- Me kërkesa të ish të punësuarve janë fotokopjuar dokumente të ndryshme nga dosjet pasive të zyrtarëve që nuk janë më në marrëdhënie pune;
- Janë lëshuar vërtetime siç janë përvoja e punës, referenca etj.
- Janë evidentuar dhe menaxhuar 138 kërkesa të pushimit në Sistemin e Burimeve Njerëzore si dhe janë përgatitur 34 kërkesa të pushimit për shërbyesit civil;
- Janë larguar 9 punëtorë nga listat e pagave ku kemi pasur 1 rast të vdekjes dhe 8 punëtorë janë pensionuar gjatë vitit 2022 dhe të njëjtëve iu është lëshuar vendimi përkatës;

- Gjatë vitit 2022 janë përgatitur 5 vendime për pushim të lehonisë;
- Janë plotësuar formularët si më poshtë:
 - Plani vjetor për trajnime;
 - Regjistri i shërbyesve civil të cilët pensionohen në vitin 2023;
 - Plani i Personelit për vitin 2023 (përmes SIMBNJ);
 - Janë ndjekur trajnime online rreth legjislacionit të ri për shërbyesit civil dhe publik si dhe rreth përdorimit të SIMBNJ (versionit të ri të Sistemit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore);
- Janë përgatitur formularët për paga dhe janë dërguar në MEF në formë elektronike si dhe për pagat e anëtarëve të Kuvendit të Komunës dhe të komiteteve për seancat e tërë vitit;
- Është dërguar në MAP raporti për strukturën e të punësuarve në shëndetësi, arsim dhe administratë për periudhat tre mujore Janar-Mars, Prill-Qershor, Korrik – Shtator, Tetor – Dhjetor 2022;
- Është plotësuar raporti statistikor për vitin 2022;
- Janë skanuar dhe janë vendosur në dosje dokumente shitesë të punëtorëve që kanë sjellë në Zyrën e Personelit. Këto janë bërë në përputhje me rregulloren për dosje;
- Janë nxjerr vërtetime të ndryshme sipas kërkesave të të punësuarve;
- Janë përgatitur vendime për përvojën e punës për punëtorët që kanë sjellë dëshmi shitesë të përvojës;
- Për çdo muaj janë plotësuar formularë të ndryshëm për paga të punëtorëve.
- Janë nxjerr nga sistemi regjistrat e pagave për punëtorët e administratës komunale, punëtorët e arsimit dhe shëndetësisë për vitin 2022 (për çdo muaj) të cilat janë kompletuar dhe janë dërguar për nënshkrimin e pagave nga ana e të të punësuarve;
- Janë zhvilluar 12 procedura të rekrutimit të jashtëm, prej tyre 6 procedura në grupe përmes sistemit elektronik, 3 procedura përmes formës fizike dhe 3 procedura të brendshme – lëvizje brenda kategorisë;
- Janë kontaktuar vazhdimisht përmes postës elektronike zyrtarët e Ministrisë së Punëve të Brendshme (DMZP) dhe janë dërguar shkresa të ndryshme për ndryshim të koeficienteve të punëtorëve për pagesën e beneficioneve tjera;
- Urdhërpagesat për pagat ose (CPO-të), për të gjitha kodet buxhetore janë dërguar te nënshkruhen nga të gjithë Drejtorët e Drejtorive Komunale dhe pas nënshkrimit, origjinalet janë dërguar në MEF;

Zyra e Personelit, përpos punëve të përditshme është marr me konsultime të ndryshme me nëpunësit civil lidhur me të drejtat e tyre edhe me procesin e vlerësimit të shërbyesve civil përkatësisht janë udhëzuar për këtë proces.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



ZYRA E INFORMIMIT DHE KOMUNIKIMIT ME PUBLIKUN

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2022

Gjatë vitit që lamë pas, Zyra e Informimit dhe Komunikimit me Publikun e cila funksionon në kuadër të Zyrës së Kryetarit të Komunës z. Agim Aliu, ka vazhduar me punën e saj të përditshme, duke pasqyruar në mënyrë të drejtë dhe të paanshme të gjitha informacionet e duhura që kanë të bëjnë me punën dhe aktivitetet e Komunës së Ferizajt.

Për një vit kalendarik, kjo zyrë ka lëshuar çdo ditë të punës komunikata nga më të ndryshmet, të cilat kanë pasqyruar punën e cila zhvillohet brenda institucionit të Komunës së Ferizajt.

Zyra për Informim dhe Komunikim me Publikun (ZIK), ka arritur që të lëshoj mbi 600 komunikata dhe komunikime të ndryshme përmes ueb faqes dhe faqes zyrtare të Komunës së Ferizajt në rrjete sociale.

Ueb faqja e Komunës sonë, çdo ditë është e freskët me plasimin e të gjitha lajmeve dhe ngjarjeve në komunën tonë, përfshirë këtu paralajmërimet e ngjarjeve, përcjelljen e ngjarjeve në komunë, por edhe jashtë komunës. Në mënyrë që Komuna e Ferizajt të jetë sa më efikase dhe të ketë transparencë sa më të madhe karshi qytetarëve, shoqërisë civile, medias dhe faktorëve të tjerë relevant, kemi bërë raportime të rregullta edhe për mbledhjet e Kuvendit, publikimin e procesverbaleve të Kuvendit, po ashtu edhe procesverbalet e mbledhjeve të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komitetit për Komunitete, komitete këto që janë obligative për komunën tonë.

Kjo zyrë gjatë vitit 2022, ka filluar me publikimet e saj edhe në Platformën e Konsultimeve Publike, duke bërë zbatimin e Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna me theks nën 5. Zbatimi i Standardeve të Konsultimit Publik.

Për një vit kalendarik janë mbajtur 16 konsultime publike, përfshirë këtu takimet publike të Kryetarit të Komunës, dëgjimet buxhetore, projekt-rregulloret, ndryshime të Statutit, plane të ndryshme dhe strategji komunale.

Gjatë këtij viti u mbajtën këto takime publike:

- 1.Njoftim për organizimin e konsultimit publik me qytetarë për Projekt Rregulloren e Punës së Teatrit “Adriana”;
2. Njoftim për organizimin e konsultimit publik për Projekt-Strategjinë e Turizmit të Komunës së Ferizajt për vitin 2023-2027;
3. Njoftim për Draft-Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Ferizajt;
- 4.Takim i parë publik me qytetarë i Kryetarit Agim Aliu;
5. Njoftim për organizimin e konsultimit publik për ndryshim-plotësimin e vendimit të Draft Rregullores për Dhënien e Dekoratave 01.Nr. 27 të datës 31.03.2015;
6. Njoftim për organizimin e konsultimit publik për ndryshim-plotësimin e Statutit të Komunës së Ferizajt;
7. Njoftim për organizimin e konsultimit publik për Draft-Rregulloren për Organizimin dhe Shfrytëzimin e Parkingjeve në tërë territorin e Komunës së Ferizajt;
8. Njoftim për organizimin e konsultim publik për logot e institucioneve kulturore, dekoratave, medaljeve dhurata dhe çmimeve;
9. Njoftim për organizimin e konsultimit publik për Projekt- Rregulloren për institucionet edukative-arsimore të Komunës së Ferizajt;
- 10.Njoftim për organizimin e konsultimit publik për Statutin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare;
11. Njoftim për organizimin e konsultimit publik për Draft-Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën së Ferizajt;
12. Kalendari i dëgjimeve publike për buxhet - 2023-Komuna e Ferizajt;
13. Njoftim për organizimin e takimit publik për hapësirën e vendosjes së Stadiumit të ri të qytetit të Ferizajt;
- 14.Njoftim për organizimin e konsultimit publik me qytetarë për Projekt Rregulloren e Taksave Komunale;
15. Njoftim për organizimin e takimit publik për projektin “Ndërtimi i nënkalimit për vetura dhe këmbësorë afër Stacionit Policor” në Ferizaj;
- 16.Njoftim për organizimin e takimit publik të dytë publik me qytetarë të Kryetarit të Komunës;

Prej të gjitha këtyre takimeve janë përgatitur procesverbalet, raportet e detajuara për ecurinë e tyre, listat me nënshkrime për qytetarë dhe zyrtarët pjesëmarrës, si dhe është siguruar edhe materiali i nevojshëm për qytetarët për çdo dokument i cili iu ka nënshtruar konsultimit publik.

Të gjitha këto dokumente, pastaj janë publikuar në ueb faqen e Komunës, por edhe në Platformën e Konsultimeve Publike.

Ueb faqja: <https://kk.rks-gov.net/ferizaj/>

Platforma: https://konsultimet.rks-gov.net/?fbclid=IwAR3RpHvMmiybqWBuxKki240ThjL3r6n0QuglwlXTD_DUKN-2VAukv33qAYo

Rregulloret e nxjerra nga Kuvendi i Komunës, të gjitha janë publikuar në ueb faqen e Komunës, por edhe në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Po ashtu janë publikuar edhe vendimet e Kryetarit të Komunës së Ferizajt në ueb faqen e Komunës për 12 muaj të vitit kalendarik.

Po ashtu, vlen të theksohet se në ueb faqe, bëhen publike vazhdimisht të gjitha njoftimet dhe konkurset, ndërkohë që aty pasqyrohen edhe vendimet e marra nga Kryetari i Komunës. Është punuar mjaft shumë edhe në publikimin e të gjitha kontratave të Zyrës së Prokurimit, por edhe njoftimeve të ndryshme të po kësaj zyre. Në kuadër të projektit të USAID-it “Komunë Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse”, është punuar mjaft shumë ku jemi renditur si njëra ndër komunat e para sa i përket transparencës në publikimin e dokumenteve të cilat janë të qasshme për publikun. Përparësi e ueb faqes së Komunës së Ferizajt është edhe ajo se secili lajm, informacion, njoftim dhe konkurs bëhet përveç në gjuhën shqipe, edhe në atë të komunitetit pakicë serb.

Në ueb faqen tonë, qytetarët e interesuar, shoqëria civile dhe mediat po ashtu mund të gjejnë të publikuara edhe të gjitha pasqyrat financiare, projektet e realizuara, projektet që do të realizohen dhe gjithçka tjetër që mund të jetë në interesin e tyre.

Pavarësisht problemeve që janë paraqitur pas ridizajnimit të ueb faqes komunale nga ana e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, zyra jonë për informim nuk ka pasur asnjë problem sa i përket plasimit të informacioneve, por edhe publikimeve të ndryshme sepse këtë e ka bërë edhe përmes rrjetit social Facebook, ku aty shikueshmëria por edhe përcjellja e informacioneve ka qenë dukshëm me e madhe sesa në faqen zyrtare të Komunës. Gjatë vitit 2022, Zyra Për Informim dhe Komunikim me Publikun, ka bërë edhe hartimin e listës së shërbimeve komunale për platformën e E-komuna, projekt ky që do të filloj së zbatuari gjatë këtij viti. Aty janë evidentuar mbi 113 shërbime, ku qytetarët do të kenë qasje të drejtpërdrejt në ofrimin e shërbimeve të tyre të shpejta dhe shumë cilësore.

Gjatë vitit 2022, janë paraqitur 69 kërkesa për Qasje në Dokumente Publike, kërkesa këto që të gjitha të aprovuara dhe të përfunduara në afat ligjor. Veç tjerash, presim që të vazhdojmë me realizimin e objektivave dhe me po të njëjtin ritëm të punës, në mënyrë që ueb faqja e Komunës së Ferizajt, çdo here të jetë e freskët me lajmet më të reja dhe në mënyrë që secili qytetarë të ketë qasje në informata dhe të dijë saktë aktivitetet e punët që ndodhin e zhvillohen në komunën tonë.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

INSPEKTORATI I KOMUNËS

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2022

Gjatë vitit 2022, Inspektorati i Komunës së Ferizajt, ka zhvilluar procesin e punës sipas objektivave dhe planit të punës të parashikuar për periudhën njëvjeçare.

AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

- Organizimi dhe planifikimi i punëve të brendshme të sektorit;
- Inspektimi i subjekteve afariste dhe pajisja e tyre me pëlqim të kushteve minimale teknike;
- Inspektimi dhe monitorimi i deponive ilegale të mbeturinave në kuadër të Komunës së Ferizajt;
- Inspektimi i subjekteve për pajisje me LMK (Leje Mjedisore Komunale);
- Zbatimi i Udhëzimit Administrativ për shqiptimin e Gjobave Mandatore;
- Inspektimi dhe monitorimi i shitësve ambulant;
- Monitorimi i rrugëve të qytetit.
- Aksione me Policinë e Kosovës – Njësia Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore;
- Monitorimi i subjekteve të cilat janë mbyllur për shkak të zhvillimit të veprimtarive devijante;
- Monitorimi dhe largimi i shitësve ambulantë nga bulevardi i qytetit;
- Monitorimi dhe kontrollimi i objekteve me ose pa leje;
- Lirimi i hapësirave publike në vendpunishte;
- Lirimi i trotuareve nga pengesat e ndryshme në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe Kompaninë “Pastërtia”;

AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

Sektori i Tregut:

Në kuadër të Sektorit të Inspeksionit funksionon edhe Njësia e Inspektoratit të Tregut. Në kuadër të Inspeksionit të Tregut gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022 kanë punuar 2 inspektorë në marrëdhënie të rregullt pune.

Gjatë kësaj periudhe:

- Janë kryer 243 kontrollime të rregullta me procesverbale të hartuar dhe një mori kontrollimesh vizuale.
- Janë lëshuar 108 vendime për dhënien e pëlqimit për plotësimin e kushteve teknike për ushtrimin e veprimtarisë biznesore për subjektet afariste.
- Janë konfiskuar mallra të ndryshme në 2 raste.
- Janë proceduar 4 lëndë në Gjykatën Themelore për Kundërvajtje në Ferizaj.
- Janë shqiptuar 35 gjoba ndaj subjekteve afariste për shkelje të ligjeve që janë në kompetenca të Inspeksionit të Tregut.
- Janë aprovuar 14 kërkesa për zgjatjen e orarit të punës.
- Janë shqyrtuar 30 ankesa të palëve, të ardhura nga Departamenti i Mbrojtjes së Konsumatorëve dhe nga persona fizik.

Sektori i Ndërtimit:

Inspektorati i Ndërtimtarisë gjatë periudhës Janar-Dhjetor të vitit 2022 ka realizuar një varg inspektimesh të rregullta dhe të jashtëzakonshme në territorin e Komunës të Ferizajt. Të gjitha këto veprime, Inspektorati i Ndërtimtarisë i ndërmori duke u bazuar në Ligjin e Ndërtimit 04/L-110, Ligjit të Inspektoratit të Ndërtimit 04/L-175 dhe Udhëzimeve Administrative në fuqi. Bazuar në ligjet dhe aktet e lartcekura, si dhe inspektimet e kryera, janë ndërmarrë këto veprime. Gjatë kësaj periudhe kanë punuar vetëm 2 inspektorë në marrëdhënie të rregullt pune.

- Janë pranuar gjithsej 37 lëndë nga arkiva.
- Nga lëndët e pranura janë 3 ankesa, të cilat janë zgjidhur.
- Kërkesa kanë qenë 34, të gjitha janë zgjidhur.
- Janë realizuar 305 inspektime.
- Janë hartuar 94 procesverbale.
- Janë marr 26 vendime për ndërprerje të punimeve.
- Janë bërë 26 mbyllje të punishteve (vendosje të shiritit dhe shenjës).

- Janë shqiptuar 20 gjoba mandatore.
- Janë bërë 5 kërkesa për fillimin e procedurës kundërvajtëse.
- Janë proceduar 3 kallzime penale në Prokurorinë Themelore në Ferizaj.
- Janë marr 2 vendime për rrënim.
- Janë bërë 40 shkresa për (dhe nga) organe dhe institucione tjera.
- Përveç punëve të lartëcekura, janë realizuar edhe punë në bashkëpunim me inspektorët tjerë.

Sektori i Ambientit:

Në periudhën Janar-Dhjetor 2022 kanë punuar 2 inspektore në marrëdhënie të rregullt pune.

Gjatë periudhës kohore dymbëdhjetë mujore janë inspektuar numër i madh i bizneseve që i nënshtrohen Lejes Mjedisore Komunale. Numri më i madh i këtyre bizneseve merren me përgatitje të ushqimeve të shpejta, përgatitje të bukës dhe pjekurinave tjera nga mielli, mishtore, përpunues të drurit (mobilerive) etj. Të gjitha këto inspektime janë bërë në bazë të nenit 15 të Udhëzimit Administrativ 01/2017 për Dhënien e Lejes Mjedisore Komunale, ku saktësisht precizohet se cilat aktivitete i nënshtrohen LMK-s. Nga këto subjekte afariste është kërkuar që t'i plotësojnë kushtet për pajisje me Leje Mjedisore Komunale. Një numër i këtyre subjekteve afariste janë pajisur me LMK, ndërsa tjerat janë në procedurë të pajisjes me LMK.

Kujdes i veçantë i është kushtuar edhe mbajtjes pastër të qytetit. Janë realizuar disa takime me K.R.M "Pastërtia", N.P.L."Ambienti" SH.A. dhe me Drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencave për bashkëpunimin që duhet ta kemi lidhur me mbajtjen sa më të pastër të qytetit.

- Janë shqiptuar 43 gjoba mandatore duke filluar nga 20 deri në 100 euro, gjoba këto për hedhje të mbeturinave, vajrave në hapësira të ndaluara, shpërndarje të broshurave (fletushkave) promocionale, ndotje të rrugëve etj., që kanë rënë ndesh me Udhëzimin Administrativ në fuqi 06/2018.
- Të gjitha gjobat e papaguara do të përcillen te përmbaruesi privat për ekzekutim të mjeteve monetare.
- Përveç gjobave janë dhënë edhe shumë vërejtje verbale të mos hedhen mbeturina në hapësira të cilat është e ndaluar hedhja e tyre. Po ashtu përmes një njoftimi të protokolluar i kemi njoftuar qytetarët për orarin e hedhjes së mbeturinave në çdo pjesë të qytetit.
- Janë pranuar 26 ankesa me shkrim të cilave i jemi përgjigjur në afat të duhur por ka akoma të cilave do i përgjigjemi brenda afatit të paraparë për shqyrtimin e tyre.
- Janë pranuar po ashtu rreth 60 ankesa verbale nga qytetarët të cilave i jemi përgjigjur menjëherë si dhe efekti ka qenë pozitiv.
- Gjithashtu gjatë inspektimit në terren janë hartuar 42 procesverbale për konstatim të gjendjes si dhe rekomandime për ecurinë e mëtutjeshme.

- Po ashtu janë realizuar 15 njoftime/rekomandime me shkrim për eliminim të deponive ilegale.
- Janë realizuar inspektime të kohëpaskohshme së bashku me Inspektorët e MMPH-së lidhur me Planin Operativ “PARANDALIMI DHE NDALIMI I AKTIVITETEVE TË JASHTËLIGJSHME NË SEKTORIN MINERAR” (saktësisht jemi marr me baza të asfaltit dhe gurthyes).

Sektori Komunal:

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022 kanë punuar 3 inspektorë në marrëdhënie të rregullt pune.

Gjatë periudhës njëvjeçare, Inspektorët Komunal janë angazhuar për zbatimin dhe implementimin e Rregullores për Rregullin dhe Shërbimet Komunale me nr. 01. Nr. 114 e datës 30/09/2019 të Komunës së Ferizajt. Zbatimi i Rregullores konsiston në mirëmbajtjen e rregullt të hapësirës publike, trotuareve, rrugëve etj.

Vëmendje e veçantë gjatë kësaj kohe i është kushtuar trotuareve, parqeve, rrjetit të ujësjellësit të kanalizimit dhe dukurive të tjera negative. Në këtë raport do të veçojmë se si aktivitet më i theksuar ka qenë ai me tregtarët ambulant me tezgat e tyre lëvizëse të vendosura në sheshin e qytetit.

Janë ndërmarrë disa aksione për pastrimin e trotuareve dhe rrugëve të qytetit nga tezgat, reklamat dhe gjësendet të ndryshme për lehtësimin e qarkullimit të qytetarëve, po ashtu jemi marr me ankesa të shumta lidhur me problemet e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit. Këto aksione janë realizuar me sukses me ndihmën e Ndërmarrjes K.R.U. "Bifurkacioni" SH.A., K.R.M. "Pastërtia", dhe mbështetjen e Policisë së Kosovës – Stacioni Policor Ferizaj.

- Janë hartuar 90 procesverbale.
- Kontrolle të rregullta - 280.
- Kontrolla vizuele - 102.
- Janë proceduar 4 lëndë në Gjykatën Themelore për Kundërvajtje.
- Janë pranuar dhe shqyrtuar 85 kërkesa dhe ankesa.
- Vendime dhe shkresa zyrtare 15.
- Janë shqiptuar 4 gjoba.

AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR

Tregu:

- Kontrollimi i të gjitha subjekteve afariste nga Inspektorët e Tregut në kuadër të autorizimeve ligjore;
- Procedimi i lëndëve për procedurën përmbartimore;

Ndërtimi:

- Monitorimi sistematik i objekteve të pajisura me leje ndërtimi;
- Rrënimi i objekteve pa leje.

Ambient:

- Monitorimi i deponive ilegale;
- Monitorimi i shitëseve ambulant të thëngjillit;
- Njoftimi në vazhdimësi për ruajtjen e ambientit;

Komunal:

- Monitorimi i bulevardit të qytetit;
- Inspektimi në terren në bazë të kërkesave të qytetarëve;
- Monitorimi dhe lirimi i hapësirave publike.

AKTIVITETET PËR VITIN 2023

- Implementimi i Udhëzimit Administrativ 01/2017
- Monitorimi i ndotjes nga djegiet e thëngjillit, plastikës si dhe sendeve tjera të cilat ndotin ambientin e të cilat nuk lejohen të digjen.
- Inspektimi i hapësirave publike;
- Organizimi dhe koordinimi i punëve brenda sektorit;
- Përcjellja e gjendjes në kuadër të sektorit, identifikimi i problemeve dhe vështirësive, si dhe propozimi i masave për mënjanimin e tyre;
- Përgatitja e planeve dhe raporteve mujore dhe vjetore të punës;
- Kontrollimi i terrenit;
- Ndërprerja e të gjitha ndërtimeve pa leje;
- Kontrollimi sistematik i objekteve me leje;
- Inspektim final i objekteve ndërtimore;
- Rrënimi i objekteve pa leje;
- Largimi nga hapësirat publike i shitësve ambulant.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



ZYRA E NJËSISË SË AUDITORIT TË BRENDSHËM

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2022

Raporti pasqyron punën e kryer dhe rezultatet e arritura, krahasuar me objektivat dhe detyrimet e planifikuara vjetore të vitit 2022. Auditimet e brendshme janë të mbështetura dhe të bazuara në Ligjin Nr. 06/L-021 Për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike si dhe ligjeve dhe akteve nënligjore të tjera në fuqi.

Njësia e Auditimit të Brendshëm, për vitin 2022 ka përgatitur Planin Strategjik 2022/2024, si dhe Planin Vjetor 2022 e që planifikimi i auditimit është bazuar në rrezikun dhe orientimin e identifikimit dhe përfshirjes për fushat me rrezik për organizatën buxhetore.

Pasi që nga ana e Njesisë së Auditimit të Brendshëm është përgatitur Plani Strategjik dhe Plani Vjetor për vitin 2022, është përcjellë për miratim tek Kryetari i Komunës dhe tek Kryesuesi i Komitetit dhe gjithashtu është dorëzuar një kopje e miratuar në Njësine Qendrore Harmonizuese të Auditimit të Brendshëm.

Në Planin Strategjik 2022-2024 janë të përfshira të gjitha drejtorit-njësitë buxhetore, duke u bazuar në nivelin e rrezikshmërisë me: rrezik të lartë, rrezik të mesëm dhe rrezik të ulët dhe gjithashtu është hartuar Plani Vjetor në të cilin janë paraparë ditët efektive për çdo auditim.

Për vitin 2022, sipas Planit Vjetor janë paraparë gjithsej shtatë (7) auditme të brendshme, që janë: katër (4) me rrezik të lartë, dy (2) me rrezik të mesme dhe një (1) me rrezik të ulët. Për vitin 2022 janë kryer këto auditime:

- Procedurat e menaxhimit të pasurive dhe inventarit- Drejtoria e Administratës së Përgjithshme;
- Grumbullimi i të hyrave vetanake - Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- Grumbullimi i të hyrave vetanake - Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;
- Procedurat e menaxhimit të resurseve njerëzore - Drejtoria e Arsimit;
- Procedurat e menaxhimit të shpenzimeve për mallra, shërbime, komunalit dhe kapitale- Drejtoria e Administratës së Përgjithshme;
- Procedurat e menaxhimit të prokurimit - Zyra e Prokurimit;
- Grumbullimi i të hyrave nga tatimi në pronë, taksat e bizneseve dhe qirave - Drejtoria e Financave.

Niveli i realizimit të Planit Vjetor

Gjatë vitit 2022, Zyra e Njesisë së Auditimit të Brendshëm ka arritur t'i kryej shtatë (7) auditime të brendshme nga shtatë të planifikuar.

Pra, gjatë vitit 2022, Zyra e Njesisë së Auditimit të Brendshëm ka arritur t'i kryej gjithsej shtatë (7) auditime të brendshme dhe t'i hartoj raportet e t'i dorëzoj në drejtoritë e audituara, Kryetarit të Komunës, si dhe Kryesuesit të Komitetit nga një kopje të raporteve finale.

Nga gjithsej shtatë (7) auditimet e kryera për të gjeturat e konstatuara kemi dhënë njëzetegjashtë (26) rekomandime për përmirësim, me qëllim të ngritjes së efikasitet dhe efektivitet gjatë kryerjeve të detyrave të punës nga ana e zyrtarëve të Komunës.

Për rekomandimet e dhëna, të gjitha drejtoritë janë përgjigjur, duke na përcjellë dhe përgatit planin e veprimit dhe datën përfundimtare të zbatimit të rekomandimeve. Bazuar në planet e veprimit të drejtorive, Njësia e Auditimit të Brendshëm ka përgatitur oraret e përcjelljes së implementimit të rekomandimeve të dhëna nga kjo zyrë.

Gjatë përcjelljes së zbatimit të rekomandimeve nga gjithsej njëzetegjashtë (26) rekomandimet e dhëna, kemi konstatuar këtë gjendje lidhur me zbatimin e tyre nga ana e drejtorive:

- Tërësisht të zbatuara shtatë (7)
- Në proces shtatë (7)
- Të pazbatuara dymbëdhjetë (12)

Shtatë (7) rekomandime mbeten për përcjellje gjatë vitit 2023, sipas planit të veprimit të përgatitur për datën përfundimtare të implementimit.

Zyra e Njesisë së Auditimit të Brendshëm, për çdo përcjellje të rekomandimeve ka hartuar raporte dhe ua ka dorëzuar drejtorive të audituara, Kryetarit të Komunës dhe Kryesuesit të Komitetit.

Zyra e Njesisë së Auditimit të Brendshëm, për dy (2) gjashtëmujorët e vitit 2022 dhe përmbledhjen e vitit 2022 ka përgatitur raportet përmbledhëse dhe ua ka dorëzuar për njoftim me gjendjen e audituar në drejtoritë e audituara në Komunën e Ferizajt, Njesisë Qendrore Harmonizuese, Kryetarit të Komunës, si dhe Kryesuesit të Komitetit.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA PËR INTEGRIME EVROPIANE

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2022

Zyra e Integritimeve Evropiane funksionon në kuadër të Zyrës së Kryetarit të Komunës së Ferizajt. Kjo zyre ka rol të koordinimit, monitorimit dhe raportimit në institucionet gjegjëse të cilat merren me integritime evropiane. Pra, linjat e komunikimit në mënyrë të vazhdueshme i mbajmë me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) dhe Ministrinë e Integritimeve Evropiane (MIE).

Gjatë periudhës dymbëdhjetë mujore, respektivisht Janar - Dhjetor 2022, ne kemi kryer në përpikëri obligimet të cilat i kemi të përcaktuara sipas detyrës zyrtare, pra koordinimin, monitorimin dhe raportimin në institucionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës të cilat merren me integritime evropiane.

Zyrtari për Integritime Evropiane ka qenë i përfshirë në ekipin e Kryetarit të Komunës së Ferizajt për aplikim në fondet e Bashkimit Evropian dhe ka mbajtur kontakt të rregullt me organizata të jashtme, ato të Këshillit të Evropës dhe të tjera të cilat operojnë në Republikën e Kosovës. Gjithashtu, vazhdojnë këto ekipe të përbashkëta të jenë aktiv edhe për thirrjet e reja të BE-së. Viti 2022 ka rezultuar i suksesshëm sepse është fituar dhe është në përfundim të implementimit Projekti “CBCEkoKid” në bashkëpunim me Komunën e Çairit në Maqedoninë e Veriut, në kuadër të projekteve për bashkëpunim ndërkufitar IPA II.

Kemi bërë raportimin e rregullt periodik në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, lidhur me Bashkëpunimin Ndërkomunal dhe Komunal Ndërkombëtar. Poashtu kemi kompletuar dokumentacionin dhe dosjet e punëve të kryera. Kemi kryer edhe punë të tjera të arsyeshme zyrtare në kuadër të zyrës.

Gjatë periudhës raportuese, Zyra për Integritet Evropian ka bërë Raportimin e rregullt në MAPL lidhur me implementimin e Planit Individual të Veprimit për Komunitetin e Ferizajt, dalur nga Agjenda Evropiane për vitin 2022. Kemi plotësuar pyetësorët e ndryshëm të kërkuara nga MAPL, MIE dhe AKK.

Janë ndërmarr të gjitha ato veprime me prioritet për integritet evropian, me të cilën synohet të jetë krijimi i një klime të volitshme për përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të jetës së qytetarëve, sundimin e ligjit, mbrojtjen e pronës, lirinë e lëvizjes, shprehjen e mendimit, tolerancën dhe krijimin e mirëbesimit.

Në periudhën njëvjeçare Janar – Dhjetor 2022 kemi mbajtur kontaktet e përditshme dhe dërgimin e informatave të kërkuara qoftë përmes telefonit apo përmes postës elektronike me Departamentin për Koordinim, Zhvillim dhe Integritet Evropian të MAPL-së, Ministrinë për Integritet Evropian dhe Ministrinë e Linjave.

Në të gjitha takimet konsultative apo tryezat e punës, jemi përgjigjur pozitivisht thirrjeve të Ministrive përkatëse, duke dhënë kontributin tonë për çështjet në fjalë.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA KOMUNALE PËR KOMUNITETE DHE KTHIM

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2022

Aktivitetet

Gjatë vitit 2022, ZKKK është marr me aktivitete të ndryshme për zgjidhjen e çështjeve dhe nevojave të komuniteteve. Udhëheqësi i ZKKK-së dhe zyrtarët kanë kryer obligimet me punë në zyre dhe terren. Po ashtu kemi mbajtur takime të ndryshme ditore, trajnime, tryeza të rumbullakëta dhe seminare me institucionet qendrore dhe lokale, organizata vendore dhe ndërkombëtare.

ZKKK në bashkëpunim me Drejtorinë Komunale të Komunës së Ferizajt ka përpiluar një pyetësor në lidhje me grumbullimin e informacioneve për gjendjen sociale, ekonomike, arsimore, shëndetësore dhe të sigurisë së komuniteteve në Komunën e Ferizajt dhe tani më ka filluar me implementimin e këtij pyetësori në komunën tonë.

Siguria

ZKKK ka qenë gjatë gjithë kohës në kontakt me komunitetet e Komunës së Ferizajt dhe sa i përket sigurisë kemi pasur 2 raste kur kemi pranuar kërkesa e që kanë të bëjnë me rrezikun nga qentë endacak një rast në Lagjen Sallahane dhe një rast tjetër në fshatin Dubravë.

Arsimi

Sa i përket arsimit, ZKKK në Komunën e Ferizajt ka pasur një bashkërendim të organizuar mirë me Drejtorinë e Arsimit (DA) Ferizaj dhe ato qendrore - MASHT e po ashtu, edhe me organizatat vendore dhe lokale që operojnë në Kosovë e që merren me zhvillimin dhe ngritjen e arsimit/edukimit. Gjatë këtij viti kemi pasur takime, bashkëpunime, ftesa për trajnime, kërkesa dhe pyetje të ndryshme, asistime për regjistrime dhe bursa, tryeza, aktivitete dhe kemi shpërndarë njoftime të ndryshme në lidhje me çështjet e arsimit gjithëherë duke koordinuar punët me DA-në e Komunës së Ferizajt. Duhet të përmendim edhe takimet që kemi pasur me disa drejtorë, psikologë dhe edukatorë të shkollave në Komunën e Ferizajt.

Ndër të tjera do të vendosim në disa pika më të detajuara aktivitetet në lidhje me arsimin dhe edukimin e komuniteteve në Komunën e Ferizajt.

- Në muajin Mars, ZKKK është takuar me organizatën Advancing Together ku kemi biseduar për mësimin online të nxënësve gjatë kohës së pandemisë.
- Në muajin shtator nxënësve të shkollimit të mesëm të lartë ju kemi lëshuar vërtetime për konfirmimin e identitetit, në lidhje me bursat shkollore.
- Me DA-në kemi arritur që të identifikojmë dhe regjistrojmë të gjithë nxënësit e interesuar nëpër shkollat e mesme.
- Kemi biseduar dhe konsultuar disa prindër dhe nxënës në lidhje me rëndësinë e shkollimit të mesëm të cilët nuk kanë dashur të vazhdojnë shkollimin e mëtutjeshëm.
- ZKKK ka asistuar organizatën Caritas Kosova me hartimin e një programi për parandalimin e braktisjes së shkollimit para fillor dhe fillor në Komunën e Ferizajt.
- ZKKK ka takuar edhe drejtorë të shkollave për të parë nëse ne si zyre mund të asistojmë në ndonjë rast apo shqetësim.
- Pas një kërkesë të ZKK-ës drejtuar Zyrës së UNMIK-ut kemi pranuar një donacion prej 35 çantave dhe mjeteve shkollore për fëmijët e shkollave fillore dhe të njëjtat janë shpërndarë tek fëmijët e përzgjedhur nga zyra nga të cilët shumica e tyre janë fëmijë jetim.

Shëndetësia

Shëndetësia në Komunën e Ferizajt duket të jetë e mirë për sa i përket ZKKK-ës së Ferizajt me disa raste që janë si vazhdimësi e pandemisë COVID-19 dhe me disa raste që për ZKKK-ën janë të menaxhueshme. ZKKK ka pasur kontakte me ta dhe është munduar që t'ju dal në ndihmë duke i adresuar tek DSHMS.

Në bashkëpunim me OSBE-në, Komuna e Ferizajt (ZKKK) ka organizuar fushatën vetëdijesuese “Shëndeti reprodaktiv” si dhe sjelljen e aparaturës mobile (Mamografi) nga Ministria e Shëndetësisë në dy lokalitete kryesisht të banuara nga pjesëtarët e komunitetit rom, ashkali, egjiptas (Lagja Sallahane dhe fshati Dubravë) për t'ju mundësuar grave nga komunitetet të bëjnë mamografi pa pagesë. Ne këtë aktivitet kanë marrë pjesë 90 gra dhe vajza nga komuniteti ashkali, 23 prej tyre kanë bërë mamografinë.

- Kërkesa për barna dhe mjekime
- Ankesa rreth mospërballjes së çmimeve të barnave

Takimet/informimet

Në muajin Janar kemi dorëzuar një kërkesë në Ministrinë për Kthim dhe Komunitete për transportin e komunitetit serb në relacionin Ferizaj-Bablak-Graçanicë. Në Janar kemi përgatitur regjistrin e 36 familjeve me varfëri ekstreme që kanë nevojë për lëndë djegëse (dru për ngrohje).

Gjatë muajit Shkurt, ZKKK-në e kanë vizituar organizata Advancing Together dhe OSBE. Njëra kishte të bënte me gjendjen e të kthyerve nga rajoni dhe tjetra me situatën e përgjithshme momentale të komuniteteve.

Nga DSHMS në muajin Shkurt kemi shpërndarë 75 batanije për familjet në varfëri ekstreme.

- Në muajin Mars, ZKKK-në e vizitoi një zyrtar i OSBE, që kishte të bënte me çështjen e ekstremizmit.
- Në muajin Mars, ZKKK është takuar me përfaqësuesin e organizatës OSBE, për përfaqësimin e komunitetit rom në institucionet lokale - Komiteti për Komunitete.
- Në muajin Mars, udhëheqësi dhe zyrtarët e ZKKK-së janë takuar me organizatën Kosint lidhur me punësimin, buxhetin dhe legalizimin e pronave.
- Në muajin Mars, zyrtarë të ZKKK janë takuar me Ministrinë për Komunitete dhe Kthim në lidhje me data bazën.
- Në muajin prill ZKKK kishte një takim me ministrin e Ministrisë të Administratës dhe Pushtetit Lokal, z. Elbert Krasniqi dhe Habit Haradini nga ZQMKM, për çështjen e ZKK-ve dhe të punësimit.
- Në muajin Prill, udhëheqësi i ZKK-së është takuar me nënkryetarin për komunitete, Danush Ademin ku kanë biseduar rreth punësimit të komuniteteve. Po ashtu ka qenë në vizitë të zyrave vendore dhe ka biseduar me zyrtarë për punët e tyre.
- Në muajin Gusht, kemi mbajtur takim me KFOR-in Amerikan LMT për punën e ZKK-së, dhe shëndetin e komuniteteve.
- Në muajin Prill, ZKKK mbajti një takim me organizatën VoRae dhe organizatën UBO lidhur me raportin e hulumtimit të gjendjes shëndetësore me Covid 19 për 14 komuna.
- Në muajin Maj, ZKKK dhe nënkryetari Danush Ademi kanë qenë në Gjilan në takim me organizatën UNHCR, MAPL dhe MKK, ku është biseduar për procesin e personave të kthyer dhe të zhvendosur.
- Në muajin Maj, në tri zyrat vendore të ZKKK janë organizuar takime me banorët për çështjet që i preokupojnë komunitetet dhe antigjipsizmin bashkë me organizatën Vo-Rae dhe ZKKK.
- Në muajin Qershor, takuam zyrtarë nga Ministria e Mbrojtjes dhe me këtë rast sollën disa njoftime për pranimin e ushtarëve në FSK, ku mund të aplikojnë të gjitha komunitetet.
- Në muajin Qershor, udhëheqësi i ZKKK-së ka pasur takim me nënkryetarin për komunitete Danush Ademin ku është biseduar për familjet që nuk posedojnë pronë (shtëpi). Për këtë çështje kanë propozuar që të mbahet takim me Kryetarin e Komunës z. Agim Aliu.
- Në muajin Qershor, ZKKK ka marr pjesë në një tryezë të rrumbullakët të ZK (Zyra për Çështjen e Komuniteteve) tema ishte ndarja e praktikave të mira.
- Në muajin Qershor, ZKKK së bashku me koordinatorin e MPB kanë qenë në terren dhe kanë vizituar 3 persona të riadhesuar përfitues të plan biznesit të viti 2016.
- Në muajin Korrik, janë ndihmuar 20 familje skamnore me pako ushqimore nga DSHMS-ja.
- Në muajin Gusht, nga DSHMS-ja janë ndihmuar 110 familje me pako ushqimore.
- Në muajin Shtator organizata Advancing Together dhe organizata Vo Rae kërkuar nga ZKK që në listën e ndihmave me lëndë djegëse të përfshihen edhe familjet e kthyer.
- Në muajin Tetor, në ZKKK ishte majori i FSK-së Muharrem Asllani dhe na njoftoi se në muajin Dhjetor do të hapet konkursi për studime në Akademinë e Forcave Ajrore të SHBA-së.
- Në muajin Tetor, organizata VoRae dhe ZKK ka mbajtur takim me disa të rinj në zyrën vendore të lagjes Sallahane ku agjenda e këtij takimi ishte antigjipsizmi, diskriminimi, roli i mediave, paragjykimimi, stereotipi, gjuha e urrejtjes, privilegji dhe krimet e urrejtjes.
- Në muajin Tetor, zyrtari nga ZKK-ja ka qenë në takim me Ministren e Drejtësisë, Albulena Haxhiu.
- Zyrtarë të ZKK-së kanë qenë në takim me organizatën IKD rreth ofrimit të ndihmave juridike për komunitetet në Komunën e Ferizajt.
- Zyrtari nga ZKK-ja ka marr pjesë në 4 takimet e organizuara nga Komiteti për Komunitete ku kanë identifikuar disa problematika infrastrukture.

- ZKKK ka mbajtur takim me organizatën OSBE për fuqizimin e grave në mekanizmat e mbrojtjes së komunitetit. ZKKK po ashtu është takuar me organizatën Helvetas projekti DEMOS për menaxhimin e bazës së të dhënave, si anëtare e grupit punues.
- Organizata VoRae ka mbajtur një takim lidhur me bartjen e pronave.
- Zyrtari nga ZKK ka qenë në një trajnim të organizuar nga OSBE në lidhje me fuqizimin e të rinjve.
- ZKK ka mbajtur dhe organizuar tri takime në tri zyrat lokale me komunitetet në lidhje me legalizimin e pronave dhe ndërtimeve pa leje me organizatën SHPRK për ofrimin e shërbimeve në lidhje me çështjet gjyqësore apo komunale pa pagesë. Temë e diskutimit ka qenë dhuna në familje ku ishte prezent edhe Kryetari i Komunës z. Agim Aliu.

Kërkesat

Në zyrat tona kemi pasur kërkesa të shumta nga komunitetet. Kryesisht ato kanë qenë për ndihma emergjente ushqimore, mjete financiare (shëndetësi), strehim (banim) etj.

ZKKK gjatë vitit 2022 i është përgjigjur 21 kërkesave gjyqësore për mosnjohjen e palëve të paditura në kontestet pronësore. Po ashtu nga zyra e jonë kemi dorëzuar kërkesa të ndryshme: për zgjidhjen e problemit me qentë endacak, pajisjen me (kompjuter, printer), lidhja me internet e zyrave vendore, kërkesa për vendosjen e një trafo elektrike në lagjen Sallahane përkatësisht rrugën “15 shkurti”, kërkesë për ndërrimin e gypave të kanalizimit në rrugicën “Ali Musa”, kërkesë për ndriçim publik, etj.

Punësimi

Në muajin Maj, jemi takuar me organizatën VoRae rreth punësimit për të rinjtë e komuniteteve.

Në muajin Qershor, zyrtari nga ZKK ka qenë në tryezën e rrumbullakët të organizuar nga Zyra e Kryeministrit me temën: “Diskutim i hapur për sfidat dhe mundësit e punësimit të komunitetit rom”

ZKK ka zhvilluar edhe takime me QAP dhe Zyrën e Punësimit.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



NJËSIA KOMUNALE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2022

Ky raport pasqyron përmbledhjen e punës së Njesisë Komunale për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore për periudhën Janar – Dhjetor 2022. Në raport janë prezantuar aktivitetet që pasqyrojnë dhe reflektojnë angazhimin dhe rezultatet e shënuara gjatë kësaj periudhe në fushat të cilat i trajton NJDNJ dhe ZBGJ.

Objektivat	Aktivitetet	Aktorët përgjegjës	Treguesit e suksesit-rezultatet	Afati kohor	Resurset-Burimet financiare
Ofrimi i mundësive të barabarta për punësim dhe krijimi i kushteve të përshtatshme për punë për të gjithë.	Monitorimi i rekrutimit në punësim në sektorin publik (pjesëmarrja në intervista)	NJKDNJ	- Rritja e shkallës së zbatimit të legjislacionit vendor dhe ndërkombëtar mbi punën dhe punësimin - Ofrimi i mundësive të barabarta për punësim	Vazhdimësi	
Ofrimi i shërbimeve më të mira shëndetësore	- Ofrimi i rekomandimeve për Rregulloren Komunale për lirin nga pagesa të kategorive të cilat janë të përcaktuara në Ligjin për Shëndetësinë.	NJKDNJ	- Krijimi i lehtësirave për shërbime shëndetësore		
Ofrimi i shërbimeve më të mira për qytetarë në administratën publike.	- Ofrimi i rekomandimeve për përmirësimin e shërbimeve më të mira për qytetarë.		- Ofrimi i shërbimeve dhe krijimi i lehtësirave në marrjen e dokumenteve identifikuese për qytetarë.	Masë afirmative një vit kohor	
Udhëzimi Administrativ për heqjen e taksave komunale për regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve	Ofrimi i udhëzimit në shërbim të qytetarëve	Drejtoria e Pronës, Gjeodezisë dhe Kadastrit dhe NJDNJK		Vazhdimësi	

Projekt udhëzimi administrativ (MPB) Nr.2002 masat për mbrojtjen e fëmijëve kundër faqeve te internetit me përmbajtje pornografike dhe atyre qe dëmtojnë shëndetin e fëmijëve.	Konsultime paraprake	NJDNJK			
Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave dhe Planin e Veprimit 2022-2026.	Ministria e Drejtësisë	NJDNJK ZBGJ			
Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinator	Agjencia për Barazi Gjimore	ZBGJ	Asistenca teknike nga Un Women	25-27 tetor 2022	
Buxhetimi i përgjegjshëm gjinore si mjet për avancimin e barazisë gjinore ne nivel komunal te organizuar nga UN WOMEN në Kosovë	UN WOMEN	ZBGJ			
Marrëveshja mes Komunave dhe UN WOMEN	Buxhetimi i përgjegjshëm gjinator	Nënkryetari i Komunës dhe UN Women	ZBGJ		
Policia e Kosovës	Punëtori për përfshirjen e te rinjve brenda KLSP-ve si dhe për të rritur ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e integritetit gjinore dhe te rinjve	Paneliste në prezantimin/kornizës ligjore qe rregullojnë çështjet gjinore ne nivelin lokal së bashku me dokumentet strategjike	ZBGJ		
Projekti DEMOS i zbatuar nga organizata HELVETAS	Përkrahja në rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve (gra, burra, persona me nevoja të veçanta dhe grupet tjera) ne proceset vendimmarrëse.	ZBGJ	ZBGJ		
Fondacioni Jahjaga	Përfshirja dhe fuqizimi ekonomik i grupeve të marginalizuara në Kosovë	Fondacioni Jahjaga në koordinim me UNHCR dhe UNDC/UNKT takim virtual me gratë dhe vajzat nga komuniteti jo-shumicë që jetojnë në Komunën e Ferizajt	ZBGJ		
Agjencia për Barazi Gjimore dhe ZBGJ	Hapja e fushatës globale 16 Ditë të Aktivizimit kundër dhunës në baza gjinore ndaj grave dhe vajzave	ZBGJ	Hapjen e fushatës se 16 Ditëve të Aktivizimit		

UN-UNMIK	Shfaqja e filmit “ROMNI” dhe filmit dokumentar “Si një grua e vërtetë”	ZBGJ	Paneliste për 16 ditët e aktivizmit kundër dhunës në familje		
ABGJ	Tryezë diskutimi në shënimin e 16 Ditëve të Aktivizmit	ZBGJ	ZBGJ Fokus-grupet për shëndetin riprodhues, është thirrja falas 080015555		
Avokati i Popullit	Hetimin e përgjithshëm për shëndetin maternal, planifikimin familjar dhe abortin në Kosovë	ZBGJ	Qasja e të gjithë qytetarëve për drejtësi		
Agjencia për Ndihmë Juridike Falas	E drejta e qytetarëve për qasje në drejtësi dhe ndihmë juridike falas	Si mund ta zvogëlojnë të drejtat pronësore rrezikun nga dhuna në baza gjinore	Vazhdimësi		
USAID	ZBGJ				
Informimi dhe vetëdijësimi i femrave për eliminimin e stigmave që pengojnë avancimin e gruas	USAID	ZBGJ	Vazhdimësi		
Ofrimi i mundësive të barabarta për Grua-Burrë		ZBGJ			
Parandalimi i stereotipeve dhe paragjyqimeve për gruan		ZBGJ	Vazhdimësi		
Informimi dhe vetëdijësimi i femrave për eliminimin e stigmave që pengojnë avancimin e femrës e veçmas në trashëgimi		ZBGJ			
Identiteti gjinor		ZBGJ			
Përkatësia gjinore		ZBGJ			
Pozita e femrës në familje dhe vendimarrje		ZBGJ			
Pozita e barabartë e vajzës dhe djalit në familje		ZBGJ			
Format e diskriminimit të gruas		ZBGJ			
Dhuna në familje		ZBGJ			
Ligji për barazi gjinore		ZBGJ dhe mekanizmat tjerë institucional			

Takimet me organizatat ndërkombëtare OSCE, Këshilli i Evropës 16 Ditët e Aktivizimit Kundër Dhunës ndaj Gruas dhe Dhunës në Familje Punëtori mbi rolin e grave dhe kontributi i tyre në siguri në bashkësi, përfshirë sfidat gjatë pandemisë Rrjeti i Grave Profesionale në kuadër të organizatës "Leadership and Growth Council" takim për të diskutuar mbi temën: Roli i grave në qeverisje dhe perspektiva për pjesëmarrjen e grave. Performanca komunale DEMOS Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, tryeza e rrumbullakët me temën :Nëna, grua dhe dhuna.	Promovimi i të drejtave të grave dhe të vajzave Prezantimi i analizës në sektorin e arsimit	ZBGJ ZBGJ ZBGJ ZBGJ ZBGJ			
Promovimi i të drejtave të komuniteteve	- Organizimi i takimeve të komunitetit pakicë për të drejtat e komuniteteve	NJDNJ	-Integrimi i komuniteteve në jetën institucionale e publike		
Promovimi i të drejtave të fëmijëve	- Organizimi i debateve publike me drejtues të shkollave, nxënës, qytetarë për të drejtat e fëmijëve	NJDNJ DA	-Identifikimi i gjendjes aktuale për DF - Zbatimi i infrastrukturës ligjore për fëmijë		
Promovimi i të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara	- Ofrimi i rekomandimeve për përmirësimin e kushteve për PAK-të - Identifikimi dhe sigurimi i të dhënave të fëmijëve me aftësi të kufizuara.	NJDNJ	- Infrastruktura e rregulluar për PAK-të - Grumbullimi i të dhënave për fëmijët me AK.		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2022

Besnik Berisha
Drejtore i Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme

Përmbajtja

Hyrje	
1. ZYRTARJA ADMINISTRATIVE (Asistentja Ekzekutive)	
2. ZYRTARI FINANCIAR	
3.SEKTORI I GJENDJES CIVILE	
4. ZYRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE	
5.SEKTORI I SHËRBIMEVE TË PËRBASHKËTA	
6. NJËSIA E PËRKTHYESVE	
7. NJËSIA E ARKIVIT TË ADMINISTRATËS KOMUNALE	

Hyrje

Drejtoria e Administratës së Përgjithshme është kompetente për ofrimin e shërbimeve të përgjithshme administrative për administratën komunale dhe për ofrimin e shërbimeve për qytetarë, bazuar në ligjet që janë në fuqi: Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Ligji mbi Shërbimin Civil, Ligji për Gjendjen Civile, Statutin e Komunës, udhëzimet strategjike të Kryetarit të Komunës, rregulloret komunale, urdhëresat dhe udhëzimet administrative.

DAP është garantuese e funksionimit demokratik të administratës komunale në aspektin e vendimmarrjes;

- E lirisë së shprehjes së mendimit;
- Trajtimit të drejtë të kërkesave e shqetësimeve të qytetarëve, shoqërisë civile dhe grupeve të caktuara të interesit;
- Zbatimit rigoroz të ligjit në procedurat administrative dhe ekzekutive;
- Rritjes së partneritetit ndërmjet administratës në njërën anë dhe qytetarëve në anën tjetër;
- DAP do të vazhdojë t'i ruaj dhe kultivoj edhe më tej marrëdhëniet e mira me komunitetet pakicë, në respektim e të drejtave dhe lirive të tyre, sipas parimit ligjor dhe qytetar.

Synimet e Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme gjatë vitit 2022 kanë qenë:

- Krijimi i një administrate profesionale, të përgjegjshme dhe të paanshme në shërbim të qytetarëve dhe bizneseve;
- Infrastrukturë të avancuar profesionale;
- Ofrimin e shërbimeve që kanë të bëjnë me punët e legjislativit dhe të ekzekutivit.

DAP është angazhuar për të siguruar dhe garantuar:

- Respektim të ligjit (akteve ligjore, nënligjore dhe normative);
- Llogaridhënie;
- Profesionalizëm;
- Efikasitet;
- Barazi gjinore;
- Transparencë në vendimmarrje dhe procedura ekzekutive;
- Luftë kundër dukurisë së korrupsionit dhe dëmtimit të pasurisë së Komunës;
- Shërbime publike cilësore dhe të shpejta për qytetarët;
- Frymë të tolerancës për mendimin ndryshe dhe të bashkëpunimit e bashkëpjesëmarrjes së qytetarëve dhe shoqërisë civile në përmirësimin e shërbimeve të administratës komunale.

Angazhimi i vazhdueshëm i DAP për ndërtimin e një administrate funksionale dhe efikase mbi bazën e respektimit të ligjit.

- DAP gjatë vitit 2022 ka zhvilluar një aktivitet të gjithanshëm të bazuar në respektimin e ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës, duke qenë në funksion dhe në shërbim të gjithë administratës komunale dhe të qytetarëve të Komunës tonë.

- DAP e organizuar në sektorët e lartshënuar ka arritur që me përkushtimin më të lartë t'i kryej me sukses të gjitha punët dhe detyrat që i kanë dalë përpara gjatë kësaj periudhe një vjeçare të punës, duke qenë vazhdimisht në shërbim të gjithë administratës komunale dhe të qytetarëve të Komunës tonë.

Më poshtë po përmendim vetëm disa nga aktivitetet më të rëndësishme të administratës komunale:

- Gjatë këtij viti kemi organizuar dhe mbikëqyr regjistrimin vjetor të inventarit të gjithë sektorëve të administratës komunale duke përfshirë edhe institucionet arsimore, shëndetësore, bibliotekave si dhe institucioneve të tjera që janë nën menaxhimin e Komunës dhe pas këtij regjistrimi kemi bërë edhe tërheqjen e inventarit të demoluar, duke e grumbulluar në depo, kurse pjesën që kemi konstatuar se mund të përdoret e kemi riaftësuar dhe dhuruar shkollave që kanë pasur nevojë (sipas kërkesave të tyre).

- Këto veprime janë kryer duke formuar paraprakisht komisionet adekuate siç janë: Komisioni për vlerësim dhe regjistrim të inventarit;

- Janë ndërmarr edhe një varg hapash e masash të tjera për funksionalizimin e mëtejshëm dhe bërjen më efektive të administratës komunale.

Në vazhdim do të paraqesim punën vjetore të sektorëve dhe njësive të DAP.

Administrata gjatë vitit 2022

DAP gjatë vitit 2022 ka zhvilluar aktivitetin e vet përmes këtyre njësive organizative:

1. Asistentja Ekzekutive
2. Zyrtari financiar
3. Sektori i Gjendjes Civile;
4. Sektori i Shërbimeve të Qytetarëve;
5. Sektori i Shërbimeve të Përbashkëta;
6. Njësia e Arkivit të Administratës Komunale.

1. ZYRTARJA ADMINISTRATIVE (Asistentja Ekzekutive)

Është përkujdesur për punët administrative në kuadër të Drejtorisë, përkatësisht ka pranuar të gjitha kërkesat e Drejtorisë për të cilat janë zhvilluar procedura dhe të njëjtat i klasifikon dhe i ruan në Arkivin e Drejtorisë gjegjëse. Shtyp njoftime dhe shkresa të tjera të DAP-së, protokollon të gjitha shkresat që dalin nga DAP, përcjellë përmes postës elektronike shkresa dhe materiale të dedikuara për Ministri, përmes intranetit u jep përgjigje kërkesave që i dedikohen DAP-së si dhe përpilon raportet e Drejtorisë.

2. ZYRTARI FINANCIAR

Është përkujdesur për gjendjen financiare të Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme, përkatësisht i ka ndërmarrë të gjitha veprimet për kompletimin e lëndëve për pagesën e të gjitha faturave të cilat kanë të bëjnë me shpenzimet e rrymës elektrike, ujit, faturat e mbeturinave, faturat për riparimin e mjeteve zyrtare si dhe faturat tjera që janë barrë e drejtorisë përkatëse.

3.SEKTORI I GJENDJES CIVILE

Të dhënat për dokumentacionin e lëshuar dhe regjistrimet e bëra nga Sektori i Gjendjes Civile (SGJC), gjatë vitit 2022, po i paraqesim në formë tabelare:

Nr.	Përshkrimi	Përdorim të brendshëm	Përdorim të jashtëm
1.	Ekstrakt i lindjes	32,168	25,144
2.	Certifikata të lindjes	3,426	24,153
3.	Certifikata të martesës	3,131	11,401
4.	Certifikata të vdekjes	2,259	2,172
5.	Certifikata të statusit martesor	1,593	1,391
6.	Certifikata të shtetësisë	219	613
7.	Certifikata familjare	6,832	13,999
8.	Certifikata të vendbanimit	3,702	2,573
9.	Vërtetim nga Arkivi	582	1092
		53,912	82,538
- Ndërtimi i Stacionit të Ri të Autobusëve – faza e dytë, filloj implementimin në vitin 2022, në vitin 2022 janë punuar 10% e punimeve, vlerë financiare e projektit 929,154.09€.
- Rikonstruimi i ndriçimit publik, 1,222,540.00€ vlera e punëve të realizuara gjatë vitit 2022.
- Ndërtimi i Qendrës Multifunksionale, filloj në vitin 2020, në vitin 2022 janë përfunduar mbi 22% e punimeve, me vlerë financiare 3,299,321.76€.
- Ndërtimi i Palestrës Sportive në fshatin Greme me kapacitet 1000 ulëse, filloj implementimin në vitin 2018, në vitin 2022 janë përfunduar mbi 95% e punimeve, me vlerë financiare 1,195,727.24€.

Më poshtë paraqitet lista e punëve që janë kryer gjatë vitit 2022:

Punët e realizuara në vitin 2022							
Projekti	Emri i rrugës	Ujësjetës në m'	Kanalizim fekal në m'	Kanalizim atmosferik në m'	Asfalt m'	Trotuar m'	Shteg i Bicikletave m'
Rregullimi i rrjetit të kanalizimit në rrugën Sadik Bega	Rr. "Behxhet Sojeva"		275.00				
	Rr. "Gjelbrimi"	250.00	250.00				
	Rr. "Tal Muhaxheri"		60.00				
Rregullimi i kanalizimit fekal dhe i rrugëve në lagjen Mehaj, Dremjak	Aksi 1		1,150.00				
	Aksi 4&5		250.00				
Rregullimi i infrastrukturës nëntokësore dhe asfaltimi i rrugicave në qytet - Lot II	Rr. "Te Visht"						
	Rr. "Te Sherret"						
Rikonstruimi i rrugës "Ahmet Kaçiku"					270.00	450.00	
Asfaltimi i rrugës kryesore dhe trotuari në Dubravë					630.00	380.00	
Asfaltimi i rrugës Bibaj kyqja R6 - Driton Islami N2 - Ferizaj	Rr. "Talinoc i M. - Bibaj"				2,130.00	4,260.00	4,260.00
Asfaltimi i rrugës kryesore dhe trotuarit në lagjen Tafaliaj, Komogllavë	Rr. "Myfti Ismajli"			980.00		3,500.00	
Asfaltimi i rrugëve dhe trotuarit në fshatin Gaçkë	Rrugica në fshatin Gaçkë				2,800.00		
Asfaltimi i rrugëve në fshatin Dremjak	Rr. "Bajram Murtezi"				485.00		
Ndërtimi i kompleksit të varrezave të reja të qytetit - Lot III - Rregullimi i hapsirave dhe ndriqimi të varrezat e qytetit						750.00	
Rregullimi i kanalizimit në fshatin Zaskok dhe asfaltimi i rrugëve në Doganaj		160.00	70.00				
Ndërtimi i kolektorit Veri-Perëndimor, për përfshirjen në kanalizimin e fshatrave Koshare, Slivovë, Kosinë, Bablak, Tërrn dhe Prelez i Jerlive			4,500.00				
Asfaltimi i rrugëve në Cërnillë						1,950.00	
Asfaltimi i rrugës që lidh lagjen Omuraj me lagjen Spahiaj në Greme dhe rrugëve të mbetura në fshatin Greme	Rrugica në fshatin Greme				2,000.00		
Asfaltimi i rrugëve në fshatin Balaj - faza II	Rr. "Mustafë Zeqiri"				393.00		
	Rr. "Mustafë Aliu"			230.00			
	Parkingu të varrezat				680 m2		
	Rr. "Ismail Salihu"		50.00	643.00			
Totali:		410.00	6,605.00	1,853.00	8,708.00	11,290.00	4,260.00



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE TURIZMIT

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2022

Balton Dërguti
Drejtore i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit

Hyrje

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit është kompetente për ofrimin e shërbimeve të përgjithshme për bizneset, për qytetarët, partnerët vendor e ndërkombëtar duke u zotuar për ofrimin e shërbimeve dhe mundësive për zhvillim ekonomik dhe turizëm dhe referuar vendit dhe rolit që ka në këtë moment turizmi në Ferizaj, përmes:

- Dhënies së pronave të komunës në shfrytëzim afatgjatë dhe afatshkurtër;
- Krijimi i zonave industriale;
- Krijimi i zonave ekonomike;
- Krijimi i zonave turistike;
- Krijimin e inkubatorëve të biznesit;
- Bashkëpjesëmarrës në financimin me partnerë ndërkombëtar dhe vendor;
- Dhënia e subvencioneve e granteve për biznese;
- Krijimi i politikave dhe dokumenteve strategjike për zhvillim ekonomik;
- Promovimi i turizmit dhe bizneseve.

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit, të gjitha punët e saj i kryen duke u bazuar në legjislacionin e vendit tonë, Statutin e Komunës, rregulloret, aktet rregullative komunale, urdhëresat dhe udhëzimet procedurale si dhe udhëzimet strategjike dhe politike të Kryetarit të Komunës.

Përmbledhje e aktiviteteve:

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit ka implementuar aktivitete të cilat kanë ndikim në

ngritjen e nivelit të zhvillimit ekonomik lokal, ku fokus i veçantë kanë qenë investimet në fushën e turizmit, rritja e numrit të vizitorëve, investimet për zhvillimin e destinacioneve, zonave, produkteve dhe shumëllojshmëria e ofertës turistike.

1. Strategjia e Turizmit:

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit ka hartuar Strategjinë e Turizmit një dokument strategjik i bazuar në planin e veprimit që ka për synim hartimin dhe koordinimin e politikave për zhvillimin e turizmit për periudhën kohore 2023-2027.

Në këtë dokument Komuna ka prezantuar planin e saj për të përkrahur zhvillimin e sektorëve kyç potencial si:

- Turizmi urban, rural dhe malor
- Turizmi kulturor
- Turizmi sportiv dhe rekreativ
- Zhvillimi i turizmit ditor me qëndrim më të gjatë në Ferizaj

Në këtë Strategji janë të planifikuara gjithsej 54 projekte të cilat planifikohen të realizohen në të ardhmen nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit. Drejtoria ka zhvilluar aktivitete konkrete për zhvillimin e turizmit, në koordinim me grupin punues për hartimin e Strategjisë së Turizmit.

Komuna e Ferizajt nëpërmjet Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit ka nënshkruar një memorandum bashkëpunimi me organizatën zvicerane Swisscontact dhe kemi bashkë financuar dy projekte.

Studimi i fizibilitetit ku përfshihen fshatrat Neredime, Pleshinë, Jezerc dhe Burrnik.

Drejtorja e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit së bashku me organizatën zvicerane Swisscontact ka bashkë financuar këtë studim e cili ka draftuar një master plan që parasheh propozimet dhe idetë për zhvillimin e produkteve turistike. Ky master plan është realizuar nga kompania franceze “GODE” të cilët kanë propozuar projekte konkrete që ndikojnë në zhvillimin e turizmit.

Po ashtu, së bashku me organizatën Swisscontact është realizuar edhe projekti për shenjëzimin dhe digjitalizimin e shtigjeve të ecjes. Ky projekt parasheh 56 kilometra shtigje, ku qytetarët, përpos shenjëzimit fizik të shtigjeve, mundën që edhe përmes telefonit ta shkarkojnë aplikacionin dhe ta kenë hartën e shtigjeve. Rregullimi i shtigjeve do të ndikoj të sjellë në Komunën e Ferizajt dhe grupe të tjera të alpinistëve nga vende të ndryshme.

Krijimi i hartave turistike të Komunës së Ferizajt

Në këto harta të vendosura në hyrje dhe sheshet e qytetit, janë përfshirë të gjitha pikat turistike që mund të vizitohen në Komunën e Ferizajt. Harta po ashtu përmes QR Code mund të shkarkohet në telefon në mënyrë digjitale. Harta Turistike e Ferizajt, është projekti i radhës i zhvilluar nga Drejtorja e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit të Komunës së Ferizajt, tejet i rëndësishëm dhe i nevojshëm për orientimin e vizitorëve të huaj, mundësi promovimi i potencialit turistik si dhe një hap i rëndësishëm për planifikimet e ardhshme në këtë sferë.

Web faqja e Turizmit

Ne webfaqen e turizmit janë përfshirë të gjitha vendet turistike, monumentet e trashëgimisë kulturore dhe historike. Webfaqja e turizmit është punuar edhe në gjuhën angleze ku kanë mundësi edhe qytetarët nga vende të ndryshme të informohen për qytetin tonë. Të gjithë ata që duan të kenë qasje më të lehtë në këtë uebfaqe mund të klikojnë në: www.visit-ferizaj.com

Udhëzuesi Turistik

Drejtorja e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit në Ferizaj, ka botuar udhëzuesin turistik për Komunën e Ferizajt. Përpos në formë digjitale, të dhënat për qytetin tonë janë edhe në formë fizike të cilat janë vendosur nëpër hotele dhe restorante të Ferizajt, si mundësi që vizitorëve t’ju ofrohet edhe mundësia të vizitojnë vende të bukura të cilat ndodhen në qytetin e Ferizajt. Udhëzuesit dhe broshurat turistike do të vendosen po ashtu edhe në pika të tjera ku frekuentohen nga qytetarë të ndryshëm. Të gjithë ata që duan të kenë qasje më të lehtë në këtë udhëzues mund të klikojnë në këtë link: <http://visit-ferizaj.com>

WebFaqja e bizneseve

Drejtorja e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit në Ferizaj, ka lansuar edhe webfaqen e bizneseve. Në këtë faqe janë paraqitur bizneset nga industria prodhuese dhe përpunuese. Të interesuarit nga të gjitha vendet e ndryshme, do të kenë më të lehtë qasjen, në të dhënat e bizneseve, sipas sektorëve. Të gjithë ata që duan të kenë qasje më të lehtë në këtë uebfaqe mund të klikojnë në: www.visit-ferizaj.com

8. Libri i bizneseve

Në mënyrë fizike janë paraqitur të dhënat e industrisë prodhuese dhe përpunuese, ky libër, do t'i ofrohet dhe të qëndroj në dispozicion për investorët e interesuar për një bashkëpunim profesional me biznese të Komunës së Ferizajt por gjithsesi ky libër i bizneseve do të shpërndahet në panair të ndryshme të bizneseve.

- Gjatë vitit 2022, organizuam gjithashtu Panairin e Punësimit së bashku me organizatën gjermane GIZ, në të cilin panair të bizneseve nga Ferizaj, u ofruan mundësi punësimi për të rinjtë. Në këtë panair ku morën pjesë mbi 50 biznese u krijua mundësia që punëkërkuarit dhe punëdhënësit të kontaktojnë direkt mbi mundësitë që ofrojnë.
- Janë zhvilluar po ashtu takime të shumta me biznese, organizata dhe institucione të ndryshme, ku është biseduar për mundësitë e bashkëpunimit në vitet e ardhshme sa i përket zhvillimit të bizneseve dhe turizmit.

Qendra për Regjistrimin e Bizneseve

Gjatë vitit 2022 Qendra Komunale e Regjistrimit të Bizneseve është bërë me platformën e re elektronike me numër unik identifikues të bizneseve ku ka pasur rritje të kërkesave dhe kjo do të vazhdojë edhe në vitin 2023. Me këtë platformë, pronarët që kanë poseduar me shumë se një biznes individual, atyre ju është mundësuar që bizneset e tjera t'i shndërrojnë në njësi. Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022 në QKRB kanë arritur gjithsej 3288 kërkesa dhe këto janë:

- Regjistrime të reja - **922**
- Ndryshime në biznes - **1372**
- Çregjistrime biznesi - **60**
- Informata biznesi - **660**
- Vërtetime - **17**
- Ndërrime të certifikatave – **156**
- Certifikata dublikate **101**

Më poshtë gjeni të bashkangjitur tabelën ku është prezantuar raporti i vitit paraprak dhe aktual i cili mund të shërbej për të bërë krahasimin e situatës sa i përket numrit të bizneseve të regjistruara e të çregjistruara , përfshirë veprimtaritë si dhe numrin e punëtorëve.

Bizneset e regjistruar		
Emërtimet/Lloji	Viti 2021	Viti 2022
Prodhuese	198	99
Tregtare	289	361
Shërbyese	279	356
Ndërtimore	127	106
Gjithsej	893	922
Struktura gjinore	Viti 2021	Viti 2022
Meshkuj	834	880
Femra	228	216
Gjithsej	1062	1096
Sipas llojit të biznesit	Viti 2021	Viti 2022
SH.P.K.	650	667
B.I.	239	253
SH.A.	0	0
Dega në Kosovë	3	1
O.K	1	1
Gjithsej	893	922

Bizneset e ç'regjistruara		
Emërtimet	Viti 2021	Viti 2022
Prodhuese	14	12
Tregtare	24	21
Shërbyese	22	23
Ndërtimore	29	4
Gjithsej	69	60

Struktura gjinore	Viti 2021	Viti 2022
Meshkuj	48	49
Femra	21	11
Gjithsej	69	60
Sipas llojit të biznesit	Viti 2021	Viti 2022
SH.P.K.	41	18
B.I.	25	42
SH.A.	0	0
Gjithsej	66	60



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



DREJTORIA E ARSIMIT

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2022

Afrim Llabjani
Drejtör i Drejtorisë së Arsimit

HYRJE

Drejtoria e Arsimit, në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi që ka, ka realizuar punë dhe detyra të shumta në funksion të ngritjes dhe përmirësimit të cilësisë në arsim dhe krijimit të kushteve më të mira në nivelin e arsimit parauniversitar, ku për vitin shkollor 2021/22, ka bërë një analizë dhe vlerësim të përgjithshëm mbi ecurinë dhe performancën e procesit edukativo-arsimor, duke e analizuar suksesin e nxënësve për rezultatet dhe sukseset e arritura në të tri nivelet e arsimit parauniversitar, duke krahasuar rezultatet e suksesit me rezultatet e periudhës së njëjtë të vitit paraprak.

Përfundimi i vitit shkollor 2021-2022 është bërë në kushte të rregullta. Ndërsa Viti i Ri Shkollor 2022-2023 për shkak të grevës së punëtorëve të arsimit, ka filluar me 27 shtator 2022.

Përkundër rrethanave të shkaktuara nga greva, Drejtoria e Arsimit ka përcjellur nga afër ecurinë e procesit arsimor, duke i mbështetur shkollat me këshilla profesionale nga zyrtarët e arsimit, duke funksionalizuar dhe fuqizuar aktivet profesionale (seksionet), duke bashkëpunuar me institucionet dhe organizata të ndryshme për zhvillimin profesional të mësimitdhënësve dhe sigurimin e efikasitetit të procesit të mësimitdhënies dhe mësimitnxënies dhe njëkohësisht në funksion të ngritjes dhe përmirësimit të cilësisë në arsim. Po ashtu, janë vlerësuar dhe analizuar rezultatet e testeve të jashtme të Provimit Shtetëror të Maturës si dhe Testi i Arritshmërisë për klasët IX-ta.

Duke ditur se vlerësimi është një proces dhe indikator determinues për nxjerrjen e treguesve kryesor, për ngritjen e cilësisë në arsim dhe për krijimin e një sistemi arsimor bashkëkohor në përputhje me kërkesat e shoqërisë së sotme-shoqërisë së dijes, kjo analizë bëhet jo vetëm për të konstatuar gjendjen, por edhe për të përcaktuar objektivat për të ardhmen, që do të reflektojnë pozitivisht në përmirësimin e shkallës së arritshmërisë së nxënësve dhe ngritjen e cilësisë së mësimitdhënies në procesin edukativo-arsimor.

Drejtoria e Arsimit po punon në mënyrë të vazhdueshme për krijimin e kushteve më të mira me qëllim që cilësia dhe rezultatet e suksesit në shkollat tona të shënoj progres dhe të arrijnë në nivelin dhe standardin e shkollave të përparuara.

Raporti i organizimit të punës së Drejtorisë së Arsimit

Organizmi i punëve në Drejtorinë e Arsimit bëhet përmes sektorëve të saj:

- **Spektori i Administratës**
- **Spektori i Financave**
- **Spektori i Arsimit**
- **Spektori i Shërbimit Teknik**

Qëllimi i raportit vjetor është prezantimi i punës njëvjeçare të të gjitha institucioneve edukativo-arsimore, gjegjësisht paraqitet suksesi, rezultatet, të arriturat por edhe sfidat dhe vështirësitë që kanë përcjellur shkollat dhe procesin edukativo-arsimor në edukimin parafillor, fillor, të mesëm të ulët dhe mesëm të lartë në Komunën e Ferizajt për vitin shkollor 2021-2022.

Drejtoria e Arsimit me kohë i ka planifikuar punët që duhet të kryhen dhe u ka kushtuar kujdes të veçantë, sidomos prioriteteve duke bërë përpjekje për shfrytëzim sa më racional të të gjitha resurseve të brendshme dhe të jashtme në shkollat tona.

Në raport janë përfshirë: rrjeti shkollor, lokali mësimor, nxënësit dhe paralelet, organizimi i mësimi, suksesi i nxënësve, mungesat e nxënësve, orët e mbajtura, aktivitetet jashtëkurrikulare etj. Pra, janë përfshirë të gjitha segmentet e punës dhe jetës në institucionet edukativo-arsimore të Komunës së Ferizajt.

Materialet bazë për hartimin e raportit:

- Plani vjetor i punës së DA-it për vitin 2022;
- Raporti vjetor i punës së Sektorëve të Arsimit pranë DA-it për vitin 2022;
- Programet vjetore dhe periodike të punës së njësive pranë DA-së:
- Njësia Administratës;
- Njësia e Financave;
- Njësia e Shërbimeve Teknike;
- Kalendar i për vitin shkollor 2022-2023, me Udhëzim Administrativ nr.05/2022;
- Raportet tekstuale dhe tabelare të shkollave fillore dhe të mesëm të ulët dhe arsimit të mesëm të lartë;
- Raportet e organizimit të seminareve me mësimdhënës për zbatimin e KK-së dhe KB për nivelet e arsimit (0,1,2,3);
- UA nr.151/2020 për përzgjedhjen dhe emërimin e drejtorëve dhe z. drejtorëve;
- Informatat rreth organizimit të Testit të Arritshmërisë Provimit të Maturës;
- Bashkëpunimi i zyrtarëve komunal të arsimit DA-së me SIA-në, dhe organe tjera relevante.

Drejtoria e Arsimit dhe stafi i saj në bashkëpunim me MASHTI-n, drejtoritë e shkollave dhe organet tjera relevante janë angazhuar në krijimin e kushteve sa më të përshtatshme për punë në shkollat e komunës sonë. Planifikimi me kohë ka mundësuar një fillim të mbarë të procesit edukativo-arsimor edhe për këtë vit shkollor.

Drejtoria e Arsimit në përfundim të vitit mësimor, në të gjitha shkollat e komunës sonë, fillon punët në lidhje me përgatitjet e përgjithshme e të nevojshme për vitin e ri shkollor.

Drejtorët e shkollave me kohë kanë marrë udhëzimet e nevojshme për fillimin e punëve në lidhje me përgatitjet të cilat duhet të bëhen sipas dinamikës së paraparë nga Drejtoria e Arsimit.

Përgatitjet janë kryer sipas punëve me prioritet:

- Në përfundim të vitit mësimor, ka filluar me përgatitjet e objekteve shkollore si renovime, lysterje, gëlqerosje, dezinfektim dhe dezinfektim etj;
- Për të siguruar kuadrin e nevojshëm, Njësia Administrative pranë Drejtorisë sonë, me kohë ka bërë përgatitjen dhe shpalljet e konkurseve;
- Me kohë është bërë edhe planifikimi për pajisjen e nxënësve me tekste shkollore të cilat gratis i ka siguruar MASHT-i, për nivelin fillor dhe të mesëm të ulët. Këto tekste janë bërë nën përcjelljen e zyrtarëve arsimor për vitin shkollor 2022-2023 të cilat janë shpërndarë nëpër shkolla ashtu siç është paraparë;
- Nga Drejtoria e Arsimit është bërë planifikimi për furnizimin e shkollave me lëndë djegëse dhe material tjetër të nevojshëm shpenzues;
- Gjithashtu me kohë shkollat janë pajisur me dokumentacion pedagogjik si libra amë, ditarë të punës, fletore të punës për mësimdhënës, material shkollore e gjëra të tjera të nevojshme;
- Drejtoria e Arsimit, përmes Aktivit të Drejtorëve të Shkollave, kujdes të veçantë i ka kushtuar përfshirjes së të gjithë nxënësve në procesin edukativo-mësimor. Një kujdes të shtuar kemi pasur për nxënësit me nevoja të veçanta. Këtë kategori të nxënësve e kemi përfshirë në gjitha nivelet e arsimit, kurse një numër i tyre (për shkak të nevojave më specifike) janë të përfshirë edhe në dy shkolla fillore në „Gjon Serreçi” dhe në „Ahmet Hoxha”. Drejtoria e Arsimit në bashkëpunim me OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare, organizon mësim plotësues me të gjitha shtresat e nxënësve në tri shkolla të qytetit (“Vezir Jashari”, “Tefik Çanga” dhe “Ahmet Hoxha”);
- Drejtoria e Arsimit ka planifikuar buxhetin për ndarjen e bursave për studentët e komunës sonë. Për shkak të rrethanave të shkaktuara nga Covid 19 dhe inflacioni, drejtoria për vitin akademik 2021-2022 u ka ndarë bursa të gjithë studentëve që kanë aplikuar si dhe ju kanë vazhduar bursat studentëve vijues. Ndërsa për vitin kalendarik 2022-2023, DKA-ja ka shpallur konkursin për bursa në bazë të rregullores për ndarjen e bursave.

Me qëllim të mbarëvajtjes së procesit edukativo- arsimor dhe në përgjithësi të punëve nëpër shkolla, Drejtoria e Arsimit, i ka kushtuar kujdes të duhur edhe:

- Planifikimit dhe regjistrimit të fëmijëve në klasat parafillore;
- Planifikimit dhe regjistrimit të nxënësve në klasën e parë;
- Planifikimit dhe regjistrimit të nxënësve në klasën e X-të, në shkollat e arsimit të mesëm të lartë;

Gjatë vitit shkollor 2021-2022, kemi vazhduar me zbatimin e KK-së dhe KB-ve në të gjitha shkollat e Komunës së Ferizaj në të gjitha nivelet e arsimit përveç shkollave profesionale që ende nuk kanë filluar në zbatimin e KK-së;

Drejtorja e Arsimit, me qëllim të ngritjes së cilësisë dhe disiplinës, ka realizuar vizitat të rregullta dhe informative nëpër shkolla.

Drejtorja e Arsimit në kuadër të rritjes së sigurisë në shkolla ka angazhuar edhe sigurimin fizik, por njëkohësisht ka vazhduar dhe ka forcuar bashkëpunimin me Policinë, Këshillin e Prindërve, ka shtuar kujdestarinë e ditës nga nxënësit dhe mësimdhënësit.

Në kuadër të zgjerimit të hapësirave gjelbëruese në oborret shkollore, DA ka arritur marrëveshje bashkëpunimi me organizaten YENI për kujdesin e mjedisit për pesë shkolla të mesme të larta, ku në kuadër të këtij projekti shkollat do mbështeten edhe materialisht për realizim të projekteve që lidhen me hapësirat e gjelbërta, poashtu në disa shkolla janë rregulluar edhe parqet shkollore.

Rëndësi e veçantë i kushtohet edhe organizimit të aktiviteteve jashtëkurrikulare, si organizimi i kuizeve nga lëndë të ndryshme të diturisë, garave kulturore, sportive etj.

RAPORTI I PUNËS PËR SEKTORIN ADMINISTRATIV TË DA-së

Spektori Administrativ në Drejtorinë e Arsimit gjatë periudhës për vitin 2022 ka udhëhequr procedurat administrative dhe ligjore për pranimin e mësimdhënësve dhe punëtorëve tjerë në shkolla për të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar në kuadër të Komunes së Ferizajt.

- Gjatë këtij viti shkollor kemi shpallur konkurset me kohë duke i respektuar kriteret dhe afatet ligjore.
- Janë udhëhequr procedurat e njoftimit të kandidatëve, intervistimit, për pranimin e kandidatëve për plotësimin vendeve të punës, si në zëvendësime, plotësime etj;
- Janë zhvilluar procedurat e pushimeve të lehonisë, pushimeve mjekësore, pushimeve pa pagesë dhe të punëtorëve të pensionuar gjatë kësaj periudhe.
- Kemi shqyrtuar kërkesa, ankesa, kemi dhënë përgjigje me shkrim sipas shkresave të palëve.
- Kemi bërë kompletimin e lëndëve për zyrën ligjore sipas padive të palëve për kompensimin e pagave me rastin e pensionimit, për rastet e punësimit.

NJËSIA E FINANCEVE

- Përgatitja për raportimin e borxheve për vitin e mëparshëm në kategoritë ekonomike paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, komunal, investime kapitale dhe subvencione.
- Përgatitja për raportimin e pasqyrave financiare për vitin e mëparshëm në kategoritë ekonomike paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, komunal, investime kapitale dhe subvencione.
- Përgatitja e planit të keshit për vitin 2022 në kategoritë ekonomike paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, komunal, investime kapitale.
- Shpërndarja e mjeteve në kategoritë e pagave për arsimin fillor të mesëm, sipas shkollave dhe raportimi i tyre për Ministrinë e Financave.

- Shpërndarja e mjeteve përmes freebalancit për çdo shkollë veç e veç në arsimin fillor të mesëm dhe çerdhen e fëmijëve.
 - Kemi bërë shpërndarjen e pagave sipas shkollave, pastaj i kemi futur në freebalance pagat dhe mëditjet, mallrat dhe shërbimet, komunalit për vitin 2022.
 - Kemi bërë përgatitjen e zotimeve për investime kapitale, përgatitjen e disponueshmërisë së mjeteve, kërkesa për zhvillimin e procedurave të prokurimit.
 - Përgatitjen e raportit tremujor për kategorinë e pagave, mallrave dhe shërbimeve, komunalive.
 - Rregullimin e retroaktivit për mësimdhënësit që nuk kanë hyrë me kohë në listën e pagave.
 - Raporti i borxheve në të gjitha kategoritë ekonomike për Ministrinë e Financave sipas kërkesës së tyre.
- Përgatitja e të dhënave për rishikim të buxhetit në të gjitha kategoritë ekonomike në muajin Qershor.
- Përgatitja e të gjitha të dhënave për bursat për studentë dhe pagesat e tyre prej subvencioneve.
 - Futja e të dhënave në BDMS në të gjitha kategoritë ekonomike për çdo shkollë.
 - Përgatitja e investimeve kapitale për ridestitim, sipas programeve të arsimit;
 - Përgatitja e listave të pagave për zyrën e Thesarit;
 - Raportimin e mjeteve të sindikatës;
 - Trajnimet e drejtorëve dhe stafit administrativ, sipas nevojave;
 - Kemi kryer të gjitha punët që na lidhin me prokurimin, planin e prokurimit, kërkesat për prokurim;
 - Bashkëpunimi dhe harmonizimi i punëve me drejtorët e shkollave;
 - Raportin e faturave të papaguara për vitin kalendarik 2022;
 - Pasqyrat financiare 2022;

NJËSIA E SHËRBIMEVE TEKNIKE

Drejtoria e Arsimit i ka kushtuar rëndësi të veçantë edhe infrastrukturës shkollore dhe duke parë që shkollat në Komunën e Ferizajt kanë nevojë për renovime dhe investime të reja, gjatë vitit 2022, ka vazhduar me realizimin e projekteve siç janë në vijim:

- Vazhdimi i punimeve të ndërtimit të shkollës "Ahmet Hoxha" në Ferizaj;
- Vazhdimi i punimeve të ndërtimit të shkollës në fshatin Tërrn;
- Fillimi i ndërtimit të shkollës në rrugën "Sali Çeku" – Ferizaj;
- Rregullimi i parkingut, trotuareve dhe shtigjeve për këmbësorë në SHFMU "Ismail Qemali" (AMË dhe PNF) në fshatin Prelez i Jerlive;
- Në shkollën "Jeronim De Rada"- Ferizaj- është bërë drenazhimi i shkollës dhe renovimi i bodrumit;
- Në shkollën "Ganimete Tërbeshti" Ferizaj - (rregullimi i toaleteve);
- Në SHFMU "Muharrem Shemsedini" në Fshatin e Vjetër – vazhdimi i punimeve për ndërtimin e sallës sportive;
- Në shkollën "Astrit Bytyçi" – Ferizaj – vazhdimi i punimeve për ndërtimin e sallës sportive;
- Rregullimi dhe renovimi i brendshëm në shkollën "Naim Frashëri" në Doganaj;
- Në SHFMU "Gjon Serreçi" – Ferizaj është bërë instalimi i paneleve solare;
- Në SHML "Kuvendi i Arbërit" – Ferizaj është bërë instalimi i paneleve solare;

- Në SHFMU “Jeronim De Rada” – Ferizaj është bërë instalimi i paneleve solare;
- Në IP “Ardhmëria Jonë” – Ferizaj është bërë instalimi i paneleve solare;
- Instalimi i ngrohjes qendrore në dy shkolla: “Ismail Qemali” - Prelez i Jerlive dhe “Naim Frashëri” Doganaj.
- Pajisja e pesë klasave parashkollore me inventarë në kuadër të marrëveshjes me Caritas-in zviceran.

Në bashkëpunim me MASHTI-in kemi furnizuar katër salla sportive të shkollave me rekuizita sportive:

- Salla në SHFMU “Imri Halili” në fshatin Gaçkë;
- Salla në SHFMU “Besim Rexhepi” në fshatin Komogllavë;
- Salla në SHFMU “Gjon Serreçi” - Ferizaj;
- Salla në SHML “Kuvendi i Arbërit” - Ferizaj.

Poashtu DA, përmes operatorit “Shtëpiaku” ka intervenuar në rregullimin dhe mirëmbajtjen e nyjeve sanitare, dyshemeve, dyerve, dritareve, kulmeve etj. Kurse përmes projektit për Eficiencë të Energjisë janë paraparë të bëhet edhe renovimi i këtyre shkollave:

- SHFMU “Dituria” - Dardani.
- SHFMU “Bilall Shala” - Lloshkobare.
- SHFMU “Visar Dodani” - Varosh.

SEKTORI I ARSIMIT

Në kuadër të sektorit të arsimit aktivitetin e tyre e zhvillojnë:

- Zyrtari për arsimin parafillor dhe fillor
- Zyrtari për arsimin e mesëm të ulët dhe
- Zyrtari për arsimin e mesëm të lartë.

Zyrtarët arsimor, i kanë kushtuar kujdes të duhur këtyre punëve:

- Kanë përcjellur dhe mbikëqyrur përgatitjet e gjithëmbarshme të shkollave në kuadër të procesit edukativo-arsimor, janë angazhuar që të bëhet përfshirja e nxënësve në shkollimin e rregullt, kemi kontribuar në ngritjen e bashkëpunimit të shkollës me prindër dhe komunitetin në përgjithësi;
- Takimet mujore të Task Focës, të mbajtura në QPS në Ferizaj;
- Është bashkëpunuar me Shoqatën e Biologëve, Matematicientëve, Fizicientëve dhe Kulturës sportive në organizimin e garave në lëmitë përkatëse;
- Në muajin Gusht kanë pranuar dhe shpërndarë tekstet shkollore në të gjitha shkollat e komunës sonë, si dhe kemi vazhduar edhe me pjesën tjetër të teksteve të ardhura më vonë nga shtëpitë tjera botuese, nga kontaktet që kemi pasur me shkolla mund të konkludojmë se të gjitha shkollat janë furnizuar me libra;
- Është bërë Vlerësimi i Fëmijëve me Nevoja të Veçanta, përmes Ekipit Vlerësues;
- Zyrtarët arsimor në kuadër të punëve dhe detyrave të tyre të punës për çdo gjysmëvjetor janë marrë me grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave statistikore për suksesin e nxënësve, vijueshmërinë, disiplinën etj;

- Zyrtarët arsimor gjatë vitit 2022 kanë bërë vizita në të gjitha shkollat, me qëllim të ngritjes së cilësisë dhe disiplinës. Gjatë këtyre vizitave është përcjellur respektimi i orarit mësimor, realizimi i planprogrameve, notimi i nxënësve, kontrollimi i dokumentacionit administrativ, pedagogjik, stafit arsimor, teknik si dhe zhvillimi i aktiviteteve tjera kurrikulare dhe jashtëkurrikulare;
- Janë dhënë udhëzime lidhur me organizmin e mbajtjes të Testit Kombëtar për klasat e IX-ta dhe të Testit të Maturës për klasat e XII-ta;
- Zyrtarët arsimor, kanë shqyrtuar konkurset e shpallura për pranimin e kuadrit arsimor, udhëheqës, teknik dhe punëtorë administrativ, kanë bërë vlerësimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve;
- Koordinimi dhe përcjellja e të gjitha trajnimeve që realizohen në Qendrën për Ngritjen Profesionale (QNP) në shkollën “Tefik Çanga”, për të gjitha nivelet (0,1,2,3);
- Është hartuar plani i përcjelljes së trajnimeve për zbatim të KK dhe KB (Kurrikulës dhe Kurrikulës Bërthamë);
- Janë hartuar raporte mujore me shkrim lidhur me zbatimin e KKK-së dhe KB-ve në të gjitha shkollat e Komunës së Ferizajt, raportet janë dërguar në MASHT;

Po ashtu, në kuadër të ngritjes së kapaciteteve të stafit arsimor në shkolla përmes zhvillimit profesional, DA në bashkëpunim me MASHTI-n dhe organizata të akredituara ka organizuar trajnime, seminare e punëtori.

DA në bashkëpunim me Caritas Zvicëran përmes projektit “SHPRESA” ka bërë trajnimin e edukatoreve të grupmoshës 5 - 6 vjeçare (dhe është duke vazhduar trajnimin). Gjithashtu, me CARITAS zvicëran, kemi nënshkruar edhe një marrëveshje bashkëpunimi tre vjeçare që ka të bëjë me projektin e ri YENI:

Trajnimet e mësimdhënësve

Trajnimi i stafit arsimor për zbatimin e Kurrikulës është zhvilluar gjatë muajit Korrik 2022. Trajnimet janë realizuar në të gjitha fushat e Kurrikulës.

Këto të dhëna janë të paraqitura në tabelën vijuese:

Numri	Fushat kurrikulare	Numri i mësimdhënësve
1	Fusha- Gjuhët dhe komunikimi	18
2	Fusha- Artet	1
3	Fusha- Matematika	11
4	Fusha- Shkencat natyrore	7
5	Fusha- Shoqëria dhe mjedisi	16
6	Fusha- Edukata fizike, sportet dhe shëndeti	6
7	Fusha- Jeta dhe puna	2
8	Fusha- Mësuese të ciklit klasor dhe parafillor	65
Gjithsej		126

RAPORT MBI ARSIMIN GJITHËPËRFSHIRËS - 2022

Arsimi gjithëpërfshirës është një dimension i arsimit cilësor bazuar në të drejtat që thekson barazi në qasje dhe pjesëmarrje dhe i përgjigjet pozitivisht nevojave individuale për nxënie dhe kompetencave të gjithë fëmijëve.

Arsimi gjithëpërfshirës ka në qendër fëmijën dhe vendos përgjegjësinë e adaptimit të sistemit arsimor në bazë të nevojave të fëmijës. Së bashku me sektorë të tjerë dhe me komunitet më të gjerë, arsimi gjithëpërfshirës funksionon në mënyrë aktive për t'i siguruar çdo fëmije, pavarësisht gjinisë, gjuhës, aftësisë, fesë, kombësisë ose karakteristikave të tjera, mbështetje për të marrë pjesë në mënyrë kuptimplotë, të mësojë së bashku me nxënësit, si dhe të zhvilloj potencialin e plotë. Në Kosovë, koncepti i edukimit gjithëpërfshirës, është kuptuar në formën më të kufizuar të tij, duke ngecur te sigurimi i qasjes në arsim për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe jo si sigurimi i kushteve për pjesëmarrje të plotë të fëmijëve me aftësi të kufizuara në procesin mësimor/mësimdhënës.

Drejtoria e Arsimit në bashkëpunim me shkollat ka bërë mbledhjen e të dhënave mbi numrin e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore dhe për vitin 2022 vazhdimin e mbajtjes me informata të databazës për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore në nivelin komunal.

Në SHFMU “Ahmet Hoxha” funksionon me sukses Qendra për Mësim Shtesë, ku punohet me nxënësit që kanë ngecje në procesin mësimor e sidomos në shkrim-lexim. Po ashtu kjo qendër punon edhe me grupe të marginalizuara si komunitetet jo shumicë.

Në kuadër të programit “Arsimi Gjithëpërfshirës”, SCiK ka organizuar trajnimin e akredituar nga MASHTI me temën “Mbështetja psikosociale dhe të mësuarit socio-emocional” ku 67 mësimdhënës nga shkollat e Ferizajt do të certifikohen për vijimin e trajnimit.

Janë organizuar trajnime për “KNF dhe përdorimi i instrumenteve për vlerësimin pedagogjik të nxënësve me nevoja të veçanta” me mësimdhënës të shkollave fillore dhe të mesme të ulta.

Në Komunën e Ferizajt, gjithsej 52 mësimdhënës do të certifikohen për vijimin e trajnimit. Gjatë këtij viti po në kuadër të të njëjtit program, SCiK ka organizuar sesione me shkolla për “Udhëzuesin mbi praktikat më të mira për arsimin gjithëpërfshirës”. Afërsisht 40 pjesëmarrës janë informuar mbi Udhëzuesin, në mesin e tyre drejtorë të shkollave, mësimdhënës dhe koordinator të cilësisë.

Në shkollat (“Besim Rexhepi”, “Kostandin Kristoforidhi”, “Naim Frashëri”, “IP Ardhmëria jonë”) ku SCiK ka themeluar qendrat “Kujdesi dhe zhvillimi në fëmijërinë e hershme”, janë mbajtur sesione informuese për prindër nga ekspertë të fushave të ndryshme.

REGJISTRIMI I NXËNËSEVE NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR

Arsimi parafillor

Në komunën tonë funksionojë dy çerdhe të fëmijëve, IP “Ardhmëria Jonë”, si çerdhe publike, dhe Çerdhja “Engjujt” në partneritet publiko-privat.

Viti shkollor 2022-2023

Në institucionet parashkollore janë regjistruar:

Grup mosha	Numri i grupeve	Gjithsej numri i fëmijëve		
		M	F	Gj
06 muaj – 2 vjeç	3	15	22	37
1 vjeç – 2 vjeç	2	11	13	24
2 vjeç – 3 vjeç	4	37	44	81
3 vjeç – 4 vjeç	5	50	62	112
4 vjeç – 5 vjeç	4	47	49	96
5 vjeç – 6 vjeç	4	59	58	117
Gjithsej	24	219	248	467

Numri i fëmijëve të regjistruar në klasat parafillore

Numri i fëmijëve në klasat parafillore	M	F	GJ
	724	711	1434

Numri i nxënësve të regjistruar klasa 1 - 9

Numri i nxënësve klasa 1 – 9	M	F	GJ
	7476	7367	14850

Numri i nxënësve të regjistruar klasa 10 - 12

Numri i nxënësve klasa 10 – 12	M	F	GJ
	2843	2806	5646

Numri i përgjithshëm i nxënësve 1 -12

Numri i nxënësve klasa I – XI	M	F	GJ
	10319	10182	20501

REZULTATET E TESTEVE
TESTI I ARRITSHMËRISË - Viti shkollor 2021 – 2022

	Nr.i nxënësve	Pozitiv	%	Negativ	%
Gjithsej	1676	780	46.6	896	53.4

PROVIMI I MATURËS – Afati i Qershorit
Viti shkollor 2021-2022

	Nr.i nxënësve	Pozitiv	%	Negativ	%
Gjithsej	1765	1373	77.8	392	22.2

PROVIMI I MATURËS – Afati i Gushtit
Viti shkollor 2021-2022

	Nr.i nxënësve	Pozitiv	%	Negativ	%
Gjithsej	309	186	60.2	123	39.8

Përfundim

Përkundër sfidave dhe peripecive të shfaqura me fillimin e vitit shkollor përshkak të grevës dhe problematikave të natyrave të ndryshme në kuadër të procesit edukativo-arsimor, Drejtoria e Arsimit, pas vlerësimit dhe analizës së përgjithshme mbi rezultatet e arritura nga nxënësit në tri nivelet e arsimit parauniversitar gjatë vitit shkollor 2021/2022, si dhe zhvillimeve të përgjithshme të ecurisë së procesit edukativo-arsimor, konstatojmë se në këtë vit shkollor ka zhvillime dhe përmirësime të kënaqshme të rezultateve dhe suksesit të nxënësve në komunën e tone, pra konsiderohet një vit i suksesshëm dhe me rezultate të mira.

Kjo është si rezultat i masave dhe veprimeve konkrete të ndërmarra nga Drejtoria e Arsimit, në shumë dimensione në funksion të përmirësimit dhe ngritjes së cilësisë në arsim.

Drejtoria e Arsimit po punon në vazhdimësi me të gjithë kapacitetet e saja, duke bashkëpunuar edhe me institucionet relevante përgjegjëse të arsimit, që në komunën tonë të ndërtohet një infrastrukturë shkollore e nivelit bashkëkohor, duke krijuar kushte optimale që në shkolla.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

DREJTORIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2022

Xhemile Murati Shabani
Drejtoreshë e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Hyrje

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit është dikaster që funksionon në kuadër të Komunës së Ferizajt, e cila kryen punët dhe detyrat sipas rregullave dhe dispozitave ligjore dhe sipas organogramit komunal.

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka këta sektorë dhe njësi:

- **Spektori i Kulturës**
- **Spektori i Sportit**
- **Spektori i Rinisë**
- **Spektori i Bibliotekave**

- **Njësia e Kulturës**
- **Galeria**
- **Muzeu**
- **Teatri**
- **Zyra administrative dhe financiare**

Fillimviti zakonisht është periudhë kur bëhen rishikimet, analizat, raportet e planet e punës, takime punuese dhe ndarjeve të detyrave sipas llojit të aktivitetit. Por gjithsesi nuk mungojnë edhe aktivitetet e kohëpaskohshme.

Në vazhdim po paraqesim raportin vjetor të punës të DKRS-së, raport i cili pasqyron punën dhe aktivitetet kulturore, sportive, rinore, të bibliotekave dhe arkivit gjatë vitit 2022.

- Vazhduam punimet në ndërtimin e Pallatit të Kulturës;
- Vazhduam punimet në kuadër të projektit “Ndërtimi i fushave sportive në qytet dhe fshatra”.
- Subvencionuam **220 projekte** të skenës së pavarur kulturore, rinore e sportive, OJQ- të ndryshme përmes Thirrjes Publike dhe aplikimit në DKRS;
- Realizuam mbi **200 aktivitete kulturore, rinore e sportive** e prej tyre veçojmë:
 - Edicioni i 10-të i Festivalit “FerFilm”;
 - Edicioni i 52- të i Festivalit të Teatrove;
 - 50 vjetori i Festivalit “Kosovarja Këndon”

- Gjatë vitit 2022, u liruan nga pagesa studentët e regjistruar në Bibliotekën “Sadik Tafarshiku”;
- Lidhëm marrëveshje bashkëpunimi për herë të parë me një komunë franceze, me Komunën Gravelines të Francës, përmes organizatës Play International, ku do të mundësohet shkëmbimi i përvojave ndërmjet të rinjve;
- Përkrahëm me dhjetëra grante për të rinjtë përmes programit të përbashkët me MAPL dhe Qeverisë Japoneze “Komuna për të Rinjtë”;
- Mbështetëm botimin e 12 veprave, kryesisht vepra letrare dhe monografike.

SEKTORI I KULTURËS

Spektori i Kulturës - është një nga katër dikasterët që funksionojnë në kuadër të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit- Ferizaj. Ky sektor organizon aktivitete kulturore të përbashkëta e të ndara, me grupet kulturore e komunitetin artistik, aktivitete tjera që kërkohen nga institucionet komunale, si dhe propozime nga faktorë të jashtëm. Këto aktivitete shtrihen gjatë punës njëvjeçare duke iu përmbajtur planit të punës të përpiluar në fillimvit e në të shumtën e rasteve duke tejkaluar këtë plan me aktivitete shtesë.

Në kuadër të Sektorit funksionojnë këto njësi:

- **Njësia e Kulturës**
- **Galeria e Arteve**
- **Njësia e Muzeut**
- **Teatri**

Në raportin në vijim i gjeni aktivitetet e realizuara nga ky sektor, përkatësisht njësitë e saj, si dhe aktivitete nga grupe kulturore që veprojnë në partneritet me këtë sektor.

Publikimi i repertoarit mujor të Teatrit “Adriana” - Zakonisht Teatri i Qytetit “Adriana” në çdo fillim muaj publikon repertoarin e shfaqjeve që do të shfaqen gjatë muajit aktual. Repertoari përfshinë reprizat e shfaqjeve të teatrit por edhe ato mysafire.

Ligjëratë nga Daut Demaku: “Ligjet e energjisë për ushqimi të shëndetshëm”.

Koncertë në klarientë: Në Galerinë e Arteve - Ferizaj, u dha një koncert me klarinetë nga studentët e International Kosova Clarinet. Dirigjent: Shkumbin Bajraktari. Organizator: Blerim Emërllahu.

Takim me përfaqësuesit e grupeve kulturore - Ky takim mbahet çdo fillimvit me grupet kulturore tradicionale edhe ato të reja, të cilat bashkëpunojnë me Sektorin e Kulturës. Në këtë takim të veçantë u nderuan me mirënjohje grupet kulturore (ansamblet, shoqatat, klubet etj) që bashkëpunuan me aktivitete kulturore me Sektorin e Kulturës gjatë vitit 2022. Njëkohësisht në këtë takim u konfirmua kalendari i aktiviteteve kulturore për vitin 2022.

Mirënjohje Postmortem -Sektori i Kulturës së DKRS-së, nderoi me **mirënjohje postmortem** aktivistët dhe dashamirët e kulturës që ndërruan jetë gjatë vitit 2021. U nderuan familjet e artistëve ose aktivistëve të kulturës: Milaim Shabani- piktor, Ruzhdi Sadriu- aktor, Don Sandro Shaboleta- prifti italian, mik i shqiptarëve.

Në Galerinë e Arteve u bë promovimi i **librit me poezi “Pranvera”** të autores së moshës së vogël Olta Salihi. Olta është nxënëse e shkollës “Besim Rexhepi” të fshatit Komogllavë, e cila shkollë përkrahë talentët e vegjël.

Kromatika koncert në Teatër - Grupi i pavarur “Kromatika” mbajti koncert me fëmijë për përvjetorin e Pavarësisë.

13 Ekspozitë e karikaturës në Shkodër nga tre artistë ferizajas nga SHK “HiTHi”- Tre karikaturistë ferizajas: Imri Musliu, Agron Sejdiu dhe Selajdin Sela, organizuan ekspozitë në Shkodër. Ekspozita u vizitua nga një grup i Sektorit i Kulturës- DKRS.

Aktivitete kushtuar 17 Shkurtit Ditës së Pavarësisë

Aktivitete kushtuar përvjetorit të Pavarësisë së Kosovës janë bërë në bashkëpunim me shoqata të ndryshme kulturore, rinore dhe sportive. 14 vjetori i Pavarësisë së Republikës së Kosovës është festuar me aktivitete të ndryshme, si në tabelën në vijim:



DKRS
FERIZAJ

Manifestim kulturor nacional

14 VJETORI I PAVARËSISË SË KOSOVËS

(16-17 shkurt 2022)

Nata	Aktiviteti	Koha	Vendi
E mërkurë 16 shkurt	Aktivitet rinor "Rruga e Kosovës drejt pavarësisë në sytë e të rinjve sot"	12:00	Teatër
	Aktivitet nga Biblioteka e Qytetit • Ekspozitë e librave të poetëve dëshmorë • Lexuesi i Vitit	14:00	Biblioteka e Qytetit
	Ekspozitë kolektive Galeria e Arteve & SHAF "Zef Kolombi"	18:00	Galeri
	Film artistik kosovar "ZGJOI"	19:00	Teatër
E Enjte 17 shkurt	HIKING - Ecje në natyrë SHBA "Lybeteni"	07:00	Destinacioni: Maja e Lybetenit
	Homazhe	10:00	Varrezat e Dëshmorëve
	Aktivitet Letrar Klubi Letrar "De Rada", Oda e Librit: "Karabina e gjyshit"	13:00	Galeri
	Koncert për fëmijë Grupet e fëmijëve	15:00	Teatër
	KONCERT FESTIV - Kori i Qytetit - Okteti - Grupi i mandolinistëve "Nostalgjikët"	19:00	Teatër

Manifestimi mbahet nën përkujdesje të kryetarit të Komunës së Ferizajt, Agim Aliu.

7 Marsi- Dita e Mësuesit – në kuadër të kësaj festë, grupi i mandolinistëve "*Nostalgjikët*" performoi me një koncert festiv dhe pika të zgjedhura muzikore.

Bras koncert me dirigjenten Lirjona Sylejmani - Ansambli i tunxheve mbajti koncert në Galerinë e Arteve në Ferizaj.

Njohje fillestare me artin skenik - Program ligjërues e praktik për të rinj. Në këtë edicion prezantuan sukseshëm talentet e reja: Aulona Gashi, Erza Sejdiu e Erina Sahiti.

Festivali i fotografisë "Lens Fest": Në këtë periudhë u mbajt faza e parë tre ditore e festivalit, për t'u ndërlidhur pastaj në pjesën e verës më vonë. Organizatore: Bardha Goga.

"Zonja X"- premierë - Teatri "Adriana" dha premierën e radhës, shfaqjen "Zonja X". Autore: Sadet Beqiri, regjisor Kastriot Saqipi.

Gala koncert me veprat muzikore të dirigjentit Ramadan Ramadani - Organizator: Trupa Artistike Regjionale TAR - Ferizaj.

Shfaqja “Era” (premierë): Me tekst të autores Albana Muja e me regjisor Agim Sopin, u dha premiera e shfaqjes “Era” në sallën e Teatrit “Adriana”- Ferizaj.

Koncert Orkestra Frymore – Filharmonia e Kosovës - Në turneun nëpër qendrat e Kosovës, Orkestra Frymore e Filharmonisë së Kosovës dha një koncert në Ferizaj, me vepra të kompozitorëve botëror dhe të vendit.

Mural Fest Kosova- Edicioni i 7-të - Ndonëse Festivali i Muraleve “Mural Fest Kosova”, ka një periudhë të caktuar të mbajtjes si festival, gjithsesi ky festival i ka kaluar edhe kufijtë kohor, por edhe kufijtë regjional, duke dëshmuar punën gjatë gjithë vitit të ekipit të këtij festivali, si dhe e dyta, duke e parë punën e tyre edhe në qytete të tjera të Kosovës. Kështu ishte edhe në këtë vit. Festivali, veç realizimit të dhjetëra muraleve, pati edhe pika të tjera, si debate, trajnime etj.

Koncert i muzikës klasike në Çelo - Cellicatesse Cello Ansambel

Gala koncert me veprat muzikore të dirigjentit Ramadan Ramadani - Organizator: Orkestra e Qytetit-dirigjente Lindita Isufi.

Koncert solistik - Rilind Konxheli - Rilind Konxheli është tenor i ri i sapodiplomuar në Akademinë e Arteve në Prishtinë. Ky ishte koncerti i tij i parë pas diplomimit.

Festivali i muzikës për fëmijë “Diamond Fest” edicioni i 9-të

Diamond Fest është festival për fëmijë, i cili organizohet tash e disa vite në Ferizaj. Sektori i Kulturës zakonisht i kushton rëndësi të veçantë mbajtjes së çdo edicioni.

“Ditët e Kulturës”: Me shumë aktivitete, për 12 ditë radhazi u realizua manifestimi tradicional - “Ditët e Kulturës”. Poashtu Dita e Çlirimit është manifestim i veçantë që mbahet në kalendarin “Ditët e Kulturës”, ku përpos aktiviteteve zyrtare protokollare, mbahen edhe disa aktivitete kultur

DITËT E KULTURËS - Ferizaj 2022

01- 12 Qershor

DITA	AKTIVITETI	KOHA	VENDI
E mërkurë 1 Qershor	DITA NDËRKOMBËTARE E FËMIJËVE - Program kulturo-artistik me grupet e fëmijëve - Prezantim ekspozues për fëmijë - Policia e Kosovës	11:00	Sheshi i Qytetit
	SHFAQJE TEATRORE PËR FËMIJË “Pinokio” - Maarif School Kosova	14:00	Teatër
E Enjte 2 Qershor	EKSPOZITË KOLEKTIVE E ARTIT PAMOR - Galeria e Arteve & SHAF “Zef Kolombi”	18:00	Galeri
E premte 3 Qershor	SOFRA TRADICIONALE - Program kulturo-artistik AKV “Kastriotët” - grupi i folklorit	18:00	Sheshi i Qytetit
E shtunë 4 Qershor	HIKING - Ecje e organizuar DKRS & Shoqëritë Bjeshkatore	07:00	Bjeshkët e Jezercit
	FESTIVAL PËR FËMIJË “Fëmijët e Gëzuar”	15:00	Teatër
E diel 5 Qershor (E diel)			
E hënë 6 Qershor	KONCERT I MUZIKËS KLASIKE - TRIO MOSSO - Vepra nga kompozitorë shqiptarë	18:00	Teatër
E martë 7 Qershor	SHFAQJE TEATRORE “The Handke Project” – Qendra Multimedia \ Mittelfest & Teatro della Toscana, Theater & Schauspiel Dortmund, Theater of Sarajevo & MESS Festival	20.00	Teatër
E mërkurë 8 Qershor	LIGJERATË MBI TRASHËGIMINË KULTURORE - Zyra për Trashëgimi e Muze	11:00	Galeri
	MANIFESTIM KULTUROR - Dita e Shkollës së Arteve “Çesk Zadeja” Koncert & Ekspozitë Mysafir special: Orkestra frymore – Filharmonia e Kosovës	18.00	Teatër
E enjte 9 Qershor	SHFAQJE TEATRORE - Teatri i Qytetit “Adriana” - Shfaqja “Era” - Teksti: Albana Muja; Regjia: Agim Sopi	20.00	Teatër
E premte 10 Qershor	FESTIVALI I RECITATORËVE - Gara në interpretim të poezisë, shkollat fillore dhe të mesme	17:00	Teatër
E shtunë 11 Qershor	PROMOVIM LIBRI “Ismail Rama - artist i dramave të mëdha në skenë e në jetë” Autor: Banush Imeri	17:00	Teatër
DITA E ÇLIRIMIT			
E diel 12 Qershor	HOMAZHE	10:00	Varrezat e Dëshmorëve
	AKADEMI SOLEMNE - Pjesë foljore\ Pjesë artistike	11:00	Teatër
	MINIMARATONA E VRAPIMIT - 2022 “Vrapojmë me polcinë tonë”	11:30	Sheshi i Qytetit
	KONCERT FESTIV - AKV “Kastriotët”	20:00	Sheshi i Qytetit

Organizator: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit - Ferizaj
Manifestimi mbahet nën përkujdesjen e kryetarit të Komunës së Ferizajt, Agim Aliu.

Balet - Baleti Kombëtar i Kosovës "Tanzminiaturen&Tangata". Koreografia: Ricardo Fernando.

Koncert në flautë- Prezantuan artistët nga Prishtina: Nina Shala- flautë e Drilon Çoçaj- kitarë.

Koncert në piano - Performoi pianistja e re Arlinda Rexhepi.

Piano Fest Ferizaj - Festivali i pianistëve të rinj “Pianofest Ferizaj” realizoi fazën e parë të festivalit.

Koncert në flautë - Performuan flautistët e vegjël, klasa e prof. Blenda Konxhelit.

Koncert në flautë - Performuan flautistët e vegjël, klasa e prof. Arditë Lubishtanit.

Shfaqja “Memorandumi”. Në sallën e Teatrit “Adriana” u dha premiera e shfaqjes “Memorandumi” me autor: Vaclav Havel, regjisor: Agon Myftari. Në shfaqje prezantoi shkëlqyeshëm trupa e aktorëve të Teatrit “Adriana”.

Dita e Pavarësisë së SHBA-së: Ky manifestim u mbajt në fshatin Mirosalë, konkretisht te lagjja Cakaj, nën organizim të shoqatës “Miq të familjes Joe Biden” dhe përkrahur nga Komuna e Ferizajt.

Festivali multidisiplinor “Playfest

Në hapësirat e “Parkut të Lirisë” u mbajt festivali Playfest, festival pesë ditor me shumë aktivitete argëtuese, kreative nga fusha e muzikës, filmit dhe artit vizuel. Udhëheqës i festivalit: Pëllumb Bekteshi.

Ekspozitë e fotografisë “Retrospektivë e qytetit” nga Eqrem Ejupi- EQA.

Muaji Korrik e Gusht karakterizohen me manifestimin kulturor “Ditët e Mërgatës”. Drejtoria e Kulturës zakonisht i kushton rëndësi të veçantë kësaj periudhe, prandaj e përgatit një kalendar të veçantë me aktivitete të larmishme kulturore. Më poshtë paraqitet tabela e aktiviteteve:

Ditët e Mërgatës

Ditët e MËRGATËS		26 korrik - 11 gusht	
NATA	AKTIVITETI	KOHA	VENDI
E martë 26 Korrik	AKTIVITET ME FËMIJË (Hapja e manifestimit)	18:00	Sheshi i Qytetit
E mërkurë 27 Korrik	KOLONI ARTISTIKE PËR MËRGIMTARË Galeria e Arteve/ SHAF Zef Kolombi	17:00	Bulevard
	SHOW BOXING Prezantim i garuesëve dhe meqeve	20:00	Sheshi i Qytetit
E enjte 28 Korrik	TURNIR I VOGËL NË FUTBOLL TË VOGËL Aktivitet sportiv për mërgimtarë	18:00	Palestra e Sporteve
	KONCERT NË SHESH AKV “Kastriotët” (folklor, popullore dhe vallëzim)	20:00	Sheshi i Qytetit
E premte 29 Korrik	BOKS PROFESIONAL ME TITUJ BOTËRORË Turnir në boks	17:00	Palesta e Sporteve
E shtunë 30 Korrik	AKTIVITET ME BIÇIKLETA Defilim qytet-fshat	17:00	Sheshi i Qytetit
E diel 31 Korrik	HIKING Shoqëritë Bjeshtkatore & DKRS	07:00	Maja e Lubotenit
	“TINGUJT E ZEMRËS” (Aktivitet kulturor për mërgimtarë)	18:00	Qendra e Kulturës Fsh. Miroslav
E hënë 01 Gusht	EKSPOZITË E EKSPONATEVE MUZEALE Prezantim Muzeu i Qytetit – Forma vizuale (aktivitet pesë ditë)	11:00	Bulevard
E martë 02 Gusht	EKSPOZITË ME FOTOGRAFI “Ferizaj nëpër vite” nga Eqrem Ejupi	19:00	Bulevard
E mërkurë 03 Gusht	LOJËRA ELEMENTARE NË UJË Sektori i Sportit & Pishina Matoshi	17:00	Pishina Matoshi
	MBRËMJE FILMI	20:00	Sheshi Kadare
E Enjte 4 Gusht	PANAIRI I LIBRIT (04 - 06 Gusht) Klubi Letrar “De Rada”- Ferizaj	10:00	Sheshi i Qytetit
	KONCERT NË PIANO Vesa Berisha	19:00	Galeria e Arteve
E premte 05 Gusht	TURNIR NË VOLEJBOLL Aktivitet sportiv për mërgimtarë (dy gjinitë)	10:00	Palestra e Sporteve
	KONCERT NË SHESH Rock grupet ferizajase	20:00	Sheshi i Qytetit
E diel 07 Gusht	DITA TRADICIONALE “BJESHKËT E JEZERCIT” Shoqata “Jezerci”	11:00	Fshati Jezerc
E hënë 08 Gusht	KONCERT Mentor Haziri & Band	20:00	Sheshi i Qytetit
E Enjte 11 Gusht	FESTIVALI NDERKOMBËTAR I VALLEVE - “NEW BORN” Grupe vallesh nga shumë vende të botës	19:00	Sheshi i Qytetit

Manifestimi mbahet nën përkujdesjen e kryetarit të Komunës së Ferizajt, Agim Aliu.

Festivali Ndërkombëtar i Filmit FERFILM- Edicioni i 10-të

Ferfilm sivjet mbushi 9 vite themelimi me 10 edicione të realizuara. Festivali kishte karakter festiv në shënim të këtij jubileu.

Ekspozitë e fotografisë - Fahredin Spahija

Në Galerinë e Arteve në Ferizaj u hap ekspozita e fotografit të njohur në Kosovë e më gjerë Fahredin Spahija, me titull: “S’du me t’pa, du me t’ndie”

Jazz Koncert – Sheki Hoxha

Shefqet Hoxha- Sheki, si një prej rokërve më të njohur dhe më të vjetër në Kosovë e më gjërë, mbajti një koncert me muzikë jazz dhe blus në sheshin e qytetit.

Punëtori nga fusha e muzikës me pedagogen muzikore, Julia Tompkins

Julia Tompkins- Wagner është muziciante amerikane e cila jeton në Zvicër. Ajo ka sjellë donacione të shpeshta muzikore në Ferizaj. Kryesisht ka sjellë instrumente muzikore dhe sidomos piano klasike. Kësaj here solli dy piano klasike në Galerinë e Arteve. Gjatë qëndrimit tre ditë të saj, ajo bashkë me kolegen e saj, Janet Bouwmeester, organizuan një punëtori me pedagogët e lëndës së muzikës të shkollave të Ferizajt, si dhe dhanë një koncert në piano me vepra të njohura botërore.

Festivali i Karikaturës – Edicioni i 8-të

Shoqata e Karikaturistëve “HiTHi” organizoi edicionin e 8-të të Festivalit të Karikaturës. Sivjet festivali u mbajt në një format më të zgjeruar, duke organizuar punëtori, debate dhe organizime të tjera të kësaj fushe.

28 Shtatori- Dita e Dëshmorëve- Akademi Përkujtimore

Në sallën e Teatrit “Adriana” u mbajt akademi përkujtimore kushtuar 28 Shtatorit- Ditës së Dëshmorëve. Në program veç të tjerash, prezantoi Okteti i Qytetit.

28 Shtatori –Kolonia letrare “Ora e Astritit”

Ky aktivitet letrar tani e disa vite që mbahet në Ferizaj, organizohet nga Klubi Letrar “De Rada”- Ferizaj. Aktiviteti letrar ka karakter garues dhe mbahet në nderim të poetit dëshmor, Astrit Bytyçi.

1-7 Tetor - Festivali i Teatrove

Ngjarja më e madhe kulturore si dhe ngjarja më e vjetër në qytetin tonë “*Festivali i Teatrove*”- edicioni i 52-të, u mbajt si zakonisht në muajin Tetor. Frekuentuan qindra mysafirë, artistë nga trevat shqiptare, si dhe u dhanë shumë programe e performanca, krahas programit të rregullt.



FESTIVALI TEATRORE – FERIZAJ 2022

EDICIONI 52
1-7 TETOR

8 shfaqje

Mbi 200 artistë pjesëmarrës
2000 shikues

3 performanca të prodhuara nga FTF

15 artistë pjesëmarrës
250 shikues

2 punëtori

2 mentorë të angazhuar
40 pjesëmarrës

2 panele diskutimi

8 panelistë të angazhuar
40 pjesëmarrës

7 ndeja

17 performues muzike të angazhuar
Qindra artistë e qytetarë pjesëmarrës

2 shfaqje studentore

20 artistë të angazhuar
200 shikues

Muzat e Jezercit

“Muzat e Jezercit” është koloni letrare tre ditore që mbahet prej disa vitesh në Jezerc të Ferizajt e që organizohet nga Klubi Letrar “De Rada”. Në këtë edicion, përkushtim të veçantë iu bë poetit të ndjerë me përmasa botërore, Xhevdet Bajraj, i cili ndërroi jetë vitin e kaluar.

Promovim libri nga Nazmi Hajdari “Këngët e lirisë”: Ky libër është përmbledhje me këngë të shkruara e të kënduara nga rapsodi ferizajas, Nazmi Hajdari. Në promovim morën pjesë mysafirë nga treva të ndryshme dhe njohës të fushës së folklorit. Ndër ta, Prend Buzhala e Zymer Neziri.

Promovim libri nga Isak Guta

Shkrimtari ferizajas që jeton në mërgatë, Isak Guta, bëri një përmbledhje të krijimtarisë së tij me veprat e botuara viteve të fundit: “Rrëfim i vonuar” dhe “Vrasja e veprave”. Në këtë mbrëmje u shfaq edhe një dokumentar me veprimtarinë e tij kushtuar Aleksandër Moisiut.

Promovim libri nga Blerta Tmavaj “Fjalë shpirti”

Në sallën e Galerisë së Arteve u bë promovimi i librit me poezi të autores Blerta Tmavaj me titull: “Fjalë shpirti”. Morën pjesë mysafirë e kritikë nga Prishtina e Prizreni.

Promovim libri nga Ragip Kçiku “Historia e arsimit shqip -njerëz, ngjarje, shkolla”

Në sallën e Galerisë së Arteve u bë promovimi i librit monografik “Historia e arsimit shqip -njerëz, ngjarje, shkolla”. Në promovim të këtij libri voluminoz ishin mysafirë të shumtë, si dhe kritikë të fushës, të cilët folën për rëndësinë e këtij libri.

Nita Grubi - koncert në piano

Eliona Raqi – koncert në violinë

Promvim libri “Ndjellakeqi” – Hasan Vladi

Në Galerinë e Arteve u mbajt promovimi i librit “Ndjellakeqi” të autorit ferizajas, Hasan Vladi.

Festivali Kosovarja Këndon- edicioni i 50-të

Në vigjilje të Festës së Flamurit Kombëtar, në sallën e Teatrit “Adriana” u realizua edicioni i 50-të jubilar i festivalit më të vjetër të muzikës popullore shqipe në Kosovë: “Kosovarja Këndon”. Festivalin e përcolli orkestra e ansambli “Kastriotët” me formacion të zgjeruar. Udhëheqës artistik: Fitim Bytyçi.

Ekspozitë e fotografisë nga Eqrem Ejupi- Eqa – Kujtime nga Vlora 2012

Në vigjilje të Festës së Flamurit Kombëtar, u prezantua një ekspozitë me fotografi nga Eqrem Ejupi- Eqa. Vizita nga Komuna e Ferizajt më 2012 në Vlorë.

Ferizaj Piano Fest- edicioni i III-të

Ky festival me karakter garues nga interpretues të rinj, zhvillohet tash e disa vite në Ferizaj, nën udhëheqjen artistike të pianistes Ylberina Isufi. Këtë vit festivali u organizua në dy faza (27 qershor dhe 28 nëntor). Edicionin e madhështoi prezenca e dy pianisteve nga Shqipëria, me përmasa botërore: Fjorda Veizaj -piano si dhe Nereida Fico- solokëndim. U interpretuan vepra dhe këngë të autorëve tanë si P. Jakova, T. Harapi, S. Gjoni, N. Zoraci, F.Ibrahimi, E.Sina, K. Kono etj.

Promovim libri “Nëpër stinë” nga Arben Ademi

Ky promovim u organizua nga Klubi Letrar “De Rada” dhe u mbajt në sallën e Galerisë së Arteve.

Premierë teatrore “Lufta e Gruas”

Premiera e shfaqjes “Lufta e Gruas” me tekst të Ibush Arifit dhe në regji të Agim Selimit.

Muaji Dhjetor kryesisht u konsiderua si muaj i përmbylljes së aktiviteteve vjetore të shumë grupeve kulturore, organizatave të ndryshme kulturore, gjithashtu u mbajtën edhe disa aktivitete kulturore, trajnime, debate e iniciativa të tjera kulturore, kryesisht në Galerinë e Arteve- Ferizaj.

Bienali i Skulpturës në Ferizaj

Në Galerinë e Arteve në Ferizaj, u hap ekspozita “*Bienali i Skulpturës*”, e përgaditur nga Skënder Bedriu e Jetullah Sylejmani, ku u prezantuan punime të shumta artistike skulpturale nga treva të ndryshme shqiptare.

“Kësulkuqja”- shfaqje për fëmijë

Në fund dhjetori u dha premiera e shfaqjes për fëmijë “Kësulkuqja” si një tregim mitologjik për fëmijë, në regji të Sabri Pajazitit. Shfaqja vazhdon të jepet me repriza të shumta për shkollat fillore të qytetit e fshatrave.

Toskë e Gegë- stand up komedi nga Valdrin Osmani

Një prezantim i shkëlqyer i aktorit ferizajas Valdrin Osmani, me stand up komedinë e tij “Toskë e Gegë”.

Program kulturor-artistik AKV “Kastriotët” (grupi i folklorit)

Në kuadër të projektit pesë muajsh në kërkim të talentëve të rinj, ansambli prezantoi afro 30 fëmijë dhe të rinj të cilët kanë marrë pjesë në trajnime për interpretim me instrumente dhe këndim. Ju rikujtojmë se ansambli gjatë vitit 2022 prezantoi në shumë programe e festivale edhe jashtë qytetit të Ferizajt dhe thuajse kudo që shkoi, u kthye me suksese e shpërblime, si: “Festivali ballkanik - Kumanovë”, prezantim në Pogradec, Festivali i valleve dhe lojërave tradicionale, Festivali Ndërkombëtar SHAKA Kaçaniku, “Anadrinia jehon”, “Hasi Jehonë”, “Flakadani i Karadakut” etj.

Program kulturor-artistik për fundvit

Zakonisht në fundvit, konkretisht në përfundim të aktiviteteve vjetore, Sektori i Kulturës organizon një mbrëmje festive, ku veç të tjerash prezantohet edhe pasqyra e aktiviteteve vjetore të këtij sektori me njësitë e saj dhe me grupet kulturore. Poashtu në këtë mbrëmje shpallet edhe artisti i vitit aktual. Sivjet mbrëmjen argëtuese e shoqëroi grupi i mandolinistëve “Nostalgjikët”, ndërsa artisti i vitit u zgjodh muzikanti Fitim Bytyçi.

Viti 2022 ishte vit i arritjeve, rezultateve dhe sukseseve në organizim dhe prodhim të aktiviteteve kulturore. Në fillimvit, Sektori i Kulturës shtron një plan dhe një kalendar të aktiviteteve që planifikohen të mbahen gjatë vitit dhe shpesh në fund shohim se plani është tejkaluar me aktivitete shtesë.

Në bazë të analizës së raportit dalin këto rezultate:

Në Muzeun e Qytetit kishte **63 vizita grupe të organizuara** (nxënës, mësimdhënës, shkolla, kolegji etj), si dhe mbi 4000 vizitorë të Muzeut dhe aktiviteteve që ka organizuar kjo njësi.

Galeria e Arteve organizoi mbi dhjetëra aktivitete nga fusha e artit pamor, duke vazhduar me manifestimet tradicionale dhe aktivitetet e pavarura. Nga raporti mësojmë se në këtë vit Galeria kishte mbi **5000 vizitorë** dhe mbi dhjetë grupe të organizuara (nxënës, mësimdhënës, shkolla, kolegji etj)

Teatri i qytetit „Adriana“ vazhdoi me repertoarin e saj të rregullt, poashtu realizoi **pesë premiera teatrore**, organizoi Festivalin e Teatrove (edicioni 52), si dhe u kthye nga disa festivale me shpërblime.

Njësia e Kulturës, organizon edhe shumë aktivitete edhe të disiplinave të tjera, si: koncerte, takime letrare, festivale, manifestime kulturore etj. Vetëm në këtë vit numërohen afro njëqind aktivitete të këtij lloji.

Gjatë vitit 2022 janë organizuar **169 aktivitete kulturore** konkrete, pa përfshirë këtu vizitat e shumta, takimet dhe organizime të tjera të pavarura etj.

SEKTORI I RINISË

Spektori i Rinisë është dikaster që funksionon në kuadër të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit – Ferizaj e që merret me aktivitete rinore, takime edukative, kreative.

Krahas ngjarjeve të tjera të organizuara nga DKRS 2022, Spektori i Rinisë organizon dhe udhëheqë shumë aktivitete rinore me iniciativa të ndryshme.

Realizimi i projektit “Të rinjtë flasin”

Ky projekt u realizua me organizimin e katër takimeve të drejtpërdrejta me të rinjtë të cilët kanë shënuar suksese dhe në të njëjtën kohë janë pjesë e institucioneve arsimore, shëndetësore, institucioneve të sigurisë, fushës së sportit dhe fushës së IT-së.

Takimi i parë i realizuar ishte me Dr. Visar Haliti dhe Vlora Halili.

Visar Haliti doktor dhe profesor në Shkollën e Mesme të Lartë të Mjekësisë, vite më parë si aktivist dhe vullnetar ishte përfitues i aktiviteteve dhe projekteve të realizuara nga Spektori i Rinisë, gjithashtu ishte përfitues i klasës TOEFL organizuar nga njësi i aviacioni ushtarak amerikan dhe ishte në mesin e 10 (dhjetë) të rinjve që me suksese të larta e ka përfunduar testin e nivelit TOEFL.

Vlora Halili aktualisht studente e Universitetit të Prishtinës në Fakultetin e Mjekësisë së Përgjithshme. Këta dy të rinj i ndanë përvojat e tyre në aspektin profesional dhe angazhimit vullnetar në kuadër të Spektorit të Rinisë dhe organizatave të shoqërisë civile.

Aktivitetit “Të rinjtë flasin” iu dha hapësirë mediatike me pjesëmarrjen e dy panelistave të parë në Radio Kosova 2 në programin e mëngjesit “Mirëmëngjesi Kosovë” me gazetaren Valentina Kryeziu-Nazifi.

Ndërsa aktiviteti i dytë u realizua në oborrin e Teatrit “Adriana” me dy të rinj nga fusha e teknologjisë informative dhe fusha e sportit, Lirak Hamiti Drejtor i OJQ-së ROE, profesor në shkollën digjitale dhe Atdhe Haxhimusa, trajner ndërkombëtar i notit dhe aktualisht student në fakultetin e arkitekturës. Përvoja profesionale e këtyre dy të rinjve njëri ish aktivist dhe vullnetar i Spektorit të Rinisë dhe tjetri me përvojë të aktiviteteve në komunitet ishin nxitje dhe motiv për të rinjtë pjesëmarrës.

Aktiviteti i tretë u realizua në kuadër të agjendës së 19 Gushtit, Ditës së Rinisë, organizuar në bashkëpunim me MKRS. Panelist i këtij aktiviteti ishte kapiteni i Forcës së Sigurisë së Kosovës Arlind Bajrami, ish kryetar i Këshillit të Veprimit Rinor Lokal (KVRL) dhe aktivist e vullnetar shumëvjeçar i Spektorit të Rinisë. Synimi ynë në përfshirjen e tij në aktivitetin rinor ishte nxitje për rininë dhe grupet rinore. Krahas kësaj u bë hapja e ekspozitës kolektive nga punimet e vajzave dhe djemve pjesëmarrës në koloninë e artistëve dhe mbylla e Ditë së Rinisë me mbrëmje rinore/karaoke.

Aktiviteti i katërt dhe i fundit u realizua në kuadër të projektit të “Të rinjtë flasin” me dy vajza të suksesshme dhe aktualisht qëndrojnë për studime jashtë Kosovës, Selena Buzhala gjendet në Gjermani për studime në fushën e gjeografisë dhe shkencës hapësinore ndërsa Era Hamiti në Zvicër, për t’i vazhduar studimet në fushën e psikologjisë klinike. Të dyja vajzat janë model më i fuqishëm për t’i ndjekur. Takimi u mbajt në Bibliotekën e Qytetit. Projekti “Të rinjtë flasin” u mbështet nga Kompania “Metal Laçi”.

19 Gushti- Dita e Rinisë- Sektori i Rinisë në bashkëpunim me MKRS-në dhe organizatën ROE, shënuan Ditën e Rinisë në kuadër të agjendës Muaji i Rinisë. Shënimit të kësaj date në komunën tonë i parapriu vendosja e një agjende në bashkëpunim me Organizatën ROE e që kemi përfshirë hapjen zyrtare në lokacionin e Restaurant “Bifurkacioni”, me pjesëmarrjen e zyrtarëve nga MKRS, Njësitit LMT-së të KFOR-i amerikan, përfaqësues nga Kuvendi Rinor, struktura të tjera rinore si dhe mediat lokale.

Aktivitetet e organizuara ishin kryesisht në fushën e artit pamor (kolonia e artistëve) me përfshirjen e vajzave dhe djemve që kanë talente në fushën e artit, aktivitete sportive, me theks organizimi i lojërave në sportin e volejbollit dhe basketbollit në bashkëpunim me Klubin e Volejbollit për Meshkuj “Lybeteni”. Interesimi i të rinjve ishte i madh. E gjithë agjenda e realizuar u mbështet në aspektin financiar nga buxheti i planifikuar për shënimin e Muajit të Rinisë nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Tryeza e diskutimit me Komunitetin e Regjionit me temën: Aktivizmi rinor përmes Punës Vullnetare dhe vendimarrja e të rinjve.

Kjo tryezë u zhvillua me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga drejtoritë komunale për kulturë, rini dhe sport nga Regjioni i Ferizajt, përfaqësuesve nga sektoret e rinisë, qendrave rinore dhe me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga organizatat rinore, gjithashtu edhe njohësve të politikave rinore në nivel lokal e nacional.

Tryeza regjionale u zhvillua me panelistë nga tri komunitet z. Qëndrim Hoxha-CEO-LDA Balkan i cili kishte temë diskutimi temën: Sektori i Rinisë në Kosovë, fondet dhe qëndrueshmëria; z. Lirak Hamiti-drejtor ekzekutiv i OJQ-së ROE, i cili diskutoi mbi temën: Rëndësia e aktivizmit rinor, rrjetëzimi në Komunitetin e Regjionit dhe panelisti z. Visar Hasallari-Kryetar i Këshillit të Veprimit Rinor Lokal (Komuna Hani i Elezit) diskutoj mbi temën: Roli i KVRL-ve në organizimin e aktiviteteve në fushën e rinisë. Pjesë e tryezës regjionale ishin edhe zyrtarët e lartë nga Misioni i OSCE-s - zyra në Gjilan z. Faruk Dërmaku dhe z. Irfan Ukshini, të cilët edhe ishin mbështetësit kryesor në organizimin dhe realizimin e tryezës me karakter regjional, duke përfshirë edhe aspektin financiar.

Në fund të tryezës dolën një varg rekomandimesh për përmirësimin e situatës për Drejtoritë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, duke filluar nga përfshirja më e madhe në planifikimet e projekteve dhe aktiviteteve për rini, përfshirja më e madhe e të rinjve në ndarjen e buxhetit për rininë si dhe përmirësimin e praktikave në thirrjet publike për OJQ-të. Mbi dhjetë rekomandimet e dalura nga tryeza e diskutimit në formë zyrtare iu janë dërguar drejtorëve të Drejtorive për Kulturë, Rini dhe Sport. Në këtë takim prezent ishin: Përfaqësuesit nga Misioni i OSBE-së, përfaqësuesit e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit nga komunitet: Ferizaj, Shtime, Hani i Elezit, Kaçaniku, CEO-LDA Balkan, Sektori Rinor, OJQ ROE, Këshilli i Veprimit Rinor Lokal - Hani i Elezit.

Teknikat e karatesë

Projekti u realizua në bashkëpunim me Klubin e Karatesë “Lybeteni” dhe në koordinim me Drejtorinë e Arsimit, fokus ishin nxënësit nga dy shkolla: SHFMU “Ganimete Tërbeshi” dhe Gjymnazi Gjuhësor “Dr. Shaban Hashani”.

Në aktivitetin e realizuar në SHFMU “Ganimete Tërbeshi” kemi pasur edhe dy vajza të cilat janë kampione në nivel të garave evropiane dhe botërore për kategorinë e tyre të cilat për nxënësit pjesëmarrës kanë treguar për të mirat që sjellë sporti i karates.

Në Gjimnazin “Dr.Shaban Hashani” kemi pasur prezent edhe bashkëpunorët e Sektorit të Rinisë, ushtarakët e Njësitit të LMT-së KFOR-it amerikan të cilët kanë shprehur interesim të lartë në angazhimin tonë në pjesën e vetëdijesimit të nxënësve sa i përket sigurisë dhe mirëqenies së tyre.

Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Vullnetarizmit - 5 Dhjetor

Spektori i Rinisë, në bashkëpunim me Kuvendin Rinor dhe Këshillin Rinor të Kosovës organizoi një panel të diskutimit me përfaqësues nga institucionet rinore, znj.Dashurije Ahmeti nga Spektori i Rinisë, znj. Aolta Bajrami nga Kuvendi Rinor dhe z.Ditijon Fetahu nga Këshilli Rinor i Kosovës. Diskutimin e udhëhoqi Lorik Hashani student dhe përfaqësues nga Kuvendi Rinor.

Pjesëmarrës në diskutimin “Vullnetarizmi në Ferizaj” në sallën e Kuvendit të Komunës së Ferizajt ishin përfaqësues nga shoqëria civile, këshillat e nxënësve nga shkollat e mesme të larta dhe grupe joformale të të rinjve. Vlen të theksohet se nga i gjithë diskutimi i zhvilluar ishte një interesim i madh nga të rinjtë rreth strukturimit dhe përfaqësimit vullnetar në momentin e zhvillimit të aktiviteteve rinore dhe implementimit të projekteve rinore.

Klasa për mësimin e gjuhës angleze:

Vitin e kaluar gjatë komunikimit që kemi zhvilluar me pjesëtarët e Njësitit LMT-së të KFOR-it amerikan kemi arritur që të rikthejmë klasën fillestare për mësim të gjuhës angleze duke përfshirë në fazën e parë gjithsej katër shkolla me gjithsej 20 (njëzetë) nxënës.

Shkollat përfituese janë SHFMU “Bilall Shala” Lloshkobare, SHFMU “Ali Hadri” Mirash, SHFMU “Riza Matoshi” Nikadin dhe SHFMU “Tefik Çanga” Ferizaj. E gjithë vendosja e shkollave dhe vendi për zhvillimin e mësimin për gjuhën angleze ka ndodhur në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit dhe Drejtorinë e SHFMU “Tefik Çanga” ku është e vendosur klasa për arsye të mungesës së hapësirave.

Projekti 5-Ditë me KFOR-in

Në vazhden e bashkëpunimeve në mes të Sektorit të Rinisë dhe Njësitit LMT-KFOR-i amerikan, ishte edhe projekti *5-Ditë me KFOR-in*, ku janë zhvilluar gjithsej pesë aktivitete duke përfshirë me sa vijon: *Ligjëratën për Shëndetin mendor tek adoleshentët* e zhvilluar në shkollën e mesme të lartë të agrobiznesit “Zenel Hajdini” me dy doktorëshat: Tixhe Tahiri-Rexhepi dhe Anida Zyberi Fetahi, të ndihmuara nga eprorja e KFOR-it amerikan në Kampin Bonsteel.

Ligjëratat e dytë u zhvillua në SHFMU “Ahmet Hoxha” e që temë të diskutimit e kishte shëndetin oral tek fëmijët, e cila ligjëratë u zhvillua në bashkëpunim me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, respektivisht njësinë për edukim shëndetësor në kuadër të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, me doktorëshin stomatologjen e repartit Dr.Vlora Rushiti Jakupi si dhe teknikën e këtij reparti, Sabahate Bajrami.

Aktiviteti i dytë në kuadër të projektit ishte trashëgimia përmes syrit të të rinjve (fotografi dhe ekspozitë), ku kishte për qëllim nxjerrjen e fotografive përmes syrit të kamerave që të rinjtë dhe të rejtat e kanë pasion, ndërsa objektet të cilat u fotografuan ishin Pllaka përkujtimore, që shpreh shpërnguljen e ekzodit të popullit hebre, pastaj për të vazhduar tek Shtëpia e Gjon Serreçit, Kisha Ortodokse, Xhamia, Biblioteka e Qytetit “Sadik Tafarshiku”, Teatri i Qytetit, objektin e Shkollës Normale dhe për të përfunduar në pjesën e trashëgimisë natyrore, fenomeni i lumit Neredime. Me fotografitë e realizuara, u përgatitë ekspozita me fotografi në SHFMU “Jeronim De Rada”.

SEKTORI I SPORTIT

Spektori i Sportit është dikaster i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ku zhvillohen aktivitetet sportive dhe përkujdesjes për jetën sportive institucionale në Komunën e Ferizajt.

Bashkë me stafin e këtij sektori dhe komunitetin sportiv, realizohen dhe organizohen dhjetëra aktivitete sportive gjatë gjithë vitit. Aktivitetet kryesisht realizohen në Palestrën e Sporteve “Bill Clinton”, në Stadiumin e Qytetit, si dhe në hapësirat tjera të përshtatura për aktivitete.

Në raportin vjetor, fillimisht po japim gjeneralet e klubeve sportive të vitit 2022 ku janë të përfshirë 55 klube sportive dhe 4 shoqata të organizuara mirë në zhvillimin e sportit në Komunën e Ferizajt.

Në të gjitha klubet sportive janë të përfshira në të dy gjinitë me të gjitha grupmoshat duke u përfshirë nga grupmosha U7 deri tek seniorët, çka do të thotë se në komunën tonë kemi diku rreth 4500 sportistë aktiv, dhe diku rreth 6500 sportistë rekreativ.

Gjatë vitit 2022 Drejtoria është munduar që t’i riorganizoj kryesitë e klubeve aty ku kishte nevojë dhe ka krijuar 5 klube të reja sipas nevojave dhe kërkesave.

Në komunën tonë kemi 55 klube sportive, 4 shoqata sportive të cilat aktivitetin e tyre e zhvillojnë në një hapësirë sportive prej 43,421 m².

Stërvitjet e realizuar gjatë vitit 2022

Pallati i Sporteve “Bill Clinton”

Në Pallatin e Sporteve në Ferizaj gjatë vitit 2022 janë realizuar gjithsej 2396 orë ekonomike, stërvitje. Shfrytëzues të Palestrës, kryesisht janë klubet sportive të Komunës së Ferizajt.

Lojë Kampionale

Në Pallatin e Sporteve “Bill Clinton” janë realizuar gjithsej 103 lojë kampionale, 12 lojë për Kupë, 6 lojë miqësore dhe 2 lojë ndërkombëtare.

Stadiumi i Qytetit

Në stadiumin e qytetit në Ferizaj janë realizuar 1524 orë ekonomike, stërvitje, 148 lojë kampionale, 5 lojë për Kupë dhe 20 lojë miqësore.

AKTIVITETE SPORTIVE

Shpallja e Sportistit të Vitit

Këshilli i pavarur i formuar nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ka bërë grumbullimin e rezultateve, si në sportet kolektive poashtu edhe në sportet individuale dhe pas përfundimit të garave, ka filluar poentimin e më të mirëve në sportin ferizajas. Në Janar të vitit 2022, u organizua ceremonia e shpalljes së Sportistit të vitit 2021, ku u shpallën rezultatet për më të mirët në sportin ferizajas. Festim Mustafa nga Klubi i Hendbollit “Kastrioti” – Sportisti i vitit 2021. Komisioni i pavarur i formuar nga DKRS-ja ka vazhduar punën në përcjelljen e sukseseve edhe gjatë vitit 2022.

Mbajtja e kuvendeve të rregullta për gjitha klubet dhe shoqatat sportive

Spektori i Sporteve përcjellë punën e vazhdueshme të klubeve dhe poashtu kujdeset për mbarëvajtjen e punëve të kuvendeve të organizuara nga klubet sportive. Gjatë vitit 2022 me dhjetëra klube, mbajtën kuvendet e rregullta e që për aspektin ligjor dhe mbarëvajtjen e punëve u kujdes Spektori i Sportit.

Takim me KOK-un për organizimin e sportit ferizajas

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Ferizaj, realizoi takime të përbashkëta edhe me Komitetin Olimpik të Kosovës, por ky takim kishte theks të veçantë bashkëpunimin dhe koordinimin mes KOK-ut dhe Sektorit të Sportit.

Kampi Veror Multietnik i Tenisit 2022

Kampingu i tenisit ishte i organizuar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë në bashkëpunim me Komunën e Ferizajt. Organizimi i kampit në tenis ishte i pari i këtij lloji në Ferizaj, ku përfituan grupmoshat e reja në këtë lloj të sportit.

Turneu në Volejboll - Institucionet e Komunës së Ferizajt (femrat) – Tashmë është bërë tradicional ky aktivitet, ku gratë e institucioneve garojnë për ekipet më të mira nga institucionet që përfaqësojnë ato, në sportin e volejbollit.

Dita Ndërkombëtare e Sportit për Zhvillim dhe Paqe

Gara sportive - organizoi DKRS-Ferizaj dhe KOK-u për nder të Ditës për Zhvillim dhe Paqe.

Boks Profesional me titujt botëror

Në kuadër të manifestimit “Ditët e Mërgatës” është mbajtur turnir me bokser profesional me titujt botëror, ku prezantimi i garuesve u realizua në sheshin e qytetit, ndërkaq turniri u mbajt në Palestrën e Sporteve “Bill Clinton”. Ky aktivitet u realizua nga Fides Sport e Gjermanisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Turneu memorial në ping-pong

Klubi i Pingpongut “Ahmet Hoxha” dhe DKRS organizuan turneun memorial në pingpong me pjesëmarrjen e shumë klubeve, ku u shpërblyen tri vendet e para me kupa dhe medalje. Turneu memorial “Ahmet Hoxha” në Ferizaj, organizohet në nderim të jetës, veprës dhe sakrificës së veprimtarit të çështjes kombëtare, Heroit të Kosovës, Ahmet Hoxha.

Gara në Automobilizëm

Në organizimin e Federatës së Automobilizmit dhe DKRS-së u mbajt Kampionati në Automobilizëm ku morën pjesë një numër i madh i garuesve nga gjitha klubet e Kosovës të cilat zhvilluan garat në disa kategori të ndryshme në të dy gjinitë. Organizatori tri vendet e para i shpërbleu me kupa dhe mirënjohje.

Dita Olimpike në Ferizaj

Kjo ngjarje e veçantë sportive u organizua nga Komiteti Olimpik i Kosovës – Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe bashkëpunuan në organizim me Drejtorinë e Arsimit. Fëmijë të shumtë të lindur në vitin e shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, zhvilluan garën në vrapim. Fituesit dhe pjesëmarrësit u shpërblyen me kupa dhe medalje.

Garat shkollore lokale dhe regjionale

Në Pallatin e Sporteve u organizuan garat shkollore, komunale dhe regjionale për shkollat fillore dhe të mesme, në dy gjinitë ku morën pjesë të gjitha ekipet nga shkollat e komunës sonë, si dhe ekipet nga Komuna e Shtimes, Lipjanit, Kaçanikut, Shtërpçës dhe Hanit të Elezit. Edhe në këtë garë tri vendet e para u shpërblyen me medalje dhe kupa si dhe dy vendet e para fituan të drejtë të marrin pjesë në garën finale që mbahet në Prishtinë.

Lojërat elementare me KFOR-in Amerikan

DKRS-ja në bashkëpunim me KFOR-in Amerikan kanë organizuar lojëra elementare në Palestrën e Sporteve “Bill Clinton”, me grupmosha të reja.

Debat me klubet sportive

Klubet sportive njoftohen për rolin e Këshillit Kombëtar për Parandalimin dhe Sanksionimin e Dhunës dhe Dukurive Negative në Sport. Pjesë e këtij takimi ishte Besim Kelmendi UD i Kryeprokurorit të Shtetit, njëherit Kryetar i Këshillit Kombëtar, Gazmend Hoxha Drejtor i Departamentit të Operacioneve në Policinë e Kosovës, anëtar i Këshillit Kombëtar, Fatmir Kabashi përfaqësues nga MKRS, anëtar i Këshillit Kombëtar dhe Mehdi Uka sekretar i Këshillit. Kryetari i Këshillit Kombëtar, Besim Kelmendi, i cili i njoftoi kryesitë dhe përfaqësuesit e klubeve ferizajase rreth rolit të Këshillit Kombëtar, detyrimet e klubeve për zbatueshmërinë e ligjeve për dukuritë negative në sport. Klubet sportive u njoftuan për obligimet e klubeve sportive dhe detyrimet dhe marrëveshjet në mes klubeve dhe Policisë.

Projekti “Gardianët e barazisë”

Me një tryezë të organizuar nga DemSport -Demokraci përmes Sportit, i cili është projekt që punon për të ndërgjegjësuar gratë për rëndësinë e aktivitetit fizik në mirëqenien e vajzave dhe grave. Gjatë mbajtjes së tryezës me përfaqësues edhe nga DKRS-ja dhe DemSport, u shpalos raporti i hulumtimit me të gjetura për pjesëmarrjen e grave në aktivitete fizike.

Organizimi i të gjitha stërvitjeve dhe lojërave kampionale në Palestër dhe Stadium

Sektori i Sportit në Ferizaj, ka një kujdes të veçantë me gjithë kapacitetet logjistike dhe infrastrukturën fizike për të krijuar kushte sa më të mira për mbarëvajtjen e stërvitjeve dhe garave kampionale, që mbahen në objektet sportive- publike gjatë gjithë vitit.

Sektori i Sportit, organizon edhe shumë aktivitete të tjera, në bashkëpunim me klubet sportive dhe komunitetin e sportit në Ferizaj si: Kompletimi i dokumentacionit, vizita, takime zyrtare, aktivitete të rëndomta e që shumë prej tyre nuk janë të përfshira në këtë raport.

Raporti përmban në përgjithësi aktivitete të cilat organizohen me kontributin e Sektorit të Sportit, pa përfshirjen e punëve të përditshme që bëhen në objekte sportive për të siguruar kushte për klubet sportive. Në raport nuk janë të përmbledhura aktivitetet e klubeve dhe aktivitetet e pavarura sportive.

TË ARRITURAT NË SPORT PËR VITIN 2022

Sporti ferizajas ka shënuar të arritura dhe suksese si në sportet kolektive poashtu edhe në sporte individuale. FC FERIZAJ është në Superligën e Kosovës, poashtu Klubi i Futbollit “Dinamo” ka arritur suksese të vazhdueshme në çdo lojë që është zhvilluar në Ligën e dytë të Kosovës.

Klubet e Volejbollit “Fer Volley” F, “Ferizaj” M, “ “Luboteni” M, janë në Superligën e Kosovës.

Ndërsa sa i përket sporteve individuale, qyteti i Ferizajt qëndron më së miri në sportin e karatesë, KK “Sharri”, KK “Kastrioti” dhe KK “Fituesi” janë klubet që përmes garuesve të tyre , qytetit të Ferizajt po i sjellin tituj kampioni si në garat vendore poashtu edhe në garat ndërkombëtare. Sukseset janë të theksuara edhe në sporte tjera individuale, si në vijim: Sportin e pingpongut, shahut, boksit, xhudoja, noti etj.

SEKTORI I BIBLIOTEKAVE

Spektori i Bibliotekave është pjesë e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, që në kuadër të saj përfshihen: Biblioteka e Qytetit dhe bibliotekat nëpër fshatra (Talinoc i Muhaxherëve, Neredime dhe Dardani). Biblioteka e Qytetit organizon edhe aktivitete kulturore e manifestime të tjera.

Statistika:

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor, në Sektorin për Fëmijë u anëtarësuan 1592 lexues me 14952 libra të lexuara. Ndërsa në Sektorin për të Rritur u anëtarësuan 1539 lexues me 7681 libra të lexuara.

Gjithsej: **3131 lexues**

Gjithsej: **16633 libra të lexuara**

Sallën e leximit e frekuentuan 6618 lexues dhe sallën e informatikës 618 lexues.

Në bibliotekë u inventarizuan 2242 libra.

Në bibliotekën e fshatit Talinoc i Muhaxherëve u anëtarësuan 107 lexues me 685 libra të lexuara.

Në bibliotekën e fshatit Komogllavë u anëtarësuan 243 lexues, me 966 libra të lexuara.

Në bibliotekën e fshatit Dardani u anëtarësuan 43 lexues me 93 libra të lexuara.

Në bibliotekën në Neredime u anëtarësuan 298 lexues me 1108 libra të lexuara.

Gjithsej: 691 lexues me 2852 libra të lexuara.

Përveç punës së zakonshme që bënë ky Sektor (përkujdesjen ndaj lexuesve), gjithsesi jemi pjesë e shumë organizimeve kulturore me vetiniciativë.

Aktivitetet

17 Shkurt u hap ekspozita me titull “Heronj të luftës, heronj të penës”, ku u ekspozuan librat e autorëve dëshmorë e martirë. Po ashtu u zgjodhën edhe lexuesit më të mirë të vitit 2021.

7 Mars u promovua libri tri pjesësh “*Shkolla në xhungëll*” i autores Tahire Berisha Abazi. Autorja dhe lexuesit bashkëbiseduan rreth librit.

27 Prill - U promovuan librat e shkrimtarit martir Ymer Elshani. Prezent ishte edhe e bija e të ndjerit Teuta Elshani.

Shtator u promovuan librat e autorit, Muharrem Blakajt.

28 Nëntor, u hap ekspozita me libra historik.

Dhjetor – U zgjodh lexuesi më i mirë i vitit, dhe u hap ekspozita me libra të autorëve ferizajas

ARKIVI HISTORIK

Arkivi Historik Komunal përfshinë territorin e Komunës së Ferizajt dhe vepron si njësi në kuadër të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Gjatë vitit 2022, kjo njësi ka vazhduar punët e mbetura nga viti paraprak, duke i grumbulluar, evidentuar dokumentacionin arkivor.

Dokumentacioni arkivor që gjindet në arkiv është përpunuar detajisht dhe profesionalisht dhe është vendosur në vendin adekuat sipas numrit dhe llojit të lëndës.

Gjatë vitit 2022 në Arkivin Historik kemi pasur gjithsej 117 qytetarë që i kemi shërbyer duke i respektuar kornizat ligjore, duke ju shërbyer me material arkivor dhe dokumentacione personale që ata kanë kërkuar nga ne.

Gjatë këtij viti kemi bërë ndarjen e materialit arkivor në Drejtoritë përkatëse, sipas shenjave dhe numrit të lëndëve. Gjatë vitit 2022 në kryerjen e punës në Arkivin Historik jemi përcaktuar sipas kësaj veprimtarie:

1. Ndarja dhe përcaktimi i dokumentacionit arkivor dhe lëndës arkivore;
2. Klasifikimi i lëndës arkivore në fonde;
3. Formimi dhe kompletimi i dosjeve në fonde;
4. Sistematizimi i lëndëve arkivore në fonde;
5. Mbrojtja teknike.

1. Përpunim i Fondit Komisioni informues dega LDK Ferizaj 1995/96
2. Përpunim i Fondit Universiteti i punëtorëve daktilografisë (1994-1993)
3. Përpunim i Fondit Social dhe i punësimit të viteve 1977 - 1980
4. Përpunim i Fondit të Ndërtesave të shkollave (Tefik Çanga, Gjon Serreçi etj)
5. Përpunim i Fondit Mbrojtje dhe siguri (1971-1979)

Përfundimi

Në raport nuk janë të përfshira shumë aktivitete të pavarura, ose punë të rëndomta të artistëve, sportistëve dhe të rinjëve (prova, aktivitete të lira), si dhe shumë aktivitete që kanë shfrytëzuar objektet publike të DKRS-së.

Një version i këtij raporti, me një format më të zgjeruar dhe ilustrim me fotografi, për referenca të mëtutjeshme, gjendet në arkivat e DKRS-së.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2022

Kemajl Emini
Drejtores e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, paraprakisht ka bërë një analizë dhe vlerësim të përgjithshëm të punëve dhe aktiviteteve në vitin paraprak, me qëllim të identifikimit të të gjitha sfidave që do të merren si bazë në përcaktimin e objektivave kryesore për vitin 2022, për të dy sektorët – Sektori i Shëndetësisë dhe Sektori i Mirëqenies Sociale.

SEKTORI I SHËNDETËSISË

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ka vlerësuar si të domosdoshme mbajtjen e takimeve konsultuese me strukturat udhëheqëse të QKMF-së, Këshillin Drejtues, Këshillin Profesional si dhe udhëheqës të njësive për përcaktimin e objektivave.

Konkluzion i përbashkët ishte se bazë e përcaktimit të objektivave për vitin 2022, do të jetë buxheti që kemi, duke u fokusuar në objektivat më të domosdoshme në Kujdesin Parësor Shëndetësor që drejtpërsëdrejti do të reflektonin në nivelin e ngritjes së cilësisë së shërbimeve shëndetësore për një mirëqenie shëndetësore më të mirë për qytetarët tanë.

Objektivat e Sektorit të Shëndetësisë për vitin 2022

- Ngritja e disiplinës dhe përgjegjësisë në punë (permanente)
- Ushtrimi i vazhdueshëm i kontrollit të brendshëm që do të reflektoj në ngritjen e nivelit të shërbimeve shëndetësore dhe llogaridhënies
- Implementimi i projekteve kapitale për vitin 2022
- Ngritja e aktiviteteve në kuadër të ofrimit të shërbimeve shëndetësore
- Sensibilizimi për specializime në Mjekësi Familjare si kuadro deficitare për Kujdesin Parësor Shëndetësor
- Avancimi profesional specifik për mjekët familjar ekzistues
- Ngritja e aktiviteteve të Njësive së Edukimit dhe Promovimit Shëndetësor
- Furnizimi me pajisje mjekësore dhe pajisje të tjera
- Renovimi dhe mirëmbajtja e objekteve shëndetësore
- Mbajtja e takimeve të rregullta zyrtare me karakter pune mes DSHMS-së, QKMF-së, QPS-së dhe Shtëpisë me Bazë në Komunitet
- Promovimi i shëndetit të gruas dhe fëmijës
- Vazhdimi i vizitave sistematike në shkollë dhe çerdhe, analiza e rezultateve dhe marrja e veprimeve për përmirësim
- Edukimi i stafit për trajtimin e diabetit dhe shputës diabetike
- Angazhimi në përfitimin e donacioneve për projekte dhe investime kapitale nga organizatat ndërkombëtare, qofshin ato qeveritare apo jo qeveritare, dhe rritja e bashkëpunimit me OJQ-të vendore.

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022, Sektori i Shëndetësisë i DSHMS-së, pas përcaktimit të planit dhe objektivave, është angazhuar maksimalisht për të qenë çdo herë në përputhje me planin e punës, duke bërë përcaktimin e objektivave periodike si ato tremujore, gjashtëmujore, nëntëmujore, po ashtu edhe ato përfundimtare. Vazhdimi i pandemisë Covid 19 në muajt e parë të vitit ka ndikuar në rrjedhën e përgjithshme të punës, megjithatë, krahasuar me vitet paraprake gjatë vitit 2022 situata ka qenë shumë më stabile dhe numri i rasteve me Covid 19 ka shënuar rënie të dukshme, gjë që ka krijuar mundësinë e zhvillimit më të mirë të angazhimeve sipas planit dhe objektivave të punës për këtë vit.

- **Ngritja e disiplinës dhe përgjegjësisë në punë dhe ushtrimi i vazhdueshëm i kontrollit të brendshëm**

Ushtrimi i kontrollit të brendshëm është objektiv i yni që ka për qëllim ngritjen e përgjegjësisë, disiplinës në punë dhe llogaridhënies. Gjatë ushtrimit të këtij kontrolli asnjëherë nuk kemi qenë tolerant ndaj të papërgjegjshmëve dhe kemi kërkuar nga menaxhmenti i QKMF-së që çdoherë të ndërmerren veprime ndaj kujdoqoftë që nuk respekton orarin dhe disiplinën në punë.

- **Ngritja e aktiviteteve në kuadër të ofrimit të shërbimeve shëndetësore**

DSHMS si prioritet ka rritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore kundrejt qytetarëve tanë, konsiderojmë se niveli i kënaqshmërisë së qytetarëve është i mirë dhe çdoherë i kushtojmë vëmendje çdo ankese të palëve që cenon nivelin e shërbimit.

- **Sensibilizimi për specializime në Mjekësi Familjare si kuadro deficitare për Kujdesin Parësor Shëndetësor**

Në bazë të hulumtimeve dhe në konsultim me menaxhmentin e QKMF-së vlerëson si domosdoshmëri rritjen e numrit të mjekëve familjar duke marrë përbazë numrin e përgjithshëm të banorëve të komunës sonë dhe me prioritet do t'i trajtojmë Specializime të Kujdesit Parësor Shëndetësore.

- **Avancimi profesional specifik për mjekët familjar ekzistues**

Ngritja profesionale kadrovike çdoherë ka qenë dhe do të jetë prioritet i yni është një kriter esencial që ndikon në ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore.

Në bazë të raporteve që kemi nga Qendra Trajnuese e Mjekësisë Familjare gjatë vitit 2022 në përputhje me planin dhe programin e edukimit specialistik në mënyrë të vazhdueshme bëhen trajnime në ngjitjen profesionale shëndetësore ku janë zhvilluar shumë aktivitete – punëtori me mjek familjar, mjek të përgjithshëm si dhe infermier që punojnë në kuadër të QKMF-së Ferizaj.

- **Ngritja e aktiviteteve të Njësisë së Edukimit dhe Promovimit Shëndetësor**

Njësia e Edukimit dhe Promovimit Shëndetësor ka zhvilluar shumë aktivitete promovuese edukative për përmirësimin e shëndetit të popullatës ku janë mbajtur shumë ligjërata nëpër shkolla.

- **Furnizimi me pajisje mjekësore dhe pajisje të tjera**

Furnizimi me pajisje mjekësore dhe pajisje tjera është bërë në bazë të kërkesave nga njësitë kryesore pranë QKMF-së.

- **Renovimi dhe mirëmbajtja e objektivave shëndetësore**

Renovimi dhe mirëmbajtja e objekteve shëndetësore është në kontinuitet dhe çdo herë intervenimet bëhen sipas nevojës ku paraprakisht bëhet një vlerësim i infrastrukturës së objekteve shëndetësore nga ana e kompetentëve të QKMF.

- **Mbajtja e takimeve të rregullta zyrtare me karakter pune mes DSHMS-së, QKMF-së, QPS-së dhe Shtëpisë me Bazë në Komunitet**

Mbajtja e takimeve të rregullta zyrtare me karakter pune mes DSHMS, QKMF dhe SHBK me ngecje mendore ka për qëllim njohjen e më përsëafërmi me zhvillimet dhe aktivitetet si dhe me sfidat me të cilat ballafaqohen për të gjetur forma dhe mënyra të rrugëzgjdhjes.

- **Promovimi i shëndetit të gruas, fëmijës**

Në kuadër të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare funksionon Qendra për Shëndetin e Gruas dhe Fëmijës që është në mbështetje për gratë që nga fillimi i shtatëzanisë deri pas lindjes që është një hap i rëndësishëm progresiv për shëndetin e nënës. Ky shërbim ka një rëndësi të veçantë në parandalimin e sëmundjeve të ndryshme si dhe në identifikimin e hershëm të sëmundjeve.

- **Edukimi i stafit për trajtimin e diabetit dhe shputës diabetike**

Shërbimi për trajtimin e diabetit është shërbim që funksionon në kuadër të QMF-së II, që nga viti 2011, si shërbim preventiv dhe shërues në kuadër të KPSH-së.

Ky shërbim tani ka formuar grupet vetëmbështetëse me prindërit e fëmijëve me diabet që ka për qëllim edukimin e pacientëve dhe mbështetjen nga grupi. Me qëllim të ruajtjes së vazhdimësisë së këtij shërbimi stafi i trajnuar bart përvojat e mira tek stafi i ri shëndetësor për ruajtje të kontinuitetit të këtij shërbimi teje të rëndësishëm.

- **Angazhim në përfitimin e donacioneve për projekte dhe investime kapitale nga organizatat ndërkombëtare, si me ato qeveritare apo jo qeveritare, dhe rritja e bashkëpunimit me OJQ-të vendore.**

Gjatë vitit 2022 në DSHMS, respektivisht Sektorin e Shëndetësisë, angazhim permanent ishte që zhvillimi i politikave shëndetësore konform infrastrukturës ligjore në fuqi që rregullon sferën e Kujdesit Parësor Shëndetësor duke qenë të përkushtuar në ndërmarrjen e veprimeve për një funksionalizim të mirëfilltë të QKMF-së, QMF-ve AMF-ve me të vetmin qëllim që qytetarëve tanë t'u ofrohen shërbime sa më dinjitoze dhe cilësore.

Jemi të vetëdijshëm se edhe përkundër përkushtimeve tona mbetet ende për tu bërë dhe angazhimi jonë do të jetë i përhershëm edhe përkundër që shpeshherë po përballemi me sfida jo të tejkalueshme si furnizimi jo i mjaftueshëm me barna esenciale nga Ministria e Shëndetësisë dhe jemi angazhuar të gjejmë alternativa tjera që nga të hyrat nga participimi të furnizohemi me barna esenciale që sado pak t'i mbështesim qytetarët tanë.

Një sfidë e vazhdueshme është mungesa e ligjit mbi sigurime shëndetësore që pamundëson një sistem të mirëfilltë shëndetësor.

DSHMS është transparente për punë dhe aktivitete që zhvillon kundrejt hierarkisë institucionale lokale dhe qendrore si dhe ndaj qytetarëve. Pasqyrim i transparencës është se në vazhdim të këtij raporti do të bashkëngjesim raportin njëvjeçar të QKMF-së.

RAPORT PUNE QKMF

Shkurtesat

AMC – Action for Mothers and Children

AMF – Ambulanca e Mjekësisë Familjare

AMFK - Asociacioni i Mjekëve Familjar të Kosovës

CDF – Community Development Fund

DAT - Dispanseri Antituberkular

DSHMS - Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

DMF – Departamenti i Mjekësisë Familjare

ESP - Edukimi Specialistik Postdiplomik

EVP - Edukimi i Vazhdueshëm Profesional

IKSHPK – Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës

IRSHPK – Instituti Rajonal i Shëndetit Publik të Kosovës
KAN – Kujdesi Antenatal
KD – Këshilli Drejtues
KP – Këshilli Profesional
KPSH – Kujdesi Primar Shëndetësor
MSH - Ministria e Shëndetësisë
OBSh - Organizata Botërore e Shëndetësisë
OIK - Oda e Infermierëve të Kosovës
QKMF – Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
QMF – Qendra e Mjekësisë Familjare
QTMF – Qendra Trajnuese e Mjekësisë Familjare
QZHVP – Qendra për Zhvillim të Vazhdueshëm Profesional
MRCPG – Medical Royal College of General Practitioners
SISH - Sistemi Informativ Shëndetësor
SHEP - Shërbimi Emergjent Primar
UNHCR _ United Nations High Commissioner for Refugees
UNICEF - United Nations International Children's Emergency Fund
ZHVP - Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional

HYRJE

Personeli i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare e filloi vitin 2022 me angazhimet e nevojshme me qëllim të përmbushjes së obligimeve dhe detyrave të punës. Që në ditët e para të **vitet 2022**, puna filloi me ritmin e zakonshëm nëpër të gjitha QMF – të dhe AMF – të, për të vazhduar më tej me synim të intensifikimit. Si gjithmonë, përkushtimi ndaj organizimit të punës dhe eliminimi i ngecjeve eventuale, kanë qenë preokupim i vazhdueshëm i stafit menaxhues dhe hap imediat drejt përmbushjes së objektivave të paracaktuara për këtë vit, të cilat janë:

1. Menaxhimi i burimeve njerëzore.
2. Ngritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore dhe performancës në punë në KPSH.
3. Monitorimi i vazhdueshëm i standardeve bazike në KPSH.
4. Koordinimi i punëve në Edukimin dhe Zhvillimin e Vazhdueshëm Profesional.
5. Kujdesi për shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien në punë të të gjithë të punësuarve.

6. Angazhimi i vazhdueshëm në plotësimin e standardeve teknike dhe ngritja e performancës në punë në AMF të komunës sonë.
7. Funksionalizimi i laboratorëve nëpër QMF në fshatra.
8. Krijimi i një plan-strategjie për shtimin e numrit të specializantëve të rinj në Mjekësi Familjare.
9. Me përmirësimin e situatës epidemiologjike me Covid-19 të vazhdohet me zonimin dhe listimin e pacientëve, sipas kriterëve të përcaktuara nga grupi punues i angazhuar nga MSH.
10. Shtrirja e rrjetit të internetit në QMF dhe AMF në fshatra.
11. Implementimi i tërësishëm i SISH-it dhe programit të SMSF-së.

Aktivitetet dhe takimet

- **Më 24.01.2022** - Takimi në QMF 9 në Softaj me Drejtorin e DSHMS-së dhe përfaqësuesit e organizatës nga Katari.
- **Më 03.02.2022** - është mbajtur takimi me drejtorët e QKMF-ve, për programin e vizitave në shtëpi dhe kujdesin për nëna dhe fëmijë, i organizuar nga Divizioni i KPSH-së në MSH dhe Zyra e UNICEF-it për Kosovë. Është prezantuar raporti i punës të Vizitave shtëpiake për nëna dhe fëmijë deri në 3 vjeç në QKMF, për muajin janar 2022.
- **Më 04.02.2022** - Është aprovuar *Raporti i punës në QKMF për vitin 2021* i cili më pas është dorëzuar në DSHMS.
- **Më 10.02.2022** - Në Zyrën e drejtoreshës së QKMF-së u mbajt takimi me përfaqësuesen e Kryqit të Kuq të Ferizajt, znj. Jehona Kuqi, ku ka shprehur gatishmërinë e kësaj shoqate për të ndihmuar me vullnetarë procesin e vaksinimit anticovid në QKMF.
- **Më 24.03.2022** - Drejtori i DSHMS-së Dr.Kemajl Emini dhe zv.Drejtori i QKMF-së, Dr.Afrim Abazi, në shenjë falënderimi për kontributin e dhënë në pajisjen e laboratorit të DAT-it me aparaturë moderne, kanë nderuar me mirënjohje Dr.Majlinda Gjocaj- Koorditore e Programit Kombëtar të Kontrollit të Tuberkulozit dhe Lulzim Çela-Menaxher i Programit të Tuberkulozit. Përveç aparaturës Genexpert IV R2 Module, janë siguruar edhe inventari, pajisjet përcjellëse si dhe kabineti i sigurisë për mbrojtje në vendin e punës nga kontaminimi me bacile të TB.
- **Më 25.03.2022** - pjesëtarë të ekipit Ndërlidhës Komunikues K 21 të KFOR-it Amerikan për Rajonin e Ferizajt kanë vizituar QKMF-në, me qëllim të diskutimit të mundësisë së ofrimit të mbështetjes së QKMF-së nga ana e KFOR-it Amerikan.
- **Më 05.04.2022** - QKMF-në e ka vizituar Ministri i Shëndetësisë, Dr. Rifat Latifi, i shoqëruar nga Ministri për Bashkëpunim, Zhvillim dhe Çështje Humanitare i Qeverisë së Luksemburgut, z. Franz Fayot, shefja e Zyrës së UNICEF-it në Kosovë, znj. Nona Zicherman dhe zëvendësministrin, Dr. Arsim Berisha. Në fokus të kësaj vizite ishte ecuria e realizimit të programit për nëna dhe fëmijë 0-3 vjeç, për të cilin QKMF ishte një nga qendrat e para ku ky program filloi të implementohet, në vitin 2016, në bashkëpunim me UNICEF-in. Krahas fjalëve të rastit dhe prezantimit të ecurisë së programit të vizitave shtëpiake për shëndetin e nënës dhe fëmijës dhe raportet e punës, nënat që ishin të pranishme në këtë takim shprehen opinionet e tyre të mira në lidhje me këto vizita dhe falënderuan infermieret për ndihmën që kanë ofruar.
- **Më 15.04.2022** - Me ftesë të Akademisë “Ivodont” në Tiranë, një delegacion i QKMF- Ferizaj, të prirë nga zv. drejtori Dr. Afrim Abazi, kryeshefi Dr. Albert Sherifi, kryeinfermieri Selim Bega, si dhe një

pjesë e personelit të Laboratorit Dentar, vizituan këtë Akademi. Me këtë rast u njohën me metodat e punës dhe pajisjet e avancuara të teknikës dentare. Menaxhmenti i Akademisë "Ivodont" ofroi edhe mundësinë e bashkëpunimit afatgjatë mes dy institucioneve. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, brenda këtij viti, teknikët dentar nga QKMF-Ferizaj, do të kenë mundësinë e pjesëmarrjes në tri trajnime pa pagesë në "Ivodont", që do të udhëhiqen nga profesorë dhe profesionistë eminent ndërkombëtar.

- **Më 26.04.2022** - me iniciativën e IKSHPK-së, në kuadër të 'Javës evropiane të imunizimit', Shërbimi i vaksinimit në bashkëpunim me Balkan Sunflowers kanë mbajtur një aktivitet në fshatin Dubravë. Me këtë rast është bërë vaksinimi i fëmijëve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian.
- **Më 19.05.2022** - Për nder të Ditës Botërore të Mjekut Familjar, Drejtoresha e QKMF-së, Dr.Nadire Ymeri mori pjesë në takim në nivel vendi, organizuar nga Ministria e Shëndetësisë, që u mbajt në Hotel "Emerald" në Prishtinë. Ndërkohë, Dr.Drita Lumi-Demiri mbajti një ligjëratë në HandiKos, për personat me nevoja të veçanta mbi rolin që ka mjeku familjar në shëndetin dhe mirëqenien e qytetarëve. Një aktivitet tjetër u zhvillua edhe në Sheshin "Adem Jashari" të qytetit të Ferizajt, ku mjekët familjar ofruan shërbime dhe këshilla për qytetarët, si dhe shpërndanë fletëpalosje me informacionet e nevojshme lidhur me kujdesin që ofron mjeku familjar, shërbimet e shumta dhe rëndësinë që ka përzgjedhja e mjekut për tërë familjen. Aktivitetet përfunduan me ndarjen e mirënjohjeve post mortem, për Dr.Faik Rexhepin dhe Dr.Nezir Luzhën, për kontributin e ofruar në avancimin e Mjekësisë Familjare që nga filltet e saj në QKMF.
- **Më 30.05.2022** - Këshilli Drejtues mori vendim që të vazhdoj edhe për tre muaj marrëveshjen me NPL "Ambienti".
- **Më 31.05.2022** - në sallën e objektit të Kuvendit të Kosovës është mbajtur tryeza me temën *Zbatimi i konceptit të Mjekësisë Familjare - të arriturat dhe sfidat*, organizuar nga Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale i Kuvendit të Kosovës, kryesuar nga Dr.Fatmire Kollqaku. Në këta takim ishin të pranishëm edhe zv.Ministri i Shëndetësisë, sekretari i MSH, shefja e Divizionit të KPSH-së, deputetë, drejtorë të QKMF-ve, drejtorë të DSHMS-ve, përfaqësues të shoqatave për të drejtat e pacientëve etj. Në këtë takim, Drejtori i DSHMS-së ka reaguar lidhur me zvogëlimin nga Ministria e Financave të buxhetit të kërkuar nga MSH për QKMF-të, ndërsa Drejtoresha e QKMF-së, ka shtruar kërkesën për shtimin e stafin dhe buxhetit shtesë.
- **Më 07.06.2022** - Drejtoresha Dr. Nadire Ymeri, së bashku Drejtorin e DSHMS-së, Dr.Kemajl Emini, zv.drejtorin Dr.Afrim Abazi, kryeinfermierin Selim Bega, të shoqëruar nga dy konsulentët e jashtëm dhe zëdhënësin e kryetarit Aliu, z.Ajazi, z.Rexha dhe z.Marevci, pritën në takim përfaqësues të Ambasadës Japoneze të prirë nga zv.Sekretarja e Ambasadës Japoneze për Kosovë znj. Kurimoto Kay. Gjatë kësaj vizite mysafirët u informuan nga nikoqirët për sfidat, shërbimet shëndetësore që ofrohen në KPSH, me theks të veçantë në Shërbimin Emergjent Primar, si dhe nevojat për staf dhe pajisje mjekësore të domosdoshme për realizimin e shërbimeve mjekësore më cilësore.
- **Më 08.06.2022** - Drejtoresha e QKMF-së, Dr. Nadire Ymeri, bashkë me kryeinfermierin, Selim Bega, u takuan me infermieret të cilat merren me programin e Vizitave Shtëpiake për Nëna dhe Fëmijë 0-3vjeç, të kryesuar nga koordinatorja Haxhere Bërkolli. Në këtë takim nga të pranishmit u diskutua për sfidat me të cilat po ballafaqohen infermieret në kryerjen e këtyre vizitave. Në fokus të diskutimit ishte numri jo i mjaftueshëm i stafit, që paraqet vështirësi në zbatimin e këtij programi, që ka përkrahje e mbështetje gjithnjë më të madhe nga MSH, UNICEF-i dhe organizata të tjera ndërkombëtare humanitare. Gjithashtu, u diskutua edhe për rezultatet e arritura nga infermieret gjatë pandemisë Covid-19, veçmas gjatë pesë muajt e parë të këtij viti.

- **Më 15.06.2022** - Për nder të 15 Qershorit – Ditës së Shëndetësisë së Komunës së Ferizajt, punëtorët e QKMF-së, të udhëhequr nga zv.Drejtori, bënë homazhe te Varrezat e Dëshmorëve. Të njëjtën ditë, Kryetari i Komunës, z. Agim Aliu dhe Drejtori i DSHMS-së, Dr. Kemajl Emini, vizituan ekspozitën e organizuar për nder të “15 Qershorit - Ditës së Shëndetësisë Ferizajase” nga institucionet shëndetësore të komunës sonë dhe deputetët ferizajas të OIK-ut, me ç'rast në fjalët e rastit, veç tjerash i uruan mantelbardhët për këtë ditë dhe vlerësuan lartë punën e tyre. Në ekspozitë u prezantuan pamje të punës dhe aktivitetëve gjatë periudhës së pandemisë dhe pas saj. Ekspozita tjetër u organizua në Shpellën e Kusarit në Gjakovë.
- **Më 16 dhe 17.06.2022** - në Prishtinë është mbajtur punësoria dyditore në kuadër të programit "Vizitat në shtëpi për nënat dhe fëmijët nga 0 deri në 3 vjeç" të udhëhequr nga MSH, me mbështetjen e UNICEF-it dhe *Aksionit për Nëna dhe Fëmijë*. Në këtë punëtori u prezantuan të dhënat, raportet, ecuria e zbatimit dhe progresi i programit, si dhe diskutimi rreth planifikimit të buxhetit. Përballja me pamjaftueshmërinë e personelit u përmend si sfidë kryesore në realizimin e këtij programi, nga të gjithë drejtorët e QKMF-ve të pranishëm në këtë takim.
- **Më 30.06.2022** - në Hotel "Internacional" në Prishtinë, është mbajtur takimi i përbashkët i drejtorëve komunal për shëndetësi dhe drejtorëve të QKMF-ve, me qëllim të diskutimit të aktivitetëve që po zhvillohen në KPSH, përfshirë edhe vizitat në shtëpi.
- **Më 14.09.2022** - menaxhmenti i QKMF-së kryesuar nga drejtoresha dr. Nadire Ymeri , në Qendrën e Vaksinimit dhe në prani të stafit të saj, pritën në takim UD të shesheve të Imunizimit të IKSHPK-së epidemiologjen Dr. Fetije Fetaj, Administratoren e Lartë të IT nga MSH-së znj. Donika Gjigolli dhe Dr. Arbëresha Turjaka. Qëllimi i kësaj vizite ishte për të parë për së afërmi implementimin e SISH-it sipas Procedurave Standarde Operative për vaksinimin e rregullt në QKMF.
- **Më 28.10.2022** - në Galerinë e Arteve në Ferizaj u mbajt tryeza infermierore me temë "Të arriturat e punës ekipore të infermierisë ferizajase 2019-2022" e cila u mbajt nën patronatin e drejtorit të DSHMS - Ferizaj, Dr.Kemajl Emini në bashkëpunim me Drejtorinë e QKMF-së, Zyrën e Kryeinfermierit të QKMF dhe Zyrën e Drejtoreshës së Infermierisë së Spitalit të Përgjithshëm, delegatëve të OIK dhe koordinatorëve të EVP nga QKMF dhe SP.
- **Më 08.11.2022** - në Prishtinë u mbajt takimi i organizuar nga MSH me drejtorët e QKMF-ve dhe drejtorët e DSHMS-ve. Takimi kishte për qëllim diskutimin për: Buxhetin; Planifikimin e Barnave nga LEB dhe Rekrutimin e stafit në bazë të Grantit Specifik për Shëndetësinë Primare.
- **Më 16.11.2022** - Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me OSCE-në ka organizuar fushatë për vetëdijësimin e grave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, mbi shëndetin gjinekologjik, në disa komuna përfshirë edhe Komunën e Ferizajt. Në kuadër të kësaj fushate u mbajtën ligjërata në Lagjen Sallahane dhe në Qendrën Sociale Edukative në fshatin Dubravë. Ndërsa më 17 Nëntor, në lagjen "Halit Ibishi", ka qëndruar mamografi mobil dhe u është bërë mamografia grave të interesuara nga ky komunitet.
- **Më 16 dhe 17 nëntor 2022** - ekipet shëndetësore të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare zhvilluan vizita sistematike në shkollën “Jeronim De Rada”, me nxënës të klasëve të I-ra dhe të V-ta. Qëllimi i këtyre vizitave është vlerësimi i rritjes dhe zhvillimit psiko-fizik të nxënësve, zbulimi i sëmundjeve, anomalive, ç'rregullimeve, si dhe ndërmarrja e masave për trajtimin dhe korrigjimin e tyre. Për të vlerësuar gjendjen e përgjithshme të shëndetit të tyre, nxënësve u bëhen vizita nga mjeku familjar, stomatologu, fiziatru dhe oftamologu.

- **Më 22, 23 dhe 24 nëntor 2022** - u organizua trajnimi për menaxherët e institucioneve shëndetësore të Kujdesit Parësor, drejtorët e DSHMS-ve dhe menaxherët e QKMF-ve, të pesë komunave të rajonit të Ferizajt: Ferizaj, Kaçanik, Shtime, Shtërpçë dhe Hani i Elezit. Me këtë trajnim përfundoi moduli i gjashtë dhe i fundit. Qëllimi kryesor i trajnimit ishte rritja e njohurive dhe performancës së menaxherëve. Trajnimi është përkrahur nga organizata zvicerane AQH.
- Në Dispanserin Antituberkular, gjatë muajit nëntor, pas kompletimit me aparaturën e nevojshme për testimin Gen Expert, të siguruar nga CDF, ka filluar testimi për BK dhe rezistencën ndaj terapisë me Rimfampicin, testim ky tejet i rëndësishëm për të sëmurët me tuberkuloz.
- **Më 29.11.2022** - Menaxhmenti i QKMF-së priti në vizitë përfaqësues të KFOR-it Amerikan, të Komandës së re të Njësisë LMT në Kampin Ushtarak në Bonsteel të udhëhequr nga rreshteri Jarred Ball. Gjatë këtij takimi mysafirët u informuan për së afërmi me organizimin e punës në KPSH, infrastrukturën dhe resurset humane. Mysafirët shprehën gatishmëri për vazhdimin e mëtejshëm të bashkëpunimit me fokus mbështetjen e QKMF-së me pajisje mjekësore dhe trajnimin e stafit, të premtuara nga përfaqësuesit e komandës paraprake.
- **Më 02.12.2022** - Pas akreditimit të dy trajnerëve Dr.Drita Nazifi-Emini dhe Dr.Adnan Çoçaj nga MRCGP gjatë muajit tetor 2022, zyrtarisht të dy trajnerët e rinj iu bashkuan ekipit të trajnerëve të Qendrës Trajnuese të Mjekësisë Familjare në Ferizaj. Aktualisht grupi i trajnerëve është duke përcjellë vitin e dytë të specializantëve të Mjekësisë Familjare në programin e Edukimit Specialistik Postdiplomik.
- **Më 12.12.2022** - në Hotel "Emerald" është organizuar ngjarja për lansimin e Programit të Vizitave Shtëpiake për Nëna dhe Fëmijë në katër komuna të reja. Kjo ngjarje është mbështetur nga Zyra e UNICEF-it në Kosovë dhe Aksioni për Nëna dhe Fëmijë, realizuar përmes përkrahjes financiare të Qeverisë së Luksemburgut. Në këtë takim u diskutua edhe për: Fuqizimin e bashkëpunimit ndërinstitucional në zbatimin e Programit të Vizitave në Shtëpi; Informimin mbi grantin specifik të vizitave në shtëpi; Fillimin e punës në zhvillimin e instrumenteve për monitorimin e zhvillimit të fëmijëve, të cilat do të gjejnë zbatim në KPSH; Përfshirjen e pakos së trajnimit për vizitat në shtëpi në kurrikulat e programeve të infermierisë dhe mamisë në universitetet publike dhe private.
- **Më 20.12.2022** - në sallën e Kuvendit të Komunës së Ferizajt, është mbajtur konsultimi publik për Projekt-Statutin e QKMF-Ferizaj. Me këtë Statut rregullohen: dispozitat e përgjithshme, emërtimi dhe selia, veprimtaria e QKMF-së, statusi juridik, përfaqësimi dhe prezantimi, struktura e institucionit, udhëheqja dhe trupat e institucionit, zhvillimi i vazhdueshëm institucional, mbikëqyrja e QKMF-së, aktet e përgjithshme të QKMF, pronësia dhe financimi, transparenca në punë, konfidenca profesionale dhe afariste, organizimi sindikal, mbikëqyrja e brendshme dhe dispozitat kalimtare dhe përfundimtare lidhur me ushtrimin e veprimtarisë së KPSH-së. Vërejtje dhe sugjerime rreth Projekt-Statutit kanë dhënë të gjithë të pranishmit Drejtori i DSHMS-së, Drejtoresha e QKMF-së, Zëvendësdrejtori i QKMF-së, si dhe pjesëmarrësit të tjerë në këtë takim. Projekt-Statuti i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Ferizaj, do të jetë në konsultim publik deri më 5 janar të vitit 2023.
- **28.12.2022** - në "Holiday Resort"- Sllatinë e Madhe, është organizuar në tavolinë ushtrimi me të gjithë aktorët e përfshirë në Pakon Minimale Fillestare të shërbimeve (MISP) për Shëndet Seksual dhe Riprodhues (SHRS), specifikisht me të trajnuarit, profesionistët shëndetësor, duke përfshirë edhe drejtorët e QKMF-ve të disa komunave. Ushtrimi është udhëhequr nga përfaqësues të AME (Agjencia për Menaxhimin e Fatkeqësive dhe Emergjencave), MSH, UNFPA dhe Kryqi i Kuq i Kosovës.

- **Më 29.12.2022** - Kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, bashkë me Drejtorin e DSHMS-së, Dr. Kemajl Emini, vizituan Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Ferizaj. Me këtë vizitë kryetari falënderoi punëtorët shëndetësorë për angazhimin gjatë tërë vitit dhe i uroi për Vitin e Ri 2023. Në takimin e organizuar në QTMF drejtoresha Dr.Nadire Ymeri prezantoi një raport të shkurtër të punës dhe shërbimeve të ofruara, foli për sfidat që e kanë përcjellë personelin gjatë këtij viti dhe paraqiti objektivat për vitin 2023. Ndërkohë drejtoresha i dhuroi kryetarit Aliu një plaketë dhe drejtorit Emini një mirënjohje në shenjë falënderimi për mbështetjen e ofruar në vazhdimësi, ndaj menaxhmentit dhe punëtorëve të QKMF-së. Ndërsa, drejtori i DSHMS-së u dha mirënjohje menaxhmentit të QKMF-së, shefave të njësive dhe kryeinfermierëve, për kontributin që kanë dhënë punëtorët e njësive të tyre në shërbim të qytetarëve të Komunës së Ferizajt. Në këtë takim u përurua edhe numri i ri, numri 21 i revistës Kujdesi Shëndetësor që botohet nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare.

Numri i përgjithshëm i të gjitha shërbimeve shëndetësore në QKMF gjatë **vitet 2022** është **920 617**, nga të cilat **245 947** janë vizita mjekësore, **637 199** shërbime infermierike dhe shërbime të tjera, **37 471** janë shërbime stomatologjike.

TRUPAT PROFESIONALE TË QKMF – së KËSHILLI DREJTUES DHE ZYRA E DREJTORIT

Këshilli Drejtues si organi më i lartë i udhëheqjes së QKMF – së, gjatë **vitet 2022** ka mbajtur 29 mbledhje, për të cilat janë mbajtur rregullisht procesverbalet, që pas aprovimit janë protokolluar dhe ruhen në arkiv. Në këto mbledhje ndër temat kryesore që u shqyrtuan ka qenë menaxhimi i situatës epidemiologjike me Covid 19, procesi i vaksinimit antikovid, respektimi i orarit të punës, janë aprovuar listat e përfituesve të shtesës mujore për stafin shëndetësor dhe atë mbështetës të rrezikuar nga infektimi me COVID-19, janë diskutuar ndryshimet në Draft-Statutin e QKMF-së dhe çështje të tjera të lidhura me mbarëvajtjen e procesit të punës në QKMF; disa prej temave të diskutuara janë paraqitur në vazhdim sipas datave të mbledhjeve:

Më 04.02.2022 - Në mbledhjen e Këshillit Drejtues janë paraqitur tri raporte tematike të arritura me vonesë nga Inspektorati Farmaceutik, njëri raport është i datës 20.12.2021 (nr. 05/1534) dhe dy të datës 21.12.2021 (nr. 05/1542, 05/1546). Të tria raportet janë nga inspektimi në Qendrën e Vaksinimit kundër Covid 19. Në bazë të gjetjeve të paraqitura, nuk ka pasur vërejtje dhe është rekomanduar vazhdimi i mëtejme i punës konform legjislacionit në fuqi.

Më 10.02.2022 - Është arritur marrëveshja me NPL "Ambienti" SHA për menaxhimin e parkingut dhe mirëmbajtjen e oborrit të QKMF-së. Marrëveshja është bërë për tre muaj, me mundësi vazhdimi.

Më 11.02.2022 - Është diskutuar drafti i *Planit të punës për vitin 2022*, i cili pas plotësimeve u aprovua nga Këshilli Drejtues dhe u dorëzua në DSHMS.

Më 18.02.2022 - Është shpallur Konkursi me numër 209 për plotësimin e nëntë vendeve të lira të punës me: Katër (4) - Specialistë të Mjekësisë Familjare, Specializantë të Mjekësisë Familjare apo Mjekë të Përgjithshëm; Një (1) - Magjistër i Farmacisë; Dy (2) - Vozitës dhe Dy (2) - Punëtorë higjienik.

Më 25.02.2022 - Në mbledhjen e Këshillit Drejtues është marrë vendim që pas përfundimit të kontratës mes Komunës së Ferizajt dhe Caritas Kosovës, prej 1 marsit 2022 të bëhet riorganizimi i punës me resurset humane që janë në dispozicion, punëtorët e rregullt dhe punëtorët e angazhuar përmes MSH-së.

Më 29.03.2022 - Në mbledhjen e kryesuar nga zëvendës drejtori, Dr. Afrim Abazi, Këshilli Drejtues mori vendim që puna në Kujdestarinë e natës në QMF 2 përkohësisht të ndërpritet për arsye të: Numrit të ulët të pacientëve në këtë shërbim; Zvogëlimit të numrit të personelit në QKMF dhe Krijimi i shpenzimeve të panevojshme gjatë natës.

Më 14.04.2022 - u mor vendim që t'i drejtohet Ministrisë së Shëndetësisë një kërkesë për rritjen e numrit të personelit shëndetësor në QKMF.

Më 05.05.2022 - Nga anëtarët e Këshillit Drejtues u aprovua propozimi për rifillimin e botimit të revistës *Kujdesi shëndetësor*.

Më 19.07.2022 - Në mbledhjen e Këshillit Drejtues janë paraqitur dy raporte tematike të Inspektoratit Shëndetësor të datave 10 dhe 11.06.2022, nga inspektimi në Shërbimin Emergjent Primar. Njëri inspektim tematik është bërë për verifikimin e respektimit të orarit të punës nga ana e personelit, ndërsa inspektimi tjetër për verifikimin e respektimit të Ligjit për Kontrollin e Duhanit. Gjatë të dyja inspektimeve nuk janë gjetur të dhëna lidhur me mosrespektimin e orarit të punës apo mosrespektimin e Ligjit për Kontrollin e Duhanit.

Më 27.07.2022 - Është shpallur Konkursi me numër 863 për plotësimin e nëntë vendeve të lira të punës, me: Dy (2) - Magjistra të Farmacisë; Një (1) - Teknik i dhëmbëve; Dy (2) - Vozitës dhe Një (1) - Punëtor higjienik.

Më 13.07.2022 - Në mbledhjen e Këshillit Drejtues janë paraqitur Raporti i Inspektoratit Farmaceutik nga inspektimi me numër 05-2452, datë 17.08.2022 për *Qarkulluesit me Pakicë të Produkteve dhe Pajisjeve Medicinale për Praktikën e Mirë Farmaceutike*. Gjatë këtij inspektimi janë dhënë disa rekomandime të cilat janë më pas janë plotësuar.

Më 29.09.2022 dhe 04.10.2022 janë mbajtur mbledhjet e Komisionit, në përbërje prej anëtarëve të Këshillit Drejtues dhe katër profesionistëve të tjerë shëndetësor, për shqyrtimin e Draft-Statutit unik të QKMF-ve. Në këto mbledhje, duke iu referuar Draft-Statutit Unik të QKMF-ve, Udhëzimit Administrativ për Shëndetësi 04/2020 dhe Qarkores Informative Nr. 04/2021, janë shtuar specifikat e KPSH të Komunës së Ferizajt, si dhe janë nxjerr disa propozime për ndryshime, të cilat janë proceduar për shqyrtim të mëtejme në Divizionin e KPSH-së në MSH.

Më 18.10.2022 - Pas aprovimit të pjesshëm nga Ministria e Financave të kërkesës për shtimin e numrit të punëtorëve të QKMF-së dhe ndarjes së buxhetit për 10 mjekë që do të fillojnë punën nga 1 janari i vitit 2023, është shpallur konkursi me numër protokolli 1296, për plotësimin e vendeve të lira të punës për 10 mjekë, 2 vozitës (pasi që për shkak të parregullsive është anuluar pika e konkursit të kaluar për vozitës) dhe 1 fokist.

Më 10.11.2022 - Në mbledhjen e Këshillit Drejtues është paraqitur Raporti tematik i Inspektoratit Shëndetësor të Republikës së Kosovës, nga inspektimin tematik i bërë në QMF 2 - Ferizaj, më 20.10.2022 bazuar në Ligjin për Shëndetësi Nr. 04/L125, Ligjin për Inspektoratin Shëndetësor Nr. 02/L-38 dhe Ligjin për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid-19 në Territorin e Republikës së Kosovës Nr. 07/L-006. Në raportin tematik me numër 05-3010 të datës 31.10.2022 është konstatuar se: *Gjatë kohës së inspektimit të pranishëm në vendin e punës ishin mjekët dhe stafi i mesëm konform listës së vijueshmërisë dhe rekomandohet që Të vazhdohet të punohet duke respektuar orarin e punës në QMF 2 - Ferizaj.*

Më 22.12.2022 - Në takimin e Këshillit Drejtues, me rekomandim të Ministrisë së Shëndetësisë, janë formuar dy ekipe emergjente për të qenë në gjendje gatishmërie në rast të ndonjë fatkeqësie natyrore, meqë ndodhemi në prag të sezonit të dimrit. Në këtë takim, është vendosur që t'u përcillen shërbime të njëjta formualarët për vlerësimin e punëtorëve dhe të njoftohen se procesi i evaluimit duhet të përfundojë deri më 31 dhjetor 2022.

Gjatë vitit 2022 në QKMF kanë arritur këto donacione:

- Nga Caritas Kosova, nëpërmjet Drejtorit të DSHMS-së, Dr. Kemajl Emini, ka arritur një donacion prej 20 mijë maskash mbrojtëse për fytyrë (FFP2), për nevojat e personelit të Qendrës Kryesore të Mjekësore Familjare, Spitalit të Përgjithshëm dhe Institutit Rajonal të Shëndetit Publik.
- Nga UNICEF-i ka arritur donacioni me shtatë pako higjienike për QMF-të.
- Nga AQH ka arritur donacioni me inventarë për QTMF, ku përfshihen: 12 tavolina për trajnime dhe 25 karrige metalike me stof përsipër. Me këtë donacion është plotësuar nevoja për inventarë në QTMF, sepse orenditë e mëparshme ishin të vjetëruara dhe mjaft të dëmtuara.
- Nga Rotary Club Ferizaj ka arritur donacioni me material mbrojtës për personelin, ku përfshihen: maska, mbrojtëse për fytyrë, syza mbrojtëse, pulsoksimetra, termometra etj.
- **Më 24.04.2022** - në QKMF ka arritur një donacion nga UNICEF-i: otomana, termometra, paravana, kartona për shiringa dhe hanzaplasta.
- **Më 12.05.2022** - në QKMF kanë arritur frigoriferët për ruajtjen e vaksinave dhe kanë filluar menjëherë të shpërndahen nëpër QMF dhe AMF. Prej tyre dy frigoriferë 240 litrash, ngrirës të vaksinave (- 20°C) janë vendosur në Qendrën e Vaksinimit në QKMF, ndërsa dy të tjerë me kapacitet prej 105 litrash janë dërguar në QMF 1 dhe QMF 2. Gjithashtu edhe 10 frigoriferë me kapacitet 80 litra (2-8 °C) janë shpërndarë nëpër të gjitha Qendrat e Mjekësisë Familjare dhe një Ambulancë të Mjekësisë Familjare ku funksionon shërbimi i vaksinimit: QKMF, QMF 1, QMF 2, QMF 3, QMF 4, QMF 5 - Komogllavë, QMF 6 - Pleshinë, QMF 8 - Dardani, QMF 9 - Softaj dhe AMF - Gaçkë. Ky donacion është bërë në kuadër të iniciativës për zëvendësimin e plotë të pajisjeve të zinxhirit të ftohtë nëpër qendrat e vaksinimit në nivel vendi, iniciativë kjo e filluar nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe me përkrahjen e UNICEF-it. Për këtë donacion të rëndësishëm ne kemi falënderuar Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik, Ministrinë e Shëndetësisë dhe në veçanti UNICEF-in.
- **Më 09.08.2022** - Ka arritur një donacion nga UNICEF-i sipas kërkesës për plotësimin e nevojave të shërbimit të vaksinimit, me: 3 laptop Lenovo, 3 tabela elektronike për nënshkrim, 2 printera zebra, 1 printer Epson, 1 inventar kondicioner, 20 ngjyra Epson (color dhe bardhë e zi) dhe një gjeneratori 10 kw.
- **Më 10.08.2022** - Sipas marrëveshjes mes Ministrisë së Shëndetësisë së Kosovës (MSH) dhe Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Shërbime të Projekteve (UNOPS), në 26 komuna të Kosovës janë shpërndarë pajisje mjekësore bazike. QKMF në Ferizaj është furnizuar me: Aparate të EKG-së 12 kanalshe - 8 copë, Stetoskopë medicinal - 8 copë, Tensionmetra - 8 copë, Llamba mobile për ekzaminim - 8 copë, Pajisje për matjen e peshës dhe gjatësisë (për të rritur) - 8 copë, Çekanë neurologjik - 8 copë, Termometra me rreze infra të kuqe - 8 copë, Pulsoksimetra - 8 copë, Otoskopa - 8 copë, Glukometra - 4 copë, Shirita për matjen e glukozës 200, Shirita për urinë 2 pako dhe Termometër digjital - 8 copë. Ndërsa në kontigjentin e dytë të donacionit kanë arritur: 8 peshore për fëmijë, 8 sete kirurgjike, 8 sete stomatologjike dhe 8 inhalatorë.
- Në fillim të muajit shtator është bërë pranimi i kontingjentit të dytë të pajisjeve mjekësore, donacion sipas marrëveshjes mes Ministrisë së Shëndetësisë dhe Zyrës së Kombeve të Bashkuara në Prishtinë. Me këtë rast janë pranuar: 8 peshore digjitale për fëmijë, 8 inhalatorë, 8 setet kirurgjike, 8 sete stomatologjike.

- **Më 23.09.2022** - Nga organizata "Islamic Relief Woldwide", Zyra në Kosovë, ka arritur donacioni prej 10 aparatesh oksigjen-koncetrator, prej të cilëve 7 për QKMF-në, 2 për Spitalin e Përgjithshëm dhe një për FSK-në. Ky donacion është pranuar nga Kryetari i Komunës së Ferizajt, z. Agim Aliu nga drejtori i organizatës në fjalë, Dr.Mohamed Soliman.
- **Më 04.11.2022** - Shoqata bamirëse "Jetimat e Ballkanit" ka dhuruar 10 shtretër për nevojat e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Ferizaj. Ndërsa salloni i perdeve dhe materialeve "Lentex" dhuroi mbulesa për shtretër, jastëk dhe çarçafë.
- **Më 04.11.2022** - Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Ferizaj ka pranuar një donacion prej shtatë karrocash invalidore nga HANDIKOS-i. Një pjesë e karrocave kanë mbetur në QKMF dhe në Shërbimin Emergjent Primar, ndërsa të tjerat sipas nevojës janë dërguar nëpër qendrat e tjera të qytetit si në QMF 1, QMF 2 dhe QMF 4.
- **Më 08.11.2022** - në QKMF-Ferizaj ka arritur edhe një sasi e pajisjeve mjekësore sipas marrëveshjes mes Ministrisë së Shëndetësisë së Kosovës (MSH) dhe Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Shërbime të Projekteve (UNOPS. Në këtë kontingjent të pajisjeve të dedikuara për Shërbimin Emergjent Primar bëjnë pjesë: reanimator automatik (1 copë), aparat i EKG-së (1 copë), defibrilator me monitor (1 copë), defibrilator i jashtëm automatik (1 copë), aspirator (2 copë), qafore (4 copë), çantë mjeku (1 copë), batanije termike alumini (5 copë), çantë paramediku (1 copë), set i ndihmës së parë (1 copë), barelë mobile për bartje (1 copë), bocë oksigjeni (2 copë), barelë traumatike (1 copë), karrige kardiologjike (1 copë), dyshek me ajër (1 copë), pallto për evakuim (1 copë), barelë spinale (1 copë), batanije zjarri (1 copë), aparat kundër zjarrit (1 copë) dhe kosh depozitimi (1 copë).
- **Më 19.12.2022** - nga Drejtori i DSHMS-së, Dr. Kemajl Emini dhe menaxhmenti i QKMF-së është pranuar vetura e re Suzuki (LY-Vitara, viti i prodhimit 2022), donacion nga UNICEF-i, e dedikuar për *Vizitat shtëpiake për nëna dhe fëmijë 0 deri 3 vjeç*. Sigurimi i kësaj veture ofron mundësinë e fuqizimit të këtij programi, që është edhe një nga objektivat e QKMF-së, prandaj menaxhmenti i QKMF-së shpreh mirënjohje dhe falënderim për UNICEF-in, për këtë donacion dhe për mbështetjen e vazhdueshme ofruar institucionit tonë, e në veçanti për Programin për vizita shtëpiake për nëna dhe fëmijë 0 deri 3 vjeç.

KËSHILLI PROFESIONAL DHE ZYRA E KRYESHEFIT TË DMF (DEPARTAMENTIT TË MJEKËSISË FAMILJARE)

Zyra e Kryeshefit të Departamentit të Mjekësisë Familjare gjatë **vitet 2022** shumicën e kohës është angazhuar në menaxhimin e situatës epidemiologjike me Covid 19, sistematizimin e stafit nëpër QMF pas skadimit të kontratës të punëtorëve të angazhuar me Caritas Kosova dhe me vizita të shpeshta në terren, duke u njoftuar me procesin e punës, nevojat e personelit dhe vështirësitë në ofrimin e shërbimeve më cilësore. Si rezultat i një vale të të infektuarve me Covid 19 gjatë muajve të parë të vitit, aplikimit të masave anticovid si dhe kufizimin e numrit të pjesëmarrësve, takimet e përgjegjësve të njësive janë mbajtur kryesisht në Zyrën e Kryeshefit, me një numër të kufizuar të tyre. Pas një periudhe të shkurtër me zvogëlim të numrit të rasteve me Covid-19, kah fundi i tremujorit të dytë, filloi të rritet numri i rasteve pozitive, që ka kërkuar një mobilizim të shtuar nëpër të gjitha njësitë për ofrimin e shërbimeve më të mira, përkundër mungesës së stafit. Megjithatë, kontakti dhe konsultimet me shefat e njësive ka qenë i përditshëm, me vizita nëpër QMF dhe AMF në terren.

Po ashtu, gjatë kësaj periudhe kemi pasur edhe disa takime dhe aktivitete. Në takimet që janë mbajtur në Zyrën e Kryeshefit, me pjesëmarrje të kufizuar të shefave të njësive, është diskutuar për

problemet, nevojat dhe mundësitë e përmirësimit të mbarëvajtjes së punës, e sidomos përballja me një numër të madh të të infektuarve me Covid 19 gjatë kësaj periudhe. Gjatë këtyre takimeve është diskutuar gjithashtu rreth detyrave dhe aktiviteteve të cilat janë të përfshira në disa pika:

1. Menaxhimi i situatës epidemiologjike me Covid 19;
2. Vazhdimi i punës së ekipeve mobile gjatë orarit të paradites dhe pasdites për personat e dyshuar me Covid 19;
3. Vazhdimi i procesit të vaksinimit anti-covid në QMF 1 dhe aktivizimi i pikës tjetër të vaksinimit në qendër të qytetit;
4. Riorganizimi dhe risistemimi i një pjese të stafit nëpër njësitë e caktuara pas skadimit të kontratës me Caritas Kosova;
5. Respektimi i orarit të punës dhe pauzës nëpër njësi nga stafi shëndetësor dhe ai mbështetës;
6. Përpilimi i orareve për kujdestaritë e të dielave dhe festave;
7. Vizitat mbikëqyrëse nëpër njësitë e QKMF-së;
8. Takimet dhe kontaktet e vazhdueshme me shefat e njërive;
9. Vazhdimi i ligjëratave dhe trajnimeve online si dhe në QTMF për stafin shëndetësor.

Gjatë kësaj periudhe janë mbajtur gjithashtu edhe një numër i takimeve dhe aktiviteteve:

- **Më 01.02.2022** - Takimi në Zyrën e Kryeshefit me përgjegjësit e Shërbimit Emergjent Primar, Kujdestarisë së natës, si dhe përfaqësuesin e Depos së Barnatores Qendrore.
- **Më 14.02.2022** - Në Zyrën e Kryeshefit është mbajtur takimi me shefat dhe kryeinfermierët e qendrave, ku temë diskutimi ishte mbarëvajtja e punës nëpër njësitë e tyre, numri i stafit aktual me kontrata të rregullta të punës, si dhe nevojat e tyre për staf shtesë pas skadimit të kontratës me Caritas Kosova më 28.02.2022. Në këtë takim u arrit dakordimi që për shkak të numrit të pamjaftueshëm të personelit t'i kërkohej menaxhmentit që vizitat shtëpiake paliative të pasdites dhe të shtunave përkohësisht të ndërpriten, deri në momentin e plotësimit të nevojave me staf të ri të mjaftueshëm.
- Gjatë muajit Mars përveç pikës ekzistuese në QMF 1, u hap edhe një pikë e re për vaksinimin anti-covid, në Sheshin e Qytetit në një kontejner të ardhur donacion nga UNICEF-i.
- **Më 03.03.2022** - Është mbajtur takimi në Zyrën e Kryeshefit me përgjegjësit e njërive QKMF, QMF 1, QMF 2, QMF 4, SHEP dhe Sektorit të Stomatologjisë, ku u bisedua rreth vijueshmërisë së stafit (ardhja, dalja, pauzat), konfirmimet e vdekjeve, plotësimin e nevojave për mjekë të shtunave në SHEP nga QMF-të e tjera për shkak të mungesës së stafit etj.
- Takimi me koordinatoren e Edukimit dhe Promovimit Shëndetësor, Dr. Ibadete Bucaliu rreth organizimit të aktiviteteve për nder të Ditës Botërore të Shëndetit Oral (më 20.02.2022) dhe Ditës Botërore kundër Tuberkulozit (më 24.03.2022).
- **Më 11.03.2022** - Takimi në Zyrën e zëvendës drejtorit me kryeinfermierët e QMF-ve rreth vizitave shtëpiake paliative dhe vizitave shtëpiake për nëna dhe fëmijë 0-3 vjeç.
- **Më 21.03.2022** - Pjesëmarrja në takimin e mbajtur në Prishtinë me përfaqësuesit e MSH-së dhe Kryqit të Kuq ku tema të diskutimit ishin:
 - a) Plani i Reagimit Kombëtar dhe sistemi i integruar i menaxhimit të emergjencave (Përfaqësuesi i MPB)
 - b) Shëndeti seksual dhe riprodhues në situata emergjente MISP (Përfaqësuesi nga MSH).

- **Më 23.03.2022** - Në Zyrën e Kryeshefit është mbajtur takim me kryeinfermierin e QKMF-së dhe kryeinfermierin e kujdestarisë së natës, në lidhje me transferimin e kujdestarisë nga QMF 2 te SHEP për të funksionuar si një ekip e përbashkët.
- **Më 29.03.2022** - Takim me koordinatoren e projektit për nëna dhe fëmijë në lidhje me vizitën e përfaqësuesit të UNICEF-it dhe ambasadores së Luksemburgut më 03.03.2022 me qëllim të diskutimit rreth aktiviteteve, donacioneve, aparatit oksigjenoformues, pakove higjienike etj.
- **Më 15.09.2022** - Pjesëmarrja në tryezën diskutuese me temën: "**Fuqizimi i rolit të mamive në të gjitha nivelet e shërbimeve shëndetësore në Kosovë**", organizuar nga *Action for Mother and Children* në Prishtinë.
- **Më 16.11.2022** - u mbajt mbledhja e Këshillit Profesional ku ishte i pranishëm edhe Drejtori i DSHMS-së. Përveç raportimit të shefave të njësive, në këtë mbledhje u diskutua edhe rreth vijueshmërisë në punë dhe respektimit të orarit nga ana e punëtorëve të QKMF-së.

Gjatë kësaj periudhe janë mbajtur edhe disa trajnime dhe ligjërata, të cilat i kemi paraqitur në kreun e Qendrës Trajnuese të Mjekësisë Familjare, gjegjësisht Edukimit të Vazhdueshëm Profesional.

Zyra e Kryeinfermierit

Shërbimet infermierike në QKMF përbëjnë mbi 70% të volumit të përgjithshëm të punës në institucionin tonë dhe si të tilla kërkojnë një menaxhim dhe përkushtim serioz. Si tërësi shumica e punëve në QKMF dhe cilësia e tyre varen nga përgatitja dhe profesionalizmi i infermierëve, gjithashtu janë disa shërbime të cilat udhëhiqen dhe mbahen vetëm nga stafi infermieror, si p.sh.: *Vizitat shtëpiake për persona me sëmundje kronike dhe kujdes paliativ, shërbimi i vizitave për nëna dhe fëmijë, kujdesi antenatal, dispanserit antituberkular, vizitat dhe shërbimet për persona me COVID-19, qendra e thirrjeve* etj.

Në mbledhjen e parë për këtë vit, të mbajtur më 21 janar me kryeinfermierët e njësive është diskutuar plani i punës për vitin 2022 ku edhe janë vendosur disa objektiva si:

1. Menaxhimi i resurseve humane të stafit infermieror në QKMF (për QMF dhe AMF).
2. Ngritja dhe aftësimi profesional i stafit infermieror përmes trajnimeve dhe ligjëratave në kuadër të EVP-së, të parapara për vitin 2022.
3. Trajnimi i stafit infermieror në Emergjencën Primare për *dispeçer*.
4. Prefeksionimi i shërbimeve infermiore nëpër njësi dhe ekipeve të vizitave në terren (kujdesit shtëpiak, vizitave shtëpiake për nëna dhe fëmijë etj).
5. Organizimi i Simpoziumit të Dytë Infermierisë në nivel regjional.
6. Nxjerrja e Revistës së Infermierëve dhe Revistës "Kujdesi Shëndetësor" në kuadër të QKMF-së.
7. Bashkëpunimi me koordinatoren e Edukimit dhe Promovimit Shëndetësor për organizimin dhe shënimin e ditëve të promocionit të shëndetit sipas datave të caktuara sipas OBSH-së, në komunitet dhe në institucion. Këto objektiva do të realizohen në bashkëpunim me drejtorinë e QKMF-së dhe në koordinim me të gjithë sektorët e QKMF-së.

Me koordinatorin e Edukimit të Vazhdueshëm Profesional kemi hartuar planin e EVP-së që është dërguar për Akreditim në OIK, ku janë paraparë 12 ligjërata nga dy sesione gjatë vitit. Gjatë kësaj periudhe, gjegjësisht në fillim të vitit, ballafaquar me një valë të re të pandemisë e cila për fat të mirë ishte shumë më e lehtë sesa ato paraprake, megjithatë infermierët nuk e neglizhuan punën dhe kujdesin por arritën që t'i kryejnë detyrat me përgjegjësi.

Më 14.02.2022 - është mbajtur mbledhja e dytë me kryeinfermierë të njësive ku u diskutuan modalitetet e punës pas 28 shkurtit kur edhe përfundon kontrata për punëtorët e angazhuar përmes marrëveshjes me Caritas Kosova, është konkluduar se organizimi i punës pa këta punëtorë do të jetë shumë i vështirë, për arsye se është rritur numri i shërbimeve dhe janë hapur dhe QMF-të reja, kurse numri i punëtorëve nuk është shtuar, përkundrazi, ky numër po zvogëlohet çdo vit me pensionimin e infermierëve, vendet e të cilëve po zëvendësohen me kuadro të tjera. Për më tepër, shumica e infermiereve të angazhuara në QKMF me kontrata të rregullta janë mbi moshën 50 vjeçare, që do të thotë se problemi i mungesës së tyre do të thellohet në vazhdimësi.

Më 01.03.2022 - ka përfunduar kontrata me Caritas Kosova dhe ne kemi bërë një risistemim të stafit shëndetësor dhe infermieror. Qendra e Thirrjeve e cila ka funksionuar nga 16.07.2021 ka pushuar punën për shkak të numrit të ulët të pacientëve me covid dhe nevojave për infermierë në qendra tjera. Përndryshe kjo qendër gjatë pandemisë Covid-19 ka luajtur një rol të rëndësishëm në informacionin, këshillimin dhe monitorimin e gjendjes së pacientëve me covid, gjë që ka ndikuar pozitivisht edhe në shëndetin mendor të këtyre pacientëve. Deri më 28.02.2022 janë realizuar rreth 30.000 thirrje nga kjo qendër.

Si pasojë e numrit të pakët të infermierëve në QMF-të e fshatrave, si QMF 5, QMF 6, QMF 7, QMF 8, QMF 9 dhe nëpër AMF, janë duke punuar vetëm nga një infermiere, kurse vetëm në QMF 3 janë dy infermiere. Situata nuk është aspak e këndshme edhe në 4 qendrat e mëdha në qytet, ku problem kryesor është mbulimi i shërbimeve të të shtunave, ku infermierët janë të detyruar të punojnë pothuajse çdo të shtunë në mungesë të stafit. Megjithatë, edhe pse me numër të pakët të stafit, shërbimet nuk kanë ngecur për asnjë moment. Ndihmesë të madhe në këtë drejtim i kemi pasur infermierët e angazhuar nga MSH për vaksinim dhe 16 infermiere nga vaksinimi janë angazhuar nëpër njësi të QKMF-së. Në koordinim me AMC dhe MSH janë mbajtur deri më tani tri trajnime me infermierë nga QKMF.

Një sfidë në vete është edhe planifikimi i punës praktike të stazhierëve që gjatë vitit arrin deri në 450 numri total i të regjistruarve për stazh, si të shkollave të mesme të drejtimeve mjekësore, të Fakultetit të Infermierisë në UP dhe kolegjeve të drejtimit të infermierisë me të cilat kemi marrëveshje të shkruar.

Në **vitin 2022** janë regjistruar **416** studentë të infermierisë për të ndjekur stazhin në QKMF, QMF dhe njësitë tjera të QKMF-së. Ndërsa deri më 31.12.2022 nga Zyra e Kryeinfermierit janë lëshuar **346** vërtetime për kryerjen e stazhit tremujor në QKMF.

Nga 16.01-04.03.2022 - kanë përfunduar punën praktike 15 studentë të vitit të tretë (III) nga kolegji QEAP Heimerer.

Nga 01.02-25.02.2022 - kanë përfunduar punën praktike 8 studentë nga UP, drejtimi Infermieri.

Nga 16.01-04.03.2022 - kanë ndjekur praktikën 22 studentë të vitit të dytë (II) nga Kolegji AAB.

Nga 07.03.2022 - 16 studentë të vitit të parë (I) të Kolegjit Heimerer kanë filluar procesin e vijimit të praktikës, një ditë në javë (çdo të enjte) për tre muaj rresht .

Është bërë planifikimi i punës së praktikës për studentët e vitit të I-rë, II-të dhe të III-të të Kolegjit Universum, drejtimi infermieri, në bazë të marrëveshjes gjatë muajve prill, maj dhe qershor, të ndarë në tri grupe.

Përveç shërbimeve në institucion dhe në terren, të cilat janë pasqyruar në raportin e përgjithshëm të QKMF, ekipet shëndetësore janë angazhuar edhe në disa shërbime tjera si:

Prej 1-7 mars - nga një ekip shëndetësor në përbërje prej mjekut, infermierit dhe vozitësit, kanë qenë të angazhuar në përcjelljen e garave të skijimit në Brezovicë, nga 24-orë për shtatë ditë radhazi. Këto gara ishin të organizuara nga Ministria e Arsimit në koordinim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Ministrinë për Rini Kulturë dhe Sport.

Më 17 prill - është angazhuar një ekip i Emergjencës Primare në përcjellje të garave të Federatës së çiklistëve të Kosovës në relacionin Prishtinë-Hani i Elezit dhe anasjelltas.

Më 19 prill - një grup prej 8 studentësh të Infermierisë të komunitetit RAE, në bazë të marrëveshjes mes DSHMS-së dhe Helsinki Deaconess Foundation - janë sistemuar për kryerjen e stazhit në QMF 2 dhe QMF 4 në kohëzgjatje prej tre muajve.

Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar edhe takime e aktivitete të tjera si:

Më 20 prill - u mbajt mbledhja e katërt me kryeinfermierë të njësive të QKMF-së, ku u diskutua rreth sfidave të stafit infermierik në mbulimin e shërbimeve në QKMF si dhe rreth modaliteteve të orarit të praktikës së studentëve dhe nxënësve të infermierisë në QKMF dhe QMF.

Më 21 prill - takimi me koordinatoren e praktikës së Shkollës së Mesme të Mjekësisë “Elena Gjika”, z. Astrit Osmani, me qëllim të koordinimit lidhur me orarin e praktikës së nxënësve të kësaj shkolle në bazë të marrëveshjes ndër-institucionale.

Më 4 prill - Takim me koordinatoren e Promovimit dhe Edukimit Shëndetësor të IRSHP Ferizaj, Dr. Diana Sojeva, ku u vendos që dy institucionet, IRSHP- KPSH (QKMF) t'i organizojnë së bashku aktivitetet e edukimit dhe promovimit shëndetësor në komunitet, në bazë të përgjegjësisë institucionale.

Më 6 maj - u mbajt mbledhja e pestë me kryeinfermierët e njësive, ku veç tjerash u diskutua plani për shënimin e 12 Majit - Ditë së Infermierisë, fillimit të ligjëratave në kuadër të EVP-së, pas akreditimit të programit.

Më 12 maj - u shënuar Dita Ndërkombëtare e Infermierisë në qendër të qytetit, gjegjësisht në sheshin “Hyrë Emini”, ku infermierët, kalimtarëve të rastit, u bënë matjen e tensionit arterial, matjen e glikemisë, shpërndanë fletëpalosje me mesazhe kundër dukurive negative në shoqëri etj. Këtij aktiviteti iu bashkëngjiten edhe infermieret nga IRSHP Ferizaj dhe studentët të Infermierisë së Kolegjit Universum. Të njëjtën ditë, në Qendrën Trajnuese të Mjekësisë Familjare u bë edhe promovimi i revistës “Kujdesi Shëndetësor”, numër ky që doli pas gjashtë viteve ndërprerje, që për nder të Ditës së Infermierisë iu dedikua infermierëve dhe u përgatit në tërësi nga stafi infermieror.

Më 15 qershor - për nder të 15 qershorit - Ditës së Shëndetësisë Ferizajase, në bashkëpunim me Zyrën e drejtoreshës së infermierisë të Spitalit Rajonal të Ferizajt, Kryeinfermierin e IRSHP-së, kryeinfermierin e QSHM, si dhe delegatët e OIK-ut nga Ferizaj, është organizuar një ekspozitë me foto nga procesi i punës në institucionet shëndetësore gjatë pandemisë dhe më pas.

Në të njëjtën datë, 15 qershor, përfunduan kontratën e punës edhe 20 infermierë të angazhuar nga Ministria e Shëndetësisë gjatë periudhës së vaksinimit anticovid. Kjo e ka ndikuar në gjendjen edhe ashtu

të rënduar nga mungesa e stafit infermierik. Për të mos pasur ngecje në procesin e punës, në QKMF dhe QMF1, 2, 4, janë tërhequr infermierët nga AMF-të. Gjendje më e rënduar është krijuar në SHEP, QMF 2, Kabinetin e Rëntgenit, por as në qendrat e tjera nuk është gjendje më e mirë. Në disa njësi, gjatë ndërrimit një infermiere duhet t'i mbulojë dy-tre vende të punës, sidomos në rastet kur një kolegj shkon në pushim vjetor. Ndërsa vështirësitë janë edhe më të madhe në rastet e pushimeve të paplanifikuara, si pushimet mjekësore.

Më 13 korrik - me kërkesë të MSH, kemi organizuar një ekip mjekësor nga një mjek dhe dy infermiere në ndihmë të QKMF-së së Hanit të Elezit, në përballimin e gjendjes së rënduar nga infeksionet gastrointestinale të popullatës së fshatit Gorancë.

Më 24 gusht - me shtimin e rasteve me Covid-19 është shtruar nevoja e hapjes së këndit për trajtim të pacientëve covid pozitiv në QMF-I, në këtë kënd kanë punuar vetëm infermierët e QMF 1 pasi QMF-të e tjera mezi po i mbulonin njësitë e tyre me staf. Për pesë javë rresht janë trajtuar me terapi intravenoze 974 raste në këtë kënd.

Më 26 korrik - Trajnimi për vaksinim në Prishtinë, nga një mjek për secilën QMF, nga një infermiere, si dhe kryeinfermieret e QMF-ve, aplikimi i SISH për vaksinim në secilën pikë të vaksinimit si dhe për ekipet mobile.

Më 11 gusht - Trajnim nga AMC, Klasat për Nëna dhe Fëmijë ku morën pjesë 4 infermiere.

Më 11 gusht - Mbledhja e shtatë me kryeinfermiere të njërive, me pikat e rendit të ditës: Raportimi për njësi, regjistrimi i barnave pa afat të grumbulluara në depon në Neredime të Epërme, mbarëvajtja e Kujdestarisë së Natës, të shtunave dhe të dielave.

Më 16 gusht - me kërkesë të drejtoreshës së QKMF-së kemi caktuar një grup prej 4 infermiereve, si dhe një teknik laborant dhe një teknik dentar, për numërimin dhe regjistrimin e barnave pa afat, që ka zgjatur rreth tre muaj, për t'i hapur rrugë AKPM-së për asgjësimin e tyre.

Më 30 gusht - kemi caktuar një grup prej 13 infermieresh për trajnim për MISP që u mbajt më 01 dhe 02.09.2022

Më 1 shtator - dy grupe nga tetë infermiere kanë ndjekur trajnimin online nga AMC me 01.09.2022 dhe 02.09.2022 dhe kanë qenë kryesisht infermiere që janë të caktuara për Vizita për Nëna dhe Fëmijë.

Më 19 shtator - Mbledhja e tetë me kryeinfermierët e njërive ku u bë raportimi nga njësitë dhe u diskutua rreth furnizimit me barna dhe material harxhues shëndetësor.

Më 20 shtator - trajnimi për MISP që u ndoq nga shtatë infermiere dhe tre mjekë nga QKMF, trajnim ky që është përmbyllur me një ushtrim fushor me ekipin e Emergjencës. Trajnimi ishte i organizuar nga Kryqi i Kuq i Kosovës.

Gjatë kësaj periudhe kohore ekupe infermierësh veç punëve të zakonshme të tyre kanë marrë pjesë në përcjelljen e garave të ndryshme sportive.

Më 03.10.2022 - janë sistemuar pesë praktikantë nga komuniteti RAE, në bazë të marrëveshjes mes DSHMS-së dhe Shoqatës VORAE, të cilët janë me pagesë po nga kjo shoqatë dhe praktika e tyre do të zgjasë deri më 31.12.2022.

Më 21.10.2022 - është mbajtur mbledhja me kryeinfermierët e njësive me qëllim të diskutimit të përgatitjeve për takimin profesional i caktuar për datën 28.10.2022. Në këtë mbledhje e përgatit plani i organizimit, u ndanë detyrat dhe përgjegjësitë, si dhe u caktua numri i infermierëve që do të marrin pjesë në takim.

28.10.2022 - është organizuar takim profesional në infermieri – Tryeza: “Të arriturat e punës ekipore në infermierinë ferizajase 2019-2022,” e cila u organizua nën patronatin e Drejtorit të DSHMS-së. Tryeza u organizua nga kryeinfermieri i QKMF-së dhe delegatët e OIK-ut nga Ferizaj dhe morën pjesë infermierë nga katër institucionet shëndetësore nga QKMF, Spitali Rajonal, IRSHP dhe QMSHM. Tryeza i tejkaloi përmasat e takimit komunal duke marrë karakter vendor pasi kishte pjesëmarrës mysafirë nga Kryesia e OIK, drejtorë të infermierisë, infermierë dhe punëtorë të tjerë shëndetësorë.

Më 16.11.2022 - ekipet shëndetësore filluan vizitat sistematike në shkolla me target grupet - klasat e para dhe klasat e pesta lidhur me *Rritjen dhe Zhvillimin e Fëmijëve*, ushqyeshmërinë, shikimin dhe deformitetet e mundshme të shtyllës kurrizore. Në këto ekipe krahas mjekëve, (fiziatër, oftamolog, mjek familjar) janë angazhuar dhe katër infermiere si dhe katër stazhiere në rolin e asistentes së infermieres. Këto vizita janë mbajtur për katër javë rresht deri më 11.12.2022 në dy shkolla të mëdha të qytetit, “Jeronim De Rada” dhe “Tefik Çanga”.

Më 13.12.2022 - u mbajt mbledhje me kryeinfermierë të njësive (mbledhja e dhjetë me radhë); ku kryeinfermierët raportuan për mbarëvajtjen e punës, problemet dhe sfidat që po i përcejellin, në veçanti vizitat për nëna dhe fëmijë deri në 3 vjeç ku për shkak të mungesës së stafit infermior ka ngecje në realizimin e tyre, caktimin e stafit infermior për trajnimin për përdorimin e pajisjeve dhe njohurive bazë për reanimim dhe triazhim emergjent si dhe përgatitjen e temave të ZHVP-së për vitin 2023. Nga kryeinfermierët u kërkua që urgjentisht të shtohet numri i infermierëve, pasi që mungesa e tyre po shkakton mospërmbushje të detyrave të punës, lodhje kronike të stafit, ngarkesë psiko-fizike, stres etj.

Më 14.12.2022 - Ka filluar vaksinimi i pacientëve në kujdesin paliativ me vaksinën kundër gripit sezonal, nga ekipet e vizitave shtëpiake të katër QMF-ve me ç’rast të gjithë pacientët përfitues të kujdesit shtëpiak, gjithsej 48, patën rastin të vaksinohen me pëlqimin e tyre.

15 dhe 22.12.2022 - është organizuar trajnimi intensiv për emergjencë, bashkë me Koordinatorin e EVP-së. Trajnimi u krye në dy grupe dhe morën pjesë shumica e stafit të Emergjencës Primare, nga tre infermierë prej qendrave të tjera si dhe katër infermierë nga Kaçaniku dhe Dragkoci.

Më 27.12.2022 - tri infermiere bashkë me tre mjekë nga QKMF, morën pjesë në trajnimin për MISP, organizuar nga MSH dhe Kryqi i Kuq i Kosovës. Ky trajnim është mbajtur në Fushë Kosovë.

KOMITETI PËR NGRITJEN E CILËSISË SË SHËRBIMEVE

Zyra për sigurimin e cilësisë në punë

Sipas pikës 3, të vendimit me numër protokolli 05-4179 të datës 11.06.2021, të Ministrit të Shëndetësisë, Koordinatorët e Cilësisë të QKMF-ve të komunave përkatëse janë caktuar të jenë mbikëqyrës të drejtpërdrejtë të vaksinimit kundër Covid-19 dhe të raportojnë në Komisionin për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e procesit teknik të vaksinimit kundër Covid-19 në nivel të Republikës së Kosovës.

Koordinatori i Cilësisë së Shërbimeve në QKMF sipas vendimit të lartpërmendur, nga data 15.06.2021 deri më 15.06.2022, krahas raportimit në baza ditore dhe javore, ka kryer edhe detyra dhe obligime të tjera si: Mbikëqyrja e procesit teknik të vaksinimit; Mbikëqyrja dhe sistemimi i ekipeve gjatë proceseve të vaksinimit; Mbikëqyrja e arritjes së sasisë së nevojshme ditore të vaksinave, sipas planifikimit;

Mbikëqyrja dhe menaxhimi i mbetjeve mjekësore pas vaksinimit dhe materialit tjetër shpenzues; Mbikëqyrja dhe sigurimi i furnizimit me mjete mbrojtëse dhe material tjetër shpenzues; Mbikëqyrja dhe furnizimi me material IEK; Mbikëqyrja e prezencës së Autoambulancës në ofrimin e shërbimeve emergjente; Mbikëqyrjen e vijueshmërisë së stafit shëndetësor, Forma mujore e vlerësimit të realizimit të shërbimeve për mjekë dhe infermierë dhe dorëzimi çdo muaj tek Menaxheri i ekipit-Komisioni për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e procesit teknik të vaksinimit kundër Covid-19 në Republikën e Kosovës ku më pas përmes Arkivit, dorëzohet tek Divizioni i Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë. Përcjellja e realizimit të procesit të vaksinimit sipas *Manualit për mbikëqyrje nga përhapja e virusit SARS-Cov 2, Covid-19*; Raportimet tek Ekipi Menaxhues Qendror, tek drejtori i DSHMS-së, menaxhmenti i QKMF-së dhe ekipi menaxhues lokal. Gjithashtu, njoftimet e pranura nga Ekipi Menaxhues i nivelit qendror janë bartur tek stafi shëndetësor në qendrën e vaksinimit verbalisht dhe përmes e-mailit.

1. Furnizimi i fermerëve me serra dhe sistemin e ujitjes pikë-pikë: Janë ngritur 155 serra me sipërfaqe 50m² dhe 10 serra me sipërfaqe 300m². Në këtë subvencionim është përfshirë konstruksioni i serrës, folia, transporti, punët rreth vendosjes së serrës dhe sistemi i ujitjes. Interesimi i fermerëve ka qenë shumë i madh për këtë projekt, kanë aplikuar për serra të vogla 323 fermerë ndërsa për serra të mëdha kanë aplikuar 51 fermerë.

2. Subvencionimi i fermerëve për ngritjen e pemishteve me arra: Me këtë subvencionim janë ngritur 10 ha me pemishte të arrave, përfitues kanë qenë 20 fermerë me nga 0.50ha. Subvencionimi ka qenë në sigurimin e fidaneve dhe të sistemit të ujitjes për pemishtet që do të ngriten.

3. Furnizimi i fermerëve kultivues të grurit me impute bujqësore: Me këtë projekt janë përkrahur 414 fermerë me pleh artificial azotik me 27% N, sasia e plehut që janë subvencionuar fermerët ka qenë 125000 kg. Sasia e plehut është shpërndarë te fermerët në mënyrë proporcionale me sipërfaqen e mbjellur të grurit.

4. Subvencionimi i fermerëve kultivues të perimeve në serra me pajisje: Me këtë projekt janë përkrahur 12 fermerë me nga një motokultivator me 7.5kW dhe 48 fermerë me nga një motokultivatorë me 4.4 kW, pra janë përkrahur gjithsej 60 fermerë, mirëpo pikërisht për shkak të rëndësisë që kanë këto pajisje numri i fermerëve aplikues ka qenë shumë i madh, për këto pajisje kanë aplikuar 183 fermerë.

5. Përkrahja e fermerëve në ngritjen e pemishteve me mjedra: Duke u bazuar në perspektivën e kultivimit të pemëve të imta sidomos të mjedrës, që është një kulturë shumë rentabile, interesimit të madh të fermerëve për kultivimin e kësaj kulture, këtë vit Drejtoria e Bujqësisë ka përkrahur fermerët në ngritjen e 4 ha pemishte me mjedra. Sipërfaqja për një përfitues ka qenë 0.25ha, ku kanë qenë 16 fermerë përfitues. Përkrahja ka qenë në: Sigurimin e fidaneve të mjedrave, folinë dhe sistemin e ujitjes për ato sipërfaqe që janë ngritur.

6. Organizimi i trajnimeve për fermerët dhe fushata vetëdijësuese, sjellja dhe kujdesi ndaj qenve endacak – Gjatë implementimit të këtij projekti janë organizuar trajnime në lëmi të ndryshme të bujqësisë, janë mbajtur trajnime teorike, praktike dhe vizita në terren. Pjesëmarrës në të gjitha këto trajnime kanë qenë rreth 250 fermerë varësisht nga veprimtaria e tyre. Në kuadër të këtij projekti janë mbajtur edhe fushata vetëdijësuese rreth sjelljes dhe kujdesit ndaj qenve endacak, janë shtypur fletushka dhe janë përgatitur spote rreth kësaj fushate.

7. Ndërtimi i serrës tunel me polikarbon – ky projekt është realizuar me kërkesën e SHML e Agrobiznesit dhe Teknologjisë "Zenel Hajdini", me qëllim të ngritjes së aftësive profesionale të nxënësve të kësaj shkolle. Me realizimin e këtij projekti nxënësit nga gjenarata në gjeneratë e kanë mundësinë që këtu të zhvillojnë edhe pjesën praktike në lëminë e perimkulturës.

8. Rregullimi i rrugëve të arave me zhavor- Në vitin 2022 është arritur të rregullohen disa rrugë të arave dhe hapen disa rrugë të reja si:

- Rruga në Fshatin e Vjetër me gjatësi 257.33m
- Rruga në fshatin Pojatë me gjatësi 148.83m
- Rruga në fshatin Prelez i Jerlive me gjatësi 1075.82m
- Rruga në fshatin Prelez i Muhaxherëve me gjatësi 281.40m
- Rruga në fshatin Muhoc me gjatësi 348.63m
- Rruga në Koshare me gjatësi 553.28 m
- Rruga në Sazli me gjatësi 354.11m
- Rruga Talinoc i Muhaxherëve-Pojatë me gjatësi 1456.38m
- Rruga në Muhoc - vazhdimi i pjesës së parë me gjatësi 326.06 m

9. Furnizimi i fermerëve me lopë të racës simental - Drejtoria e Bujqësisë në mbështetje të mbarshtuesve të fondit blegtoral ka furnizuar 79 fermerë në fshatrat e komunës sonë me nga një lopë të racës simental. Realizimi i këtij subvencionimi është me pjesëmarrjen e fermerëve me 25% në vlerën e tërësishmë të projektit.

10. Ndërtimi i silloseve (baseneve) të sillazhit - Sillazhi po zë vend të rëndësishëm në të ushqyerit e kafshëve. Sillazhi si ushqim i konservuar mund të përdoret tek të gjitha llojet e kafshëve dhe më së shumti rekomandohet në stinën e dimrit kur nuk kemi ushqime tjera të njoma dhe të lëngëta. Për një prodhimtari të suksesshëm Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë ka ndihmuar 13 blegtorë me ngritjen e silloseve- vendeve për vendosjen e masës për sillazhim.

11. Rregullimi i Tregut të Kafshëve - Është një projekt trevjeçar, punët janë duke vazhduar sipas dinamikës së planifikuar, deri më tani janë kryer 70% të punimeve dhe pritjet finalizimi i tregut në fund të vitit 2023.

Për menaxhimin e problemit të qenve endacak Drejtoria e Bujqësisë ka realizuar këto projekte:

12. Projekti i trajtimit të qenve endacak - Duke pasur kërkesa të shumta nga ana e qytetarëve për qentë endacak dhe rrezikun që paraqesin për jetën e qytetarëve e sidomos fëmijëve që shkojnë në shkollë, Drejtoria e Bujqësisë ka realizuar projektin për trajtimin e qenve endacak ku përfshihen: Kapja e qenve, kontrolli klinik, mjekimi, vaksinimi, dehelmetizimi, kastrimi, sterilizimi, hospitalizimi dhe eutanazia sipas vlersimit të ekspertëve. Janë trajtuar 1253 qenë dhe i janë vendosur numrat e matrikulit.

13. Rregullimi i katër pikave për vendosjen e ushqimit dhe ujit të pijes (Pikat ushqyese) -

Problemi i qenve endacakë tash e sa kohë është bërë problem serioz për qytetarët e Ferizajt ani pse ata po trajtohen në bazë të Ligjit për trajtimin e kafshëve. Për uljen e agresivitetit të qenve, Drejtoria e Bujqësisë ka realizuar projektin e katër pikave për vendosjen e ushqimit dhe ujit të pijes (**Pikat ushqyese**), po ashtu ka inicuar procedurën edhe për projektin tjetër për **ndërtimin edhe të katër pikave tjera për ushqimin e qenve endacak** duke shkuar në tetë numri i pika ushqyese.

14. Ndërtimi i shtëpizave apo Qendra e trajtimit të përkohshëm të qenve endacak - Numri i pakontrolluar i qenve mund të jetë burim i sëmundjeve zoonotike, ndaj është jashtëzakonisht e rëndësishme të kontrollohen qentë që bredhin lirshëm. Këto QTPQE mund të përmbushin një sërë rezultatesh duke zbatuar masa të kontrollit veçanërisht ato të shtimit të qenve, monitorimit dhe kontrollimit për sëmundjet e ndryshme që mund të bartin këta qenë.

15. Kompenzimi i dëmeve në bujqësi – Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë për vitin 2022 në kuadër të subvencioneve ka ndarë një buxhet për kompenzimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe dëmet tjera në ferma. Varësisht nga dëmet e shkaktuara fermerët kanë bërë kërkesat në Drejtorinë e Bujqësisë dhe Pylltarisë. Komisioni i formuar nga ekspertët e kësaj drejtorie i ka shqyrtuar ato kërkesa, ka bërë vlerësimin e dëmeve dhe u është bërë pagesa. Kanë qenë 39 kërkesa, ndërsa sipas vlerësimit kompenzimi u është bërë 35 fermerëve.

- Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë ka kryer të gjitha procedurat për realizimin e projekteve të cekura më lartë, ka bërë menaxhimin e projekteve deri në përfundimin e tyre, ka bërë pagesat sipas kontratave të nënshkruara dhe vazhdon monitorimin e mëtutjeshëm.

Përveç projekteve të cekura më lartë në Drejtorinë e Bujqësisë dhe Pylltarisë janë kryer edhe këto aktivitete:

- Aplikimi i fermerëve për subvencione nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Ky aplikim është kryer në zyrat e Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë, kjo fazë ka zgjatur 40 ditë kalendarike, ishte një punë shumë voluminoze dhe një afat shumë i shkurtër për përmbushjen e të gjithë kërkesave të fermerëve.

Tërë stafi i Drejtorisë së Bujqësisë ishte i angazhuar në kryerjen e këtyre punëve:

- *Shpallja e njoftimeve për aplikim për subvencione;
- *Caktimi i termineve për aplikim;
- *Kontrollimi dhe pranimi i dokumenteve;
- *Regjistrimi në Regjistrin e Fermës;
- *Digjitalizimi i parcelave në ELPIS;
- *Aplikimi online për të gjitha subvencionet në EFR.

Gjatë vitit 2022 për subvencionet nga MBPZHR në Drejtorinë e Bujqësisë kanë aplikuar gjithsej 917 fermerë për këto subvencione: lopë 1378 krerë, viça për majmëri 780 krerë, dele 5071 krerë, dhi 232 krerë, pula 64500 copë, bletë 7766 zgjoje, grurë 2885 ha, farë gruri 14ha, misër 1948 ha, elb dhe thekër 36 ha, molla 50 ha, mjedra 11,9 ha, kumbulla 14 ha, patate 20 ha, kunguj 33 ha, qepë 6 ha, lakra 9 ha, aronia 3 ha, arra 58 ha, vishnje 2.5 ha, lajthia 37 ha, dredhëza 11 ha, fasule 27 ha, perime në serra 3 ha, material fidanor 193030copë. Subvencionimi i fermerëve për sasi dhe cilësi të qumështit si dhe viçave për majmëri nga MBPZHR që bëhet për çdo 6 muaj, aplikimi me të gjitha procedurat është bërë në Drejtorinë e Bujqësisë dhe Pylltarisë, ku është aplikuar për 6 mujorin e dytë 2021 dhe aplikimin e parë 2022.

Në Drejtorinë e Bujqësisë dhe Pylltarisë janë bërë:

- Pagesat për të gjitha subvencionet dhe projektet e realizuara;
- Pagesat për të gjitha kategoritë e shërbimeve dhe mallrave;
- Janë bërë raportet mujore dhe gjashtëmujore për faturat e papaguara;
- Pagesat e participimit të fermerëve gjatë realizimit të subvencioneve;
- Planet dhe raportet e mbjelljeve pranverore dhe vjeshtore;
- Janë bërë përgatitjet për korrje-shirje dhe raportet e korrje shirjeve;
- Kemi bërë edhe vlerësimin e dëmeve sipas kërkesave të fermerëve që kompenzohen nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- Jemi të kyçur në komisionin për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore;
- Janë pajisur fermerët me vërtetime si prodhues bujqësor për nevoja të tyre personale;

- Të gjitha kërkesat që i janë drejtuar kësaj Drejtorie janë shqyrtuar dhe janë zgjedhur konform ligjeve dhe rregulloreve në fuqi.

Sektori i Pylltarisë

Mbrojtja e pyjeve

Fletëparaqitjet e ngritura (rojet, stafi dhe konfiskimet)

a)Fletëparaqitje Penale

Lëndë: 13 me vëllim 70.42 m^3 në vlerë 9659.02 €

b)Fletëparaqitje për Kundërvajtje

Lëndë: 182 me vëllim 214.93 m^3 në vlerë 29070.35 €.

Gjithsej fletëparaqitje:

Fletëparaqitje-195 copë

Vëllimi – 285.55 m^3

Vlera –38729.37 €

Konfiskimi i masës drusore

Dru zjarri- 79.50 m^3 .

Dru teknik– 0.0 m^3

Masa e druve të konfiskuar është proceduara sipas proceduarave të prokurimit dhe UA për shitblerjen e asortimenteve drusore ku janë shitur 125.00 m^3 dru zjarri në vlerë prej 7625.00 € të cilat janë të hyra të Komunës.

Kontrollet pyjore

Janë zhvilluar mbi 70 kontrolle dhe monitorime të pyjeve publike në rrugët pyjore dhe jopyjore.Me polici janë bërë 35 kontrolle pyjore.

Takimet e mbajtura

Janë mbajtur takime sipas nevojës me roje të pyjeve dhe teknik, ku rojeve iu janë dorëzuar materialet e punës si (ditarët e punës dhe librat e cungjeve, çekanat e dëmeve pyjore).

Poashtu kemi mbajtur takime me polici, me inspektorë të pylltarisë lidhur me realizimin e planeve menagjuese për vitin 2022, për regjistrimet e dëmeve pyjore për vitin 2022, për gjueti etj. Nga APK-ja është mbajtur debat lidhur me rregullimin e produkteve pyjore jodrunore.

Mbrojtjen e pyjeve nga zjarret dhe sëmundjet

Gjatë kësaj periudhe janë shfaqur disa zjarre në pyjet e Komunës së Ferizajt, në pyjet e Dremjakut si dhe në pyjet e Gaçkës. Këto zjarre janë shfaqur në pyje publike si dhe në pyje private. Sipërfaqja e përhapjes së zjarrit në pyje publike ka qenë 46 hektarë, ndërsa në pyje private ka qenë 40 hektarë. Zjarret kryesisht janë shfaqur gjatë muajit mars dhe prill, ku banorët e zonave rurale kanë djegur mbeturina. Lloji i drurit ka qenë kryesisht dushqe. Në fikjen e zjarrit kanë marrë pjesë edhe Njësiti i Zjarrfikësve.

Seancat gjyqësore, pasqyra e aktgjykimeve dhe aktvendime

Gjatë këtij viti janë mbajtur 63 seanca në Gjykatën Themelore –Divizioni Penal në Ferizaj.

Aktgjykimet e pranuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj-Divizioni Penal.

Gjithsej- 79 aktgjykime.

Pozitive- 37

Të pezulluara - 42 dhe

Negative -0.

Aktvendimet e pranuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj-Divizioni për Kundërvajtje.

Gjithsej- 223 aktvendime

Pozitive- 94,

Të pezulluara -94 dhe

Negative -0.

- Gjatë këtij viti janë përgatitur 200 aktvendime kundërvajtëse për t'u dërguar në Gjykatën për Kundërvajtje për t'u bërë të plotfuqishme për kompensim të dëmit pyjor.

- Poashtu edhe 95 aktgjykime penale janë përgatitur për tu dërguar në Gjykatën Penale për tu bërë të plotfuqishme kompensimin e dëmit pyjor.
- Tek përmbaruesi privat kemi bërë propozim për kompenzim të dëmit pyjor për 69 aktgjykime penale të plotfuqishme.
- Nga përmbaruesi privat gjatë këtij viti kemi pranuar 21 urdhër/pagesa të kompensimit të dëmit pyjor në vlerë prej 6,603.22 €.

Shfrytëzimi në pyjet publike, damkimi, realizimi etj.

Gjatë këtij viti sipas planeve menaxhuese të APK-së dhe sipas UA për shitblerjen e masës drusore në pyje publike janë tenderuar dy ngastra pyjore. Sipas procedurave të prokurimit në ankand/tender në këto ngastra do të operojnë këta operator.

Ngastra pyjore 21-NTPSH “LYPETENI”

Dru teknik-336.40 m³ dhe Dru zjarri-323.10 m³

Ngastra 22-NTP “METI COMERC”

Dru teknik-539.60 m³ dhe dru zjarri-800.10 m³

Këto ngastra iu janë dorëzuar operatorëve ekonomik.

Furnizimi i ekonomive familjare me dru zjarri

Për furnizim me dru zjarri për ekonomitë familjare për zonat rurale, sipas damkimit nga APK-ja është realizuar kjo masë drusore nëpër Njësi Menaxhuese në këto ngastra:

Njësia Menagjuese “Zhegoc” .

Ngastra 24 janë realizuar- 23.30 m³ dru zjarri pastrim fitosanitar të llojit pishë.

Njësia Menaxhuese “Neredime-Jezerc”.

Ngastra 60 janë realizuar - 39.76 m³ dru zjarri.

Ngastra 61 janë realizuar - 35.74 m³ dru zjarri të llojit ahu.

Ngastra 102 janë realizuar - 49.63 m³ dru zjarri të llojit ahu.

Ngastra 109 janë realizuar -54.16 m³ dru zjarr të llojit ahu.

Te Parku i Lirisë janë realizuar 11.07 m³ dru zjarri pastrim fitosanitar të llojit pishë.

Sipas Vendimit të Inspektoratit Pyjor në nivel qendror dhe kërkesës së Njesisë së Pylltarisë në Ferizaj, kemi bërë furnizimin me dru zjarri (pastrime sanitare) gjatë muajit Gusht dhe Shtator me vëllim prej 383.40 m³ në Njësinë Menaxhuese “Neredime-Jezerc” në rajonet e pyjeve të larta.

Shërbimet dhe shfrytëzimi në pyje private

Gjatë këtij viti nga pronarë të pyjeve private kemi pranuar 49 kërtesa për lejimin e shfrytëzimit me dru zjarri. Nga këto 49 kërkesa, 10 kërkesa kanë qenë toka bujqësore, kullosa etj, ndërsa 39 kërkesa kanë qenë toka pyjore.

Nga APK-ja është bërë damkimi i trungjeve në pyje private me vëllim prej: dru teknik -5.89 m³ dhe dru zjarri-444.35 m³.

- Janë lëshuar 32 leje për prerje me vëllim: dru teknik-15.89 m³ dhe dru zjarri 508.94 m³.
- Janë vulosur dru zjarri-319.10 m³ dhe dru teknik-10.89 m³.
- Janë lëshuar 95 fletëpërcjellëse me vëllim prej 287.84 m³.

Regjistrimet e dëmeve pyjore

Gjatë vitit 2022, është bërë regjistrimi i dëmeve pyjore në këto rajone:

- Njësia Menaxhuese “Neredime-Jezerc”-Rajonet: Jezerci 1, Lumi i Madh, Lumi i Vogël, Pleshina 1, Pleshinë-Greme dhe Greme-Gaçkë.
- Njësia Menaxhuese “Dremjak” – Rajoni i Dremjakut.

Të hyrat nga pagesat e APK-së

-Taksa për shitjen e masës drusore në këmbë.....22,566.94 €

-Taksa nga shitja në cung (prerje sanitare).....3,829.06 €

-Taksa nga pastrimet në pyll.....6,135.40 €

-Taksa nga shërbimet e pyjeve private..... 1,113.38 €

Gjithsej të hyra-----33,644.78 €



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE EMERGJENCË

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2022

Arben Halili

Drejtore i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencë

1. HYRJE

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë në kuadër të fushë veprimtarisë së saj ka sektorin e shërbimeve publike dhe sektorin e emergjencave.

Sektori i shërbimeve publike mbulon aktivitetet që ndërlidhen me mirëmbajtjen e hapësirave publike si mirëmbajtja e rrugëve me asfalt, me zhavorr, riparimin e trotuareve, pastaj mirëmbajtja e rrugëve me shenja të komunikacionit si ato horizontale dhe vertikale, mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruara si sheshet, parqet, drunjtë dekorativ, mirëmbajtjen e rrjetit të ndriçimit publik si dhe zgjerimin e tij, aty ku paraqiten nevojat sipas mundësive buxhetore, pastaj mbarëvajtjen e komunikacionit rrugor dhe atij të mallrave, mirëmbajtjen e infrastrukturës nëntokësore si rrjeti i kanalizimit atmosferik dhe atij fekal, rrjetin e ujësjellësit etj., çdo herë në koordinim edhe me ndërmarrjet publike për detyrat dhe obligimet që ato i kanë ndaj qytetarëve të përcaktuara me ligjet dhe udhëzimet administrative në fuqi.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-027 për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, në të cilin përcaktohen dhe rregullohen detyrat bazë të sistemit të mbrojtjes dhe shpëtimit nga fatkeqësitë e tjera, Komuna në territorin e saj organizon mbrojtjen nga zjarri, kujdeset për zbatimin dhe përparimin e masave të mbrojtjes nga zjarri dhe fatkeqësitë tjera natyrore si vërshimet, rrëshqitjet e dheut apo erërat si dhe fatkeqësi tjera natyrore që mund të ndodhin në Komunën e Ferizajt.

Në të njëjtën kohë, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë zhvillon aktivitete për shënimin e datave të rëndësishme mjedisore si dhe dekorimin e qytetit për festat e fund vitit dhe festave tjera zyrtare.

Gjatë vitit 2022 janë pranuar 1509 kërkesa nga zyra pritëse të adresuara nga qytetarët për Drejtorinë e Shërbimeve Publike, pas shqyrtimeve të gjitha janë shpërndarë tek zyrtarët përkatës të Drejtorisë të cilat pas verifikimeve në terren disa prej tyre janë miratuar disa janë refuzuar e disa janë në proces.

Kërkesa të pranuar	Kërkesa të miratuara	Kërkesa të refuzuara, anuluara	Kërkesa në proces, pezulluara
1509	1340	134	35

2. SEKTORI I EMERGJENCAVE

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-027 për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, në të cilin përcaktohen dhe rregullohen detyrat bazë të sistemit të mbrojtjes dhe shpëtimit nga zjarri dhe fatkeqësitë tjera natyrore, stafi i sektorit të emergjencave është munduar që të përmbush këto obligime që dalin nga ligji duke kryer këto detyra në terren që lidhen me kërkesat dhe nevojat e qytetarëve.

- Gjatë këtij viti kemi pranuar kërkesa të natyrave të ndryshme, ku të gjitha janë shqyrtuar.
- Mbikëqyrja e kryerjes së punëve në pastrimin e rrugëve të qytetit dhe fshatrave gjatë sezonit dimëror dhe veror ku për këtë qëllim të kontraktuara janë operatorë ekonomik privat dhe publik.
- Menaxhimi-shqyrtimi i kërkesave të qytetarëve për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë e ndryshme natyrore si reshjet e shiut, borës, erërave dhe rastet e zjarreve në bashkëpunim me Policinë, zjarrfikësit, kompanitë publike. Vlen të përmenden si pasojë e stuhisë së erës në muajin Qershor, ka pasur dëme materiale ku nga era apo fryma e fortë bie një dru dekorativ mbi një veturë, po ashtu si pasojë e stuhisë së erës në magjistralen Ferizaj – Prishtinë konkretisht në fshatin Prelez i Jerlive, kulmi nga llamarina i një objekti afarist ka rënë në tokë. Gjithashtu edhe në muajin Dhjetor si pasojë e reshjeve të dendura të shiut, kemi pasur intervenime të ndryshme në de bllokimin e proçkave, kanalizimeve atmosferike etj. Në bazë të kërkesave të qytetarëve që i janë shkaktuar dëme përfshirë ekonominë familjare, biznese të ndryshme, si dhe dëme në sektorin e bujqësisë. Vendet që më së shumti pësuan dëme si pasojë e reshjeve të dendura të shiut janë fshatrat: Varosh, Greme, Nikadin, Doganaj, Dremjak si dhe bizneset me lokacione magjistranja Prishtinë – Shkup dhe Ferizaj (Qytet).
- Përcjellja e punëve në mbjelljen e 20.000 copë luleve verore dhe vjeshtore si dhe 470 copë të drunjve dekorativ dhe fidanëve në hapësirat e gjelbëruara të qytetit përmes kompanisë publike NPL-AMBIENTI.
- Është bërë rregullimi i ulëseve dhe shportave të mbeturinave nga kompania publike NPL-AMBIENTI.
- Është bërë vendosja (zëvendësimi) i flamujve nga kompania publike NPL-AMBIENTI.
- Është bërë krasitja e drunjve dekorativ në sheshin e qytetit në mënyrë profesionale, mirëmbajtja e hapësirave të gjelbëruara si parqet, sheshet, lapidarët.
- Po ashtu edhe gjatë vitit 2022 kemi vazhduar me operatorin ekonomik për pastrimin e varrezave të qytetit të të gjitha komuniteteve fetare si ato myslimane, katolike dhe ortodokse.
- Mirëmbajtja e aparateve ultrasonike kundër shpezëve.
- Pjesëmarrja në trajnime të organizuara nga AKK-së dhe GIZ-i gjerman për menaxhimin e mbeturinave.

- Mbajtja e punëtorëve – trajnime 3 ditore me AME-në për menaxhimin e fatkeqësive natyrore në qendrën e trajnimeve në Vushtrri.
- Pajisja e Shërbimit Zjarrfikës me pompa të ujit, si dhe pajisje të tjera për Brigadën e zjarrfikëseve
- Ndërtimi i konstruksioneve për vendosjen e 10 hidrantëve është bërë në këto lokacione – fshatrat si: Mirosalë, Tërrn, Gërlinë, Fshati i Vjetër, Koshare, Gaçkë, rr. “Uran Tinova” - Ferizaj, rr. “Bajram e Gursel Sylejmani” - Ferizaj dhe rr. “Vezir Jashari” - Ferizaj.

2.1 Hapja dhe pastrimi i kanaleve ujore dhe shtretërve të lumenjve

Me qëllim mirëmbajtjen e shtretërve të lumenjve, kanaleve ujore dhe rregullimi i argjinaturave për të eliminuar vërshimet gjatë reshjeve janë hapur 2.155m¹ gjatësi të kanaleve dhe shtretërve të lumenjve dhe janë eliminuar 13.5 m³ të shkurreve dhe drunjve.

Është bërë hapja dhe pastrimi kanalit nëntokësor të lumit “Neredime” i cili është i vendosur në gypa 1 m. gjatësia e hapjes së kanalit të lumit është 500 ml.

Me qëllim të eliminimit të vërshimeve është intervenuar në këto fshatra: Talinoc i Muhaxherëve, Salla “Bill Clinton”, Neredime, Dremjak.

2.2 Raste zjarri, shiu, vërshime fryme dhe erë, për të cilat qytetarët kanë bërë kërkesa për dalje në vendngjarje

Duhet potencuar se stafi i emergjencave në kuadër të Drejtorisë, pas pranimit të kërkesave nga qytetarët për dalje në vendngjarje për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga zjarri ka verifikuar këto raste:

- Rast zjarri në objektin ndihmës së shtëpisë (shupë) e Razije Luzha– fshati Dubravë
- Rast zjarri në shtëpinë e Dashurije Baliu – Ferizaj
- Rast nga reshjet e shiut në shtëpinë e Orhan (Spasena) Maliqi - Ferizaj
- Rast nga reshjet e shiut në shtëpinë e Kandengjike Rashiti - Ferizaj
- Rast nga reshjet e shiut në shtëpinë e Deli Rexhepi – fshati Zllatar
- Rast nga era e fortë në shtëpinë e Selver Kqiku – fshati Dardani
- Rast nga era e fortë në shtëpinë e Ramadan Kqiku – fshati Dardani
- Rast nga era e fortë në biznesin e Naim Shijaku – Ferizaj
- Rast zjarri në shtëpinë e Shefki Blenishtit – fshati Zaskok
- Rast nga reshjet e shiut në shtëpinë e Arbrenda Ademaj - Ferizaj
- Rast nga reshjet e shiut në shtëpinë e Dashurije Kosova– Ferizaj
- Rast zjarri në shtëpinë e Mehmet Heta – fshati Varosh
- Rast zjarri në biznesin e Vullnet Hetemi – fshati Neredime

2.3 Njësia e menaxhimit të mbeturinave

Me qëllim të krijimit të një ambienti sa më të pastër, si dhe largimin e mbeturinave nga hapësirat publike janë zhvilluar një numër i madh i aktiviteteve, të ndryshme në ruajtjen dhe pastrimin e ambientit, aktivitetet janë zhvilluar në zona urbane dhe rurale.

- Identifikimi i 30 deponive ilegale të mbeturinave përfshirë mbeturina prej amvisërisë, mbeturina të ndërtimit/inerte, mbeturina industriale/rrezikshme, mbeturina e vëllimshme dhe mbeturina të përziera. Në lokacionet urbane në qytet dhe fshatra në bashkëpunim me GIZ-in Gjerman si dhe eliminimi i tyre është bërë nga kompania publike K.R.M „Pastërtia”.
- Janë shënuar edhe data me rëndësi mjedisore si Dita e Pranverës, Dita e Tokës dhe Dita e Mjedisit si dhe data tjera me rëndësi ekologjike dhe mjedisore.
- Gjatë vitit 2022, Komuna e Ferizajt ka zhvilluar projekte të rëndësishme duke ndihmuar Kompaninë Rajonale të Menaxhimit të Mbeturinave duke i furnizuar me 60 kontejnerë mbitokësor 1.1 m³ dhe 100 kontejnerë shtëpiak 120L e të cilat janë shpërndarë në qytet dhe fshatra duke mundësuar kështu rritjen dhe zgjerimin e klientëve në sistemin e menaxhimit të mbeturinave.
- Gjatë vitit 2022, Komuna e Ferizajt ka marrë donacion 3 kamionë nga GIZ-i Gjerman, si dhe 4 kamionë nga Ambasada Japoneze që shërbejnë për bartjen e mbeturinave për K.R.M “Pastërtia”.
- Hartimi i Planit të komunës për menaxhimin e mbeturinave-PKMM.
- Hartimi dhe miratimi i rregullores për menaxhimin e mbeturinave.
- Hartimi dhe miratimi i rregullores për përcaktimin e taksave dhe tarifave për mbeturinat e komunale.

2.4 Vendosja e hidrantëve

Për të zvogëluar kohën e reagimet emergjent ndaj rasteve të zjarrit nëpër lokacione të ndryshme, Komuna e Ferizajt – DSHPE-ja ka vazhduar në vendosjen e 10 hidrantëve në lokacionet e ndryshme në fshatra – qytet si: Miroslë, Tërrn, Gërlinë, Fshati i Vjetër, Koshare, Gaçkë, rr. “Uran Tinova” - Ferizaj, rr. “Bajram e Gursel Sylejmani” - Ferizaj dhe rr. “Vezir Jashari” – Ferizaj, gjithashtu të gjitha hidrantët janë të pajisur me shenjë vertikale identifikuese të hidrantit.

3. SEKTORI I SHËRBIMEVE PUBLIKE

Në kuadër të shërbimeve publike janë zhvilluar një numër i madh aktiviteteve të cilat drejtpërdrejt kanë prekur interesat e qytetarëve si në riparimin e kanalizimeve, ujësjellësve, mirëmbajtjen e rrugëve me zhavorr, asfalt dhe mirëmbajtjen e trotuareve.

Duke u nisur edhe nga kërkesat e qytetarëve dhe gjendjes në terren janë realizuar këto punë dhe aktivitete.

Gjatë vitit 2022, kemi pranuar kërkesa të ndryshme kryesisht nga pjesët rurale dhe nga pjesa urbane të cilat kanë të bëjnë më së shumti me riparime të rrjetit të kanalizimit të ujërave të zeza, dhe kyçje të reja, si dhe meremetimin-mirëmbajtjen e rrugëve me zhavorr.

Gjatë vitit 2022 kemi kryer shumë raste aty ku ka pas mundësi për de bllokime në bashkëpunim me kompaninë KRU „Bifurkacioni” kemi bërë de bllokimin e rrjeteve, kurse pjesët ku ka qenë nevoja për ndërrimin e gypave, dhe kyçje te reja i kemi kryer si në shënimet në vijim:

3.1 Riparimi i rrjetit të kanalizimit

Gjatë vitit 2022 kemi pranuar një numër të madh të kërkesave dhe ankesave që lidhen me rrjetin e kanalizimeve atmosferike dhe fekale, andaj pas verifikimit të tyre në terren dhe konstatimit se janë jashtë funksionit për të cilin janë të dedikuar kemi ndërmarr masa për të riparuar apo edhe instaluar në gjatësi të caktuara rrjet të kanalizimit fekal në zonat urbane dhe rurale të komunës.

Gjatësia e riparimeve dhe instalimeve të këtij rrjeti të kanalizimeve arrin 12,500 me¹.

Gjatësia e riparimeve të rrjetit të ujësjellësit arrin 2667 m¹.

3.2 Riparimi i rrugëve me asfalt dhe zhavorr, riparimi i trotuareve

Gjithashtu për të përmirësuar infrastrukturën rrugore sektori i shërbimeve publike ka kryer një numër të madh të aktiviteteve duke u nisur nga gjendja në terren dhe kërkesat e qytetarëve. Pas daljes në terren dhe verifikimit të gjendjes nga zyrtarët e shërbimeve publike e duke u dhënë prioritet rasteve më emergjente si dhe duke pasur parasysh kufizimet buxhetore janë riparuar, mbi 7806 m² të trotuareve me kubëza si dhe 160,441 m² të rrugëve me zhavorr, riparimi me rrugëve me asfalt 38,814 m².

3.3 Rregullimi i hapësirave publike tek banesat e vjetra kolektive

Gjatë vitit 2022 kemi rregulluar 3350 m².

4. NJËSIA E TRAFIKUT DHE TRANSPORTI RRUGOR

Nga përshkrimi i detyrave zyrtare të cilat rrjedhin nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, zyrtari i lartë për komunikacion rrugor gjatë periudhës një vjeçare sipas planit të parashikuar, për këtë vit ka realizuar këto punë:

4.1 Transporti rrugor i udhëtarëve dhe mallrave

Transporti i udhëtarëve me autobus dhe taksi është duke u zhvilluar në një nivel të kënaqshëm, ku nga dyzet e pesë fshatra sa ka Komuna e Ferizajt, dyzet e tri prej këtyre fshatrave janë të përfshira në transportin publik dhe vazhdimisht inspektohen nga inspektori i transportit.

4.2 Trafiku rrugor

Në këtë pikë është paraparë rregullimi teknik i qarkullimit në trafik dhe ngritja e sigurisë për të gjithë pjesëmarrësit në trafik, ku së bashku me njësinë e trafikut të Policisë kemi analizuar disa rrugë të qytetit dhe kemi bërë disa ndërhyrje dhe ndryshime konkrete të cilat janë realizuar me qëllim të lehtësimit dhe krijimit të një ambienti më të sigurt dhe më të kënaqshëm për të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion rrugor, ku vlen të potencohen këto ndërhyrje:

1. Rregullimi i trotuarit në rrugën urbane “Sinan Sahiti” dhe pjesërisht në rrugën urbane “Xhevë Lladrovci”.
2. Rregullimi i pjerrinave për qasje më të lehtë të personave me aftësi të kufizuara në infrastrukturën publike.
3. Rregullimin e ngadalësuesve të shpejtësisë nga asfalti për qetësimin e trafikut në vendkalimet e këmbësorëve në rrugët urbane “Naim Beka”, “Epopeja e Jezercit”, “Hilmi Ferizi”, “Enver Topalli” dhe “Ahmet Hoxha”.
4. Ndërhyrja në udhëkryqin e rrugëve “Xhevë Lladrovci”, “Emin Duraku” dhe “Sinan Sahiti”, ku nga një kryqëzim i formës së parregullt është ri-konstruktuar në kryqëzim me rreth-rrotullim.
5. Ndërhyrja në udhëkryqin e rrugëve “Sinan Sahiti” dhe “Vëllezërit Gërvalla”, ku nga një kryqëzim i formës së parregullt është ri-konstruktuar në kryqëzim me rreth-rrotullim.
6. Ndërhyrja në udhëkryqin e rrugëve “Rexhep Bislimi” dhe “Universiteti”, ku kryqëzimi aktual ka qenë i rregulluar me shenja ndriçuese të trafikut (semaforë) dhe është ri-konstruktuar në kryqëzim me rreth-rrotullim.

4.3 Shenjat e Trafikut

Në bazë të planifikimeve për këtë vit, kemi realizuar këto projekte në sinjalizimin e rrugëve me shenja horizontale dhe shenja vertikale trafikut, me qëllim të përmirësimit dhe krijimit të një ambienti më të sigurt për të gjithë pjesëmarrësit në komunikacionin rrugor.

4.4 Shenjat vertikale të komunikacionit :

Në rrugët e qytetit dhe fshatrave kemi bërë mirëmbajtjen dhe vendosjen e shenjave vertikale të rrezikut, urdhrave të prera dhe shenjat e lajmërimit - udhëtreguesit, ku me prioritet i kemi vendosur shenjat para institucioneve arsimore dhe janë përfshirë vendosja e shenjave për kufizimin e shpejtësisë dhe atyre të paralajmërimit të prezencës së fëmijëve në ato segmente rrugore.

4.5 Shenjat horizontale të komunikacionit.

1. Fshati Balaj – konkretisht komplet segmenti i rrugës kryesore duke përfshirë edhe rrugët anësore janë realizuar këto punë:
 - Shënimi i vendkalimeve të këmbësorëve, vijave të STOP në sasi 115 [m²],
 - Shënimi i vijës së aksit e ndërprerë dhe vijave anësore në gjatësi 5731 [lm],
 - Shënimi i vijës së aksit e pandërprerë dhe vijave anësore në gjatësi 2067 [lm],
 - Shënimi i shigjetave orientuese njëshe dhe dy degësh në sasi 6 [copë] dhe
 - Shënimi i sipërfaqeve të ndryshme për orientim në sasi 20.94 [m²].
2. Rruga “Osman Nuhaj”, konkretisht segmenti rrugor nga fshati Balaj deri në dalje me rrugën e fshatit Neredime janë realizuar këto punë :
 - Shënimi i vijës së aksit e ndërprerë në gjatësi 892 [lm],
 - Shënimi i vijës së aksit e pandërprerë në gjatësi 1169 [lm],
3. Segmenti rrugor nga fshati Balaj deri në rrugën “Brahim Ademi”, konkretisht rruga përgjatë Parkut të Lirisë të shënohet janë realizuar këto punë:
 - Shënimi i vijës së aksit e ndërprerë në gjatësi 1188 [lm],
 - Shënimi i vijës së aksit e pandërprerë në gjatësi 1034 [lm],
4. Në rrugën “Epopeja e Jezercit”, konkretisht në segmentin rrugor nga Ferizaj deri në fshatin Neredime janë realizuar këto punë :
 - Shënimi i vendkalimeve të këmbësorëve në sipërfaqet e ngritura nga asfalti, vijave të STOP në sasi 84.80 [m²],
5. Në rrugën “Hilmi Ferizi”, konkretisht në segmentin rrugor nga Ferizaj deri në fshatin Talinoc i Muhaxherëve janë realizuar këto punë :
 - Shënimi i vendkalimeve të këmbësorëve në sipërfaqet e ngritura nga asfalti, vijave të STOP në sasi 74.0 [m²] janë përdorur dy ngjyra (bardhë dhe kuqe).
6. Në rrugën “Naim Beka”, konkretisht në segmentin rrugor nga Ferizaj deri në fshatin Zaskok janë realizuar këto punë :
 - Shënimi i vendkalimeve të këmbësorëve në sipërfaqet e ngritura nga asfalti, vijave të STOP në sasi 63.40 [m²],
 - Shënimi i vijës së aksit e ndërprerë në gjatësi 42 [lm],
 - Shënimi i vijës së aksit e pandërprerë në gjatësi 40 [lm],

7. Në rrugën “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, konkretisht në segmentin rrugor nga Qendra Ferizaj deri në fshatin Nikadin (lagja Qiraxhive) duke përfshirë edhe rrugët anësore janë realizuar këto punë :
 - Shënimi i komplet sipërfaqes së shtegut të biçikletave me ngjyrë akrilike një komponentësh në sasi 2952.0 [m²]
 - Shënimi i vendkalimeve të këmbësorëve në sipërfaqet e ngritura nga asfalti, vijave të STOP në sasi 52.0 [m²],
 - Shënimi i vijës së aksit e ndërprerë në gjatësi 573 [lm],
 - Shënimi i vijës së aksit e pandërprerë në gjatësi 4880 [lm],
 - Shënimi i shigjetave orientuese njëshe në sasi 11 [copë]
8. Në rrugën “Enver Topalli”, konkretisht në segmentin rrugor nga Ferizaj deri në kryqëzimin e kësaj rruge me rrugën e lagjes Musaj janë realizuar këto punë :
 - Shënimi i vendkalimeve të këmbësorëve në sipërfaqet e ngritura nga asfalti, vijave të STOP në sasi 65.75 [m²] - janë përdorur dy ngjyra (bardhë dhe kuqe),
 - Shënimi i vijës së aksit e pandërprerë në gjatësi 80 [lm],
9. Rruga urbane “Astrit Bytyqi” – konkretisht komplet segmenti i rrugës kryesore deri në kryqëzim me rrugën nacionale N2 Ferizaj-Prishtinë, duke përfshirë edhe të gjitha rrugët anësore janë realizuar këto punë :
 - Shënimi i vendkalimeve të këmbësorëve, vijave të STOP në sasi 300.20 [m²],
 - Shënimi i vijës së aksit e ndërprerë, plotë dhe vijave anësore në gjatësi 1588 [lm].
10. Rruga “Ismet Ramadani”, konkretisht segmenti rrugor vetëm në dy vendkalime të këmbësorëve janë realizuar këto punë:
 - Shënimi i vendkalimeve të këmbësorëve, vijave të STOP në sasi 32.90 [m²],
11. Rruga “William Walker”, konkretisht segmenti rrugor vetëm në një vendkalim të këmbësorëve janë realizuar këto punë :
 - Shënimi i vendkalimeve të këmbësorëve, vijave të STOP në sasi 8.75 [m²],
12. Në rrugën “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, konkretisht në segmentin rrugor nga Qendra Ferizaj deri në fshatin Nikadin (lagja Qiraxhive) duke përfshirë edhe rrugët anësore janë realizuar këto punë :
 - Shënimi i komplet sipërfaqes së shtegut të biçikletave brenda rreth-rrrotullimit 16.50 [m²]
 - Shënimi i vendkalimeve të këmbësorëve, vijave të STOP në sasi 68.50 [m²],
 - Shënimi i vijës së aksit e ndërprerë, plotë dhe vijave anësore në gjatësi 197.20 [lm].
13. Në rrugën “Ali Kelmendi” si dhe në kryqëzimin e rrugëve “12 Qershori”, “Ramadan Rexhepi” dhe “Madeline Albright” (te rrethi i vogël i vizatuar në rrugë) :
 - Vendkalimet e këmbësorëve (gjelbër + bardhë) 94.20 [m²]
 - Shënimi i vijës së aksit e ndërprerë, plotë dhe vijave anësore në gjatësi 140.30 [lm].
 - Shënimi i ishujve ndarës me ngjyrë të bardhë – gjelbër = 60.60 [m²].

14. Sinjalizimi i hapësirës për parking në Gjykatën dhe Prokurorinë Themelore Ferizaj.
 - Shënimi i vijës së parkingjeve e ndërprerë dhe plotë në gjatësi 427 [lm].
 - Shënimi i vendkalimeve të këmbësorëve, vijave të STOP në sasi 81.04 [m²],
15. Rruga “Hamzë Jashari”, konkretisht segmenti rrugor nga projekti “Bashkimi i Qytetit” deri te kryqëzimi me rrugën “Dëshmorët e Kombit” janë realizuar këto punë :
 - Shënimi i vendkalimeve të këmbësorëve, vijave të STOP në sasi 37.50 [m²],
 - Shënimi i vend-parkingut për biçikleta me logo në sipërfaqe 13.0 [m²].
16. Rruga “Vëllezërit Gërvalla”, konkretisht në dalje të projektit “Bashkimi i Qytetit” janë realizuar këto punë :
 - Shënimi i vendkalimeve të këmbësorëve, vijave të STOP në sasi 19.50 [m²],
 - Largimi i ngjyrës në vendkalimin e këmbësorëve duke gërvishur në sipërfaqe 18.40 [m²].
17. Rruga “Gjon Serreçi”, konkretisht përballë hyrjes së Gjimnazit “Kuvendi i Arbërit” janë realizuar këto punë :
 - Shënimi i vendkalimeve të këmbësorëve, vijave të STOP në sasi 13.40 [m²],
18. Rruga “Dëshmorët e Kombit” janë realizuar këto punë :
 - Shënimi i vendkalimeve të këmbësorëve, vijave të STOP në sasi 19.50 [m²],
19. Rregullimi dhe sinjalizimi i vend-parkingjeve për biçikleta në tri lokacione të ndryshme.

4.6 Pengesat rrugore për qetësimin e komunikacionit

Në kuadër të kësaj fushe kemi bërë vendosjen e pengesave rrugore për qetësimin e komunikacionit në disa rrugë urbane të qytetit, ku prioritet i kemi dhanë rrugëve në afërsi të shkollave si dhe në ato rrugë ku ka frekuentim më të madh të fëmijëve duke analizuar edhe infrastrukturën përcjellëse (mungesa e trotuareve dhe shtigjeve për ecje).

5. NJËSIA E NDRIÇIMIT PUBLIK

Gjatë vitit 2022 ka vazhduar puna në mirëmbajtjen e rrjetit të ndriçimit publik ekzistues si dhe është punuar në zgjerimin e rrjetit të ndriçimit në rrugët dhe hapësirat ku nuk ka pasur ndriçim publik më parë. Gjatë vitit 2022 janë vendosur gjithsej 1840 trupa ndriçues LED.

5.1 Vendosja trupave ndriçues LED

Trupa ndriçues LED 50W: 1018 copë
 Trupa ndriçues LED 80W: 113 copë
 Trupa ndriçues LED 100W: 282 copë
 Trupa ndriçues LED 120W: 267 copë
 Trupa ndriçues LED 150W: 147 copë
 Reflektor LED 100W: 13 copë
 Shtylla metalike: 665 copë

Shprehur në vijë gjatësore gjatë vitit 2022 janë realizuar 67 km ndriçim publik.

Përveç punës në mirëmbajtjen dhe zgjerimin e rrjetit të ndriçimit publik në fund të vitit 2022 kemi bërë dekorimin e qytetit me rastin e festave të fund vitit duke i vendosur dritat dekorative, bredhin e Vitit të Ri dhe elementet tjera dekorative në sheshin "Adem Jashari" para objektit komunal.

5.2 Mirëmbajtja dhe rregullimi i konstruksioneve dhe objekteve nga metali, druri dhe plastika

Punët që janë kryer në këtë kontratë gjatë vitit 2022, në tabelën si vijon:

1	Mirëmbajtja e ulëseve me material drunor dhe hekur	copë	6
2	Furnizimi dhe montimi i ulëseve me material drunor dhe hekur	copë	16
3	Mirëmbajtja e shportave të mbeturinave	copë	10
4	Furnizimi dhe montimi i konstruksioneve metalike me dimensione 40x40x2mm	m	94
5	Furnizimi dhe vendosja e rrethojës me lartësi 1m dhe 1.5m,	m ²	592.5
6	Furnizimi dhe vendosja e rrjetave mbrojtëse nga konopi ose materiali plastik(10cm x 10cm) për fushat sportive(futboll, hendboll...)	m ²	120
7	Furnizimi dhe montimi i materialit pest - glass me trashësi 8mm-Fusha e Sportit - Tërrn	m ²	24
8	Furnizimi dhe montimi i paneleve metalike me trashësi 6.0mm-Fusha e Sportit - Tërrn	m ²	41
9	Rregullimi i parqeve komplet rregullimi i hapësirave duke filluar me gërryerjen e dheut , nivelimin e sipërfaqes e deri ne fazën finale - mbjellja e barit) - Fusha e Sportit - Tërrn	m ²	7025
10	Furnizimi dhe montimi i reflektorëve ne fushat sportive ne shkolla LED 400W - Fusha e Sportit - Tërrn	copë	10

11	Furnizimi dhe vendosja e kabllos tokësore nga alumini NAYY-4x16mm ² - Fusha e Sportit – Tërrn	m	425
12	Porositja, furnizimi, transporti dhe shtrirja e shiritit paralajmërues "RREZIK TENSIONI" përgjatë gjatësisë së kanalit. - Fusha e Sportit - Tërrn	m	320
13	Hapja e kanalit 50x80m dhe vendosja e kabllos 4x25mm ² Al , duke përfshirë gypin e r Ø63m. - Fusha e Sportit - Tërrn	m	662
14	Furnizimi, transporti dhe montimi i shtyllave metalike të ndriçimit të zinkuara konike të galvanizuar me lartësi H=10,8 m, Φ=156/60 me pjesë reduktuese në shtyllë - Fusha e Sportit - Tërrn	copë	10
15	Furnizimi dhe mbjellja e drunjve dekorativ ne parqet e shkollave - Prelez i Jerlive	copë	58
16	Furnizimi, transporti dhe montimi i shtyllave metalike të ndriçimit të zinkuara konike të galvanizuar me lartësi H=7,8 m, Φ=138/60 me pjesë reduktuese në shtyllë, SHFMU - Ismail Qemali - Prelez	copë	12
17	Furnizimi dhe vendosja e shiritit për tokëzim Fe-Zn 4 x 25 (mm) SHFMU - Ismail Qemali - Prelez	m	298

6. NJËSIA E SHËRBIMIT TË ZJARRFIKJES DHE SHPËTIMIT

Në vitin 2022, Shërbimi Zjarrfikës dhe Shpëtimit ka pasur **gjithsej 632 dalje** të ndara në kategori intervenimesh të cilat janë paraqitura në pjesën e dytë të raportit pjesa grafike e intervenimeve.

Si sfida më të mëdha përpos intervenimeve të ndryshme që kemi marrë pjesë nga më të ndryshmet, shërbimi ynë sfidë serioze që ka ndikuar drejtpërdrejt në punën tonë ka qenë numri i pamjaftueshëm i zjarrfikësve profesional, që as përafërti nuk i plotësojmë kriteret numerikisht për një shërbim me standarde të parapara me Ligjin Nr. 04/-L-049 dhe Rregulloren NR 16/2012 për numër të banorëve në Komunën tonë.

Po ashtu çështje me prioritet në zhvillim dhe ndikim në shërbimin zjarrfikës është aktivizimi i njësisë vartëse zjarrfikëse në Rr. “Enver Topalli” ku objekti ri ka përfunduar me vite por vetëm duhet plotësuar me inventarë shtesë, automjete dhe pranimin e punëtorëve zjarrfikës.

Realizimi i numrit të përgjithshëm të daljeve, struktura e zjarreve dhe intervenime tjera Janar-Dhjetor 2022

NJPZSH - FERIZAJ

Daljet e përgjithshme	Numri i zjarreve	Intervenime teknike.	Aksidente rrugore.	Vërshime	Shërbime	Boca gazi	Gjendje mobile
632	461	112	18	11	26	4	0

STRUKTURA E ZJARREVE DHE KLASIFIKIMI I TYRE GJATË

2022

NJPZSH - FERIZAJ

Zjarre në objekte ndërtimore	Zjarre në sipërfaqe të hapura fushore - malore	Zjarre në automjete	Zjarre në pajisje elektrike	Zjarre mbeturinash	Zjarre në oxhaqe	Zjarre në ushqime kafshëve	Alarme të rrejtshme	Objekt. tjera	Gjithsej
31	149	34	89	95	24	3	14	22	461

Realizimi i përgjithshëm i zjarreve dhe intervenime tjera nga viti 2010-2022

NJESIA PROFESIONALE E ZJARRËFIKJES DHE SHPËTIMIT - FERIZAJ

Viti 2010	Viti 2011	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
332	625	697	479	403	561	398	541	461	773	556	986	632

Struktura e zjarreve Janar –Dhjetor 2022

Totali	Dhjetor	Nëntor	Tetor	Shtator	Gusht	Korrik	Qershor	Maj	Prill	Mars	Shkurt	Janar	Muajt
632	36	40	24	40	68	102	42	31	65	77	45	62	Dalje
31	1	2	3	2	4	3	3	0	8	0	2	3	Objekte Ndërtimore
52	0	2	0	0	3	7	0	1	17	20	1	1	Zjarre malore
97	2	1	3	4	17	31	10	4	3	18	4	0	Zjarre Fushore
18	0	1	0	1	3	3	1	2	0	1	3	3	Aksidente trafiku
34	1	3	2	3	2	2	1	2	4	4	3	7	Automjete
89	17	11	2	3	6	5	3	5	5	6	6	20	Pajisje elektrike
14	3	1	0	0	1	4	0	0	2	0	2	1	Alarme të elektrike
26	1	0	4	0	7	6	1	1	3	0	2	1	Shërbime
112	2	7	7	7	10	14	16	8	7	11	10	13	Intervetime teknike
95	5	4	2	16	12	20	5	5	9	7	5	5	Mbeturina
4	1	2	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	Boca Gazi
21	0	0	1	2	3	3	2	2	1	4	1	2	Objekte të tjera
11	2	6	0	1	0	2	0	0	0	0	0	0	Vërshime
24	1	0	0	0	0	2	0	0	5	5	5	6	Oxhaqe
3	0	0	0	0	0	0	0	1	1	1	0	0	Ushqim i kafshëve
0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	Gjendje mobile
1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0	Eksplozive
9	0	0	0	1	0	0	0	1	0	1	3	3	Te lënduar
3	0	1	0	0	0	1	0	1	0	0	0	0	Te vdekur
632	36	40	24	40	68	102	42	31	65	77	45	62	Totali

